



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI
“Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë”
Bashkia Mallakastër

Tiranë, tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-10
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	4-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	8-10
II.	HYRJA	10-14
1.	Objektivat dhe qëllimi	10-10
2-132.	Identifikimi i çështjes.....	10-11
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-11
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	11-11
5.	Kriteret e vlerësimit.....	11-12
5.	Standardet e auditimit.....	12-13
7.	Metodat e auditimit.....	13-14
8.	Dokumentimi i auditimit.....	14-14
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14-125
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-15
2.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	15-23
2.2.1- 22.5	Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	23-29
2.2.6	Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	29-39
3	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike	39-55
4	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	55-80
4.4	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve	80-90
5	Auditimi mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet, Kullotat) të transferuara me VKM.	90-92
6	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	92-94
7	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore	94-96
8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	96-125
IV	REKOMANDIME	116-132

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Mallakastër:

Bashkia e Mallakastrës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me Bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me Bashkinë Patos dhe Fier. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit.

Bashkia e Mallakastrës është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është bashkuar ish-Bashkia Ballsh dhe ish-komunat në afërsi të saj, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative dhe ato janë: Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar dhe Selitë.

Për vitin 2024 planifikimi i buxhetit të rishikuar ka vlerën 485,528 mijë lekë, ndërkohë që realizimi ka qenë 350,598 mijë lekë ose në masën 72.2 % me një diferencë mos realizimi në vlerën 134,930 mijë lekë.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ka qenë në vlerën 411,045 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 178,198 mijë lekë ose në masën 43.4 % me një diferencë mos realizimi në vlerën 203,089 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij:

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Mallakastër administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit, për të siguruar qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për këtë periudhë. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Mallakastër. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi saktësinë në përgatitjen e pasqyrave financiare.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike, të transferuara me VKM.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike të kampionuara ose në tërësi sipas rastit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Auditimi është kryer mbi bazë risku.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se, Bashkia Mallakastër për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar në total 27 gjetje dhe janë lënë 29 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

f. Praqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Planifikimi dhe realizimi të të ardhurave. Vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve.

Bashkia Mallakastër ka planifikuar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore në vlerën 411,045,000 lekë, ndërsa i ka realizuar ato në masën 43.4 % në vlerën 178,197,935 lekë. Rezulton se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve.

- Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik”, konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk disponohet regjistër fizik, në të cilin evidentohen analitikët e këtyre llogarive me emërtimin dhe vlerën përkatëse.

-Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 është shpenzuar vlera 13,521,720 lekë, nga e cila vlera 1,715,044 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 3 raste. Vlera 1,715,044 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Mallakastër,

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit:

Procedura prokurimi janë kryer me parregullsi, duke mos argumentuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, konkretisht:

Aplikimi i kriterëve “**Kapaciteti teknik**” (kategoritë e licencave, stafi teknik), të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës dhe jo në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve, si dhe mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar, si dhe vendosja si kriter e distancave, në të gjitha rastet;

Janë shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetëdeklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit. Mangësitë kryesore konstatohen në disponimin e licencave përkatëse të kërkuara, mungesë dokumentacioni për makineritë e deklaruara, mos plotësim dokumentacioni në referencë të “Kritereve të Përgjithshme”.

Në **2 raste** u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përlllogaritjen e fondit limit, pasi janë përfshirë në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar zëra punimi dhe në disa raste vendosja e çmimeve të zërave të punimit, nuk është në përputhje me manualët e ndërtimit, duke rritur në mënyrë joreale fondin limit, në vlerën **totale prej 15,483,300 lekë**.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile

Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, Bashkia Mallakastër, u konstatua se kolaudimi i punimeve të ndërtimit të këtij objekti, nuk është kryer deri në kohën e auditimit të dosjes, edhe pse punimet kanë përfunduar para 10 muajve.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, me vlerë të kontratës (me TVSh) 497,726,607 lekë, rezulton se nuk janë vendosur pajisjet e parashikuara, për shkak të mungesës së rojeve, të energjisë elektrike dhe moskolaudimit dhe dorëzimit tek institucioni që do të administrojë këtë objekt. Vlera e këtyre zërave të pa vendosur në objekt, është 7,775,637 lekë pa TVSh.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile, në 2 raste në dosjet e zbatimit ka mungesë të dokumentacionit teknik, si: provat laboratorike dhe raportet e testimit janë të pa mjaftueshme dhe dendësia e provave të kryera, nuk mbulon kërkesat lidhur me plotësimin e parametrave fiziko kimikë, për shtresat rrugës, të ndërtuara sipas materialeve përkatëse.

- Në zbatimin e punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, rezulton se është hequr si zë pune “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 16”, i ofertuar me çmimin 2500 lekë/ml, në sasinë 1499 ml, në vlerë totale 3,747,500 lekë, i cili është zëvendësuar në mënyrë të paargumentuar teknikisht (pa patur një llogaritje të saktë të sistemit hidraulik dhe pa marrë opinionin e teknikëve) me zërin e ri “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 20”, me çmimin e dakordësuar 6741 lekë/ml, në sasinë 1227 ml, në vlerë totale 8,271,316.2 lekë, duke e shtuar vlerën e objektit me **5,203,707 lekë**. Kjo vlerë përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Mallakastër.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, rezulton se me punimet e kryera, janë përmirësuar 15303 m² rrugë të qytetit, që nuk kanë lidhje me këtë objekt. Nisur nga çmimet e shtresave rrugore (stabilizant + binder + asfalt) në total 2716 lekë/m², rezulton të jenë kryer punime pa efikasitet në vlerën 41,562,948 lekë.

Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve

- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Mallakastër dhe Njësisë Administrative Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar, Selitë, rezulton se: nga 1652 pasuri gjithsej që i kanë kaluar me VKM në përdorim/pronësi kësaj bashkie, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, për të kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

- Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit

Nga auditimi i veprimtarisë së IMT Bashkia Mallakastër, rezulton se nga verifikimi në terren për ndërtimet e paligjshme, në 5 raste janë konstatuar objekte të ndërtuara pa leje, për të cilat nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje për këto objekte, referuar kundërvajtjes së konstatuar, ndërsa rezulton se vendimet e marra, nuk janë ekzekutuar.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

Spektori i Tatim-Taksave në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa që:

Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për

secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale Bashkia Mallakastër, të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara),

Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara, të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Titullari i AK Bashkia Mallakastër, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Titullari i AK Bashkia Mallakastër , të analizojë arsyet e anomalive në përlllogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësia e prokurimit, gjatë përlllogaritjes së fondit limit, të marrë masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë.

Titullari i AK Bashkia Mallakastër, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, gjithashtu KVO të marrë masa, që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla.

Bashkia Mallakastër, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime, të marrë masa për caktimin e kolaudatorit të këtij objekti, me qëllim dorëzimin në institucionin pronar dhe administrimin ligjor të këtij objekti jetik për komunitetin

Bashkia Mallakastër, në bashkëpunim me AKUKM dhe SHRUK Fier, të marrë masa duke ngritur grup pune, për monitorimin e vendosjes së pajisjeve të parashikuara në objekt dhe dorëzimin e objektit në institucionin që do të bëjë administrimin e tij. PAGESA e këtyre zërave pune, të bëhet vetëm pasi të jenë marrë në dorëzim nga institucioni administrues, konform akteve ligjore që duhet të ndiqen për marrjen në dorëzim të objektit.

Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Mallakastër të marrë masa, të marrë masa për të plotësuar dosjet e zbatimit, me dokumentacionin përkatës të konstatuar në mungesë, si dhe në vijimësi të verifikojnë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit që do të paraqesin operatorët kontraktues.

Kryetari i Bashkisë Mallakastër të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin dhe azhornimin e pronave të Bashkisë Mallakastër, të kaluara me VKM përkatëse, për të vijuar me procesin për regjistrimin e aseteve, si pasuri e saj në ASHK.

Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa duke ngritur një grup pune për kontrollin e dokumentacionit të paraqitur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi në fazën e hartimit të projektit të azhurnuar, me qëllim që ndryshimet e paraqitura të jenë të argumentuara teknikisht, duke mos rënduar ekonomikisht në buxhetin e bashkisë.

-Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa që në të ardhmen, gjatë zbatimit të punimeve, të mos miratojë ndryshime në projektpreventiv të paargumentuara teknikisht, për zëra pune të cilat nuk janë sipas natyrës së objektit që zbatohet, me qëllim shmangien e punimeve pa eficiencë. Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të ekzekutuar vendimet e prishjes të marra prej tyre sipas afateve ligjore dhe në vijimësi për çdo vendim të marrë për prishjen e objekteve, të procedohet deri në përfundim të ekzekutimit të vendimit, për prishjen e objektit përkatës.

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër për periudhën ushtrimore të vitit, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Mallakastër janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni **të kualifikuar me rezervë**, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Bazat për opinionin e kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar.

Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin të auditimit.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit, llogaritur në vlerën 6,764 mijë lekë mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” është paraqitur në vlerën 10,419,769 lekë, në fakt kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

-Në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” është përfshirë projekti me objekt “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit” në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet, se Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,314,698,240 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 339,122,460 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 14,366,981 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 35,780,422 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 186,551,053 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 472,935,617 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Mallakastër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar/kualifikuar**

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne kemi kryer auditimin tonë në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 4000 dhe ISSAI 100). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me ISSAI-n 10, ISSAI 30, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Nga auditimi me përzgjedhje i 3 procedurave me vlerë të lartë, rezultoi se në 2 raste, aplikimi i kriterëve “**Kapaciteti teknik**”(kategoritë e licencave, stafit teknik), të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës dhe jo në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve, si dhe mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuara.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, Bashkia Mallakastër, u konstatua se kolaudimi i punimeve të ndërtimit të këtij objekti, nuk janë kryer deri në kohën e auditimit të dosjes, edhe pse punimet kanë përfunduar në datën 24.07.2024, akoma nuk është proceduar me caktimin e kolaudatorit të punimeve.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, me vlerë të kontratës (me TVSh) 497,726,607 lekë, rezultoi se nuk janë vendosur pajisjet e parashikuara, për shkak të mungesës së rojeve, të energjisë elektrike dhe moskolaudimit dhe dorëzimit tek institucioni që do të administrojë këtë objekt. Vlera e këtyre zërave “Furnizim impianti i klorifikimit”, “Linjat e shpërndarjes, Makineri dhe Pajisje”, “FV Hard disk 6 TB, i prodhuar për sisteme CCTV”, “FV sëitch 8 porta”, “FV Kamera 6 MPX”, “FV Kamera 3 MPX”, “FV NVR Profesional” dhe “FV Prozhektorë”, të pakryera në fakt, është 7,775,637 lekë pa TVSh.

- Në 2 raste u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përlllogaritjen e fondit limit, pasi janë përfshirë në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar zëra punimi dhe në disa

raste vendosja e çmimeve të zërave të punimit, nuk është në përputhje me manualët e ndërtimit, duke rritur në mënyrë joreale fondin limit, në vlerën **totale prej 15,483,300 lekë**, e konsideruar përdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet i fondeve.

- Në zbatimin e punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, rezultoi se është hequr si zë pune “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 16”, i cili është zëvendësuar në mënyrë të paargumentuar teknikisht me zërin e ri “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 20”, duke e shtuar vlerën e objektit me **5,203,707 lekë**. Kjo vlerë përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, rezulton se me punimet e kryera, janë përmirësuar 15303 m² rrugë të qytetit, që nuk kanë lidhje me këtë objekt. Nisur nga çmimet e shtresave rrugore (stabilizant + binder + asfalt) në total 2716 lekë/m², rezultoi të jenë kryer punime pa efikasitet në vlerën 41,562,948 lekë.

- Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 është shpenzuar vlera 13,521,720 lekë, nga e cila vlera 1,715,044 lekë i përket 3 vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve. Vlera 1,715,044 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit 85/1, datë 20.01.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.01.2025 deri në datën 18.04.2025, në subjektin Bashkia Mallakastër u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024”. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. L.K, Përgjegjës Grupi
2. H.I, Anëtar
3. F.,Ç, Anëtar
4. A.Z, Anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Mallakastër kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Mallakastër dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2024.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2024.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike.
8. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër, janë përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

5. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Mallakastër, është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Mallakastër. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:
- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;
- VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,
- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:
- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;
- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Në fushën e prokurimeve publike:
- Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.
- Në fushën e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit:
- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”;

- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore;
- Etj;

6. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Mallakastër, grupi i auditimit ka ndjekur standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”;
- ISSAI 2200-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar” ;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”, si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb, në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese konsistoi, nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël, etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Mallakastër, me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion i kërkuar dhe i vënë në dispozicion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale². Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia e Mallakastrës është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është bashkuar ish-Bashkia Mallakastër dhe katër ish-komunat në afërsi të saj, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative dhe ato janë: Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar dhe Selitë.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Mallakastrës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me Bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me Bashkinë Patos dhe Fier. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 27.062 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë 43.033 vetë si popullsi. Sipërfaqja e bashkisë së re është 329.19 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 82.45 banorë për km², ndërsa në bazë të regjistrin civil densiteti është 130.72 banorë për km².

Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Mallakastër:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Funksionet kryesore të Bashkisë Mallakastër kryhen në fushat:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Shërbimeve sociale;
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Mbrojtjes së mjedisit;
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike;
- Zhvillimit ekonomik vendor;
- Sigurisë publike.

Forma dhe mënyra e organizimit:

Rregullimi i veprimtarisë në Bashkinë Mallakastër, për periudhën në auditim 2024, është bërë sipas përcaktimeve në “Rregulloren e brendshme” miratuar me Vendimin e KB nr. 1, datë 18.05.2020.

Struktura Organizative.

Për vitin 2024 numri maksimal i punonjësve të miratuar sipas VKB Vendim Nr. 8, datë 18.10.2023 “Për miratimin e strukturës, organikës kategoritë/klasave të pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2024”, paraqitet 299 punonjës, nga të cilët 78 punonjës janë punonjës të administratës, 123 janë punonjës të institucioneve të varësisë dhe 119 janë punonjës me funksione të deleguara, nga të cilët: Arsimi ka 95 punonjës; Shërbimi pyjor – 4 punonjës; Ujitja dhe Kullimi – 3 punonjës; MZSH – 14 punonjës; Gjendja Civile në Njësitë Administrative dhe Bashki 3 punonjës

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Mallakastër si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë:

1.1. Për vlerësimin e implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Mallakastër nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin.

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Bashkia Mallakastër funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë miratuar me Vendimin nr. 1, datë 18.05.2020 konstatohet se ka mbivendosje të detyrave të përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore me specialistin (të cituara edhe më sipër), përcaktohen si detyra për specialist të sektorëve të ndryshëm, ngarkimi i tyre për realizimin e detyrave të tjera që i kërkojnë nga eprori, por të cilat nuk janë shprehur specifikisht; Për specialistin e kadastrës parashikohet kryerja e veprimeve kadastrale si: “Pajis qytetarët, në bazë të ligjeve dhe rregullave, me vërtetime faktesh që kanë të bëjnë me posedim të sipërfaqeve të pronës private dhe tokës bujqësore”, “lëshon kopje të hartave, plan-vendosjeve të objekteve sipas kërkesave të qytetarëve”, ndërkohë që këto funksione mbështetur në ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, neni 3: “Aktet kadastrale

janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj”, “Hartë kadastrale” është harta shkresore dhe digjitale, në të cilën pasqyrohen kufijtë, përmasat, pozicioni gjeografik, në përputhje me rregullat dhe 42 standardet zyrtare për pasuritë e paluajtshme, si dhe tregues të tjerë. “Veprimtari kadastrale” është tërësia e akteve dhe veprimeve administrative, në bazë të këtij ligji, që kryhet nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e përditësimin e të dhënave kadastrale të çdo pasurie, si dhe për lëshimin e akteve kadastrale”; Për sektorin e AKU dhe Bujqësisë, parashikohen funksione si: Kontrolli i analizave laboratorike, kontrolli i sëmundjeve të kafshëve që janë ngjitëse për njeriun, kontrolli i etiketave të shitjes së mallrave”, etj, detyra të cilat sipas ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtorive Rajonale të tij, si dhe shërbimit veterinar zyrtar.

Kodi i Etikës

Bashkia Mallakastër funksionon bazuar në Kodin e Etikës, Vendim Nr. 08 prot. datë 18.10.2023, që është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër me shkresën nr. 4896 prot., datë 18.10.2023. Kodi është i bazuar në legjislacionin përkatës, në të cilin është mbështetur Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Për vitin 2024, numri i punonjësve në Bashkinë Mallakastër, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2024, Vendim Nr. 8, datë 18.10.2023, “Për miratimin e strukturës, organikës kategoritë /klasave të pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2024”, ka qenë si vijon:

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Mallakastër pa ndryshime nga projekt i sjellë nga Bashkia me numër 299 të punonjësve;
 - 1.1 Në administratë numri i punonjësve të jetë 78 punonjës;
 - 1.2 Në institucionet në varësi të Bashkisë Mallakastër numri i punonjësve të jetë 123 punonjës;
 - 1.3 Funksionet e deleguara;
 - a) Arsimi – 95 punonjës;
 - b) Shërbimi pyjor – 4 punonjës;
 - c) Ujitja dhe Kullimi – 3 punonjës;
 - d) MZSH – 14 punonjës;
 - e) Gjendja Civile në Njësitë Administrative dhe Bashki 3 punonjës;

Në total numri i punonjësve për vitin 2024, **299 punonjës**.

Nga auditimi konstatohet se, në këto raste të ndryshimeve të emërtimeve të drejtuesve sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52. Në Bashkinë Mallakastër Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuar fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve për vitin 2024.

-Për vitin 2024, Bashkia Mallakastër nuk ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm në kundërshtim me përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Për periudhën vitin 2024, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendimmarrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

1. Mbi menaxhimin e riskut

-Nga Bashkia Mallakastër përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk ka plane operationale të punës.

-Bashkia Mallakastër nuk ka miratuar një regjistër risku, në kundërshtim me Ligjin 10296 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 11, pika 2, Udhëzimin nr.16 dt. 20.07.2016 Për Koordinatorin e MFK dhe Koordinatorin e Riskut, paragrafi 3.2.3.

-Në Bashkinë Mallakastër nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nenin 8, pika 8, shkronja a, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 pika 3.2.2, si dhe në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word-it.

-Në Bashkinë Mallakastër, po ashtu Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës , niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për sa më sipër vijnë në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.3.

-Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

-Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

2. Mbi veprimtarinë e kontrollit

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
- Nga komunikimi me personat përgjegjës në Bashkinë Mallakastër, u konstatua se institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar Hartat e Proceseve të Punës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.3, Udhëzimi nr. 16, dt. 20.07.2016, pika 2.3.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.
- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyra dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit e bazës materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e thesarit për Bashkinë Mallakastër, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Mallakastër të bërë me këta agjentë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
- Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.
- Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve.
- Bashkia Mallakastër nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet

të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

- Në Bashkinë Mallakastër nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF.

- Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

- Bashkia Mallakastër disponon faqen e saj zyrtare në internet www.bashkiamallakastër.gov.al, ku pasqyrohet aktiviteti i saj si: Rregullorja e brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, VKB, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor, si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

- Përdoret sistemi e-albania për deklarime online për të marrë dokumente të ndryshme informimi. Nëpërmjet sistemit on-line të informimit,

- Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Mallakastër punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale.

Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të emailit zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

5. Komponenti: “Monitorimi”

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokumenti i cili hartohet çdo 4 muaj.

-Në Bashkinë Mallakastër mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Në Bashkinë Mallakastër aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Bashkia Mallakastër ka dërguar Raportin e Vetëvlerësimit së bashku me pyetësorin në adresën e Ministrisë së Financave me shkresën nr prot. 965 prot., datë 03.03.2025. Raporti përshkruan në mënyrë të përciptë problematikat lidhur me 5 komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, dhe nuk jep zgjidhje konkrete mbi hapat që do të ndërmerren në tejkalimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Q.I, Kryetar i Bashkisë Mallakastër;
2. Zj. L.S , Drejtor i Burimeve Njerëzore.
3. Z. A.R, Drejtor i Financës

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Në zbatim të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

“Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në gërmat a-c të kësaj pike” është ngritur dhe funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Gramsh, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Ky sektor përgjatë periudhës 2024, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 10, datë 29.12.2023 “*Për miratimin e strukturës, organikës, kategoritë/klasat e pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2024*”, duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) specialiste auditit, z. D.B dhe zj. Xh.E. Për vitin 2024 struktura e NjAB ka funksionuar pa përgjegjës sektori.

Bashkia Mallakastër, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj dhe përmbushjes së objektivave të vendosura, me Vendimin nr. 129, datë 30.08.2021, ka miratuar Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës në Bashkinë Mallakastër”, pasqyruar në tabelën 1, pika 1, bashkëlidhur.

Trajnimet e NJAB dhe certifikimet

Referuar Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, nuk i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve për të zgjeruar njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e njësisë së auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.

Për vitin 2024, trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Mallakastër pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Trajnimet e njësisë AB për vitin 2023

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i Punës /Drejtoria	Tema e trajnimit te ndjekur	Institucioni Trajnues	Data e trajnimit dhe mënyra e ndjekjes se trajnimit (online/Fizik)
1.	D.B	Auditues i NJAB	Trajnim për Audituesit e Brendshëm dhe Drejtuesit Financiarë Vendor	Ministria e Financave	21 tetor, 30-31 tetor

Burimi: NJAB Mallakastër përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa i përket trajnimeve nuk janë përmbushur kërkesat sipas Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 20 “Trajnimi i vazhdueshëm profesional i audituesve të brendshëm”, ku përcaktohet:

1. Trajnimi i vazhdueshëm profesional organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.
2. Të gjithë audituesit e certifikuar i nënshtrohen trajnimit të vazhdueshëm profesional, të paktën 80 orë në 2 vjet.

3. Audituesit të brendshëm në detyrë i njihet si trajnim i vazhdueshëm profesional pjesëmarrja në trajnime për auditimin e brendshëm, të organizuara nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe publikime në fusha që lidhen me auditimin e brendshëm, të cilat raportohen dhe njihen sipas procedurës së përcaktuar në urdhrin e nxjerrë sipas pikës 1 të këtij neni.

3/1. Në përfundim të çdo kursi trajnimi të vazhdueshëm profesional, audituesi i brendshëm pajiset me vërtetimin e ndjekjes së trajnimit. Vërtetimi depozitohet pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.”;

“3/2. Përmbushja e detyrimeve të trajnimit të vazhdueshëm profesional është kusht për regjistrimin e audituesve të brendshëm në Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Certifikuar.

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësisë së saj, nuk është krijuar nga Bashkia Gramsh.

Referuar të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12/b, përcakton se: **Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për:**

b) **krijimi e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike** përkatëse sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar, neni 12/b, 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” **Konstatim:** Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12/b, 13 të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Mallakastër e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 995 prot., datë 04.03.2024 dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016*”.

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm. Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor të çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm....”

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2024-2026. Plani strategjik për vitet 2024-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4482/2 prot., datë 19.10.2023, në përputhje me të Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2024

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se:

Për vitin 2024, janë planifikuar për t’u kryer **3** auditime (1 auditim përputhshmërie, 1 auditimi performance dhe 1 auditim i kombinuar) të cilat janë realizuar të gjitha pasqyruar në **Tabelën 2, puka 2**, “Përshkrimi i aktivitetit të AB”, bashkëlidhur.

Raporti i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 657/1 prot., datë 09.02.2024.

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi auditimit duke pasur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2024, auditoi 4 (katër) dosjet e auditimit, që janë:

- dosja e auditimit të kryer në Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit dhe Kadastrës
- dosja e auditimit të kryer në Sektorin e Transportit dhe Licencave;
- dosja e auditimit të kryer në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike;
- dosja e auditimit të kryer për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna;

Pasqyruar në Tabelën 3, pika 1, “Pershkrimi i subjekteve të audituara nga AB”, bashkëlidhur -Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2024;

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

- PBA 2024-2026 miratuar respektivisht me VKB nr.14. , datë 27.03.2023 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”,
- Me VKB nr. 37. , datë .24.07.2023 “Për miratimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

- Me VKB nr. 63., datë .21.12.2023 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”. Sipas Aneksit 6, pika 2.2.1, bashkëlidhur.

Me vendimin e këshillit bashkiak (VKB) nr.64 datë 21.12.2023, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë dhe buxhetit të vitit 2024 institucioneve në varësi njëjësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2024.

Me vendimin nr. 61, datë 21.12.2023 është miratuar niveli i pagave të punonjësve funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi dhe funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2024.

Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.64.datë 21.12.2024 konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier me shkresën nr. 1290/1 datë 28.12.2023.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën 411,045,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 224,006,726 lekë, transfertat sektoriale ka vlerën 149,071,984 lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2023 janë 20,000,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 804,123,710 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 804,123,710 lekë.

Gjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 04 , datë 29.01.2024 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Mallakastër për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 28,879,631,96 lekë.

- Me VKB nr.12 , datë 28.02.2024 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Mallakastër për rishpërndarje të fondeve buxhetore në buxhetin e vitit 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 1,200,000 lekë.

- Me VKB nr.28 , datë 30.05.2024 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Mallakastër për rishpërndarje të fondeve buxhetore në buxhetin e vitit 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 1,978,664 lekë.
- Me VKB nr.37 , datë 24.07.2024 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Mallakastër për rishpërndarje të fondeve buxhetore në buxhetin e vitit 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 145,182 lekë.
- Me VKB nr.47 , datë 25.09.2024 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Mallakastër për miratimin e buxhetit shtese dhe rishpërndarje të fondeve buxhetore në buxhetin e vitit 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 17,673,473 lekë.
- Me VKB nr.70 , datë 24.12.2024 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Mallakastër për miratimin e buxhetit shtese dhe rishpërndarje të fondeve buxhetore në buxhetin e vitit 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 16,183,752 lekë.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2, bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit të institucionit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mallakastër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Gjatë vitit 2024 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten në “Tabela e ndryshimeve të buxheteve periudha 2024”(bashkëlidhur).

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mallakastër si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2024, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat sektoriale) paraqitet në tabelën Tabela B4, pika 2.2.3, bashkëlidhur.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2024 vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar, Bashkia Mallakastër së bashku me njësitë vartëse (analizë e cila mat saktë performancën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, pasi nuk përfshihen fondet që vijnë nga transfertat e kushtëzuar).

Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2024 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertat e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 208,807 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 485,528 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 324,433 mijë lekë ose në masën 67%. Zëri shpenzime paqe dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 350,598 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 278,431 mijë lekë ose në masën 79%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 197,763 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,750 mijë lekë ose në masën 45%.

Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 232,571 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 226,072 mijë lekë ose në masën 97%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2024 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën 485,528 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 324,433 mijë lekë ose në masën 67%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta:

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2024 ka vlerën 411,045 mijë lekë ndërsa realizimi ka vlerën 178,197 mijë lekë ose në masën 43.4%. Bashkia Mallakastër ka pasur të ardhura të trashëguara nga viti 2023 shumën 48,879 mijë lekë

Gjatë viti 2023 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Mallakastër është në vlerën 136,146 mijë lekë

Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si më poshtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën 37,546 mijë lekë
- Llogaria 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 8,297 mijë lekë;
- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 59,504 mijë lekë;
- Llogaria 606 (Transferta buxhete familjarë, individ) në shumën 6,952 mijë lekë;
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 22,927 mijë lekë

Buxheti faktik i vitit 2024 është në vlerën 983,500 mijë lekë duke përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK. **Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Mallakastër me të ardhurat e veta mbulon 14% të buxhetit vjetor 2024.** Të dhënat e mësipërme për vitin 2024, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Në mënyrë të hollësishme në tabelën B5

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Mallakastër, për vitin 2024. Në lekë										
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit					
					Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
							Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet
	Paga 600	350.598.752	278.431.835	79%	37.546.523	13%	150.626.230	84.421.141		
	Sigurime shoqërore 601	57.848.127	46.836.281	81%	8.297.979	18%	23.572.182	13.979.472		
	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	208.899.612	88.750.706	42.5 %	59.504.037	67%	26.932.988	1908.681		
	Subvencion Ujësullësi, etj. 603	0	0	0	0	0	0	00	0	0
	K. Q Emergj Civile 604	9.400.682	3.524.819	37 %	1984	0			3.522.835	
	Nd/Ekonom invalid 606	232.571.200	226.072.108	97%	6.952.178	3%	936.326		218.183.604	
	Mjete ne ruajtje 466	15.832.329	15.832.329	100%	917.214	6%	2.585.000	0	0	12.330.115
	Investime 230-231	488.528.713	324.433.522	66.8 %	22.927.023	7%	51.700.000	0	0	249.806.499
	Shpenzime 605	0	0	0						
	Interesa kredia 166	0	0	0						
	Principali 651	0	0	0						
									
	Shto, pakso sipas faktit në									
	Totali	1.363.298.279	983.500.464	72 %	136.146.938	14%	256.352.726	100.309.294	221.706.439	262.136.614

Burimi: Bashkia Mallakastër

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë:

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.

Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përfshirë transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për Emergjencat Civile” i ndryshuar, të nenit 29 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të pikës III/3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ndërsa fondi i kontigjence parashikohet për herë të parë filluar nga viti 2017 dhe në vijim. Ndryshe nga sa më sipër, fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, ka filluar nga viti 2020. Nga Bashkia Mallakastër në buxhetin e vitit 2024 është parashikuar fondi i rezervë në vlerën **13,635,879** lekë.

Në VKB nr. 64 datë 21.12.2023 është miratuar për vitin 2024 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total **13.635.879** lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga granti në vlerën 0 lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- fondi kontigjencës nga granti në vlerën 0 lekë;
- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 2.500.000 lekë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 11.135.879 lekë.

Mbështetur në nenin 65 të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e veta vendore etj.

Gjatë vitit 2024 janë kryer pagesa për 2 familje me fondet e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për dëmtimet e banesave nga fatkeqësi të ndryshme. Fondi total ka qenë në shumën 2.441.322 lekë i ndarë :

1.XH.V – Djegie – 1.016.872 lekë

2.A.V – Djegie – 1.424.513 lekë.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF):

Në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet që:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katërmujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare.

Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Mallakastër administron raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2024 si vijon:

1. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të parë 2024 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 2494 prot datë 28.05.2024.
2. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të dytë 2024 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 4821 prot datë 26.09.2024.
3. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të tretë 2024 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 528 prot datë 04.02.2025.

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emërimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2023	Vlera e paguar gjatë vitit 2024 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2024 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2024 (situata më 31.12.2024)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur më 31.12.2024
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta						
1	Detyrime për vendime gjyqësore	945.792	0	945.792	0	945.792
2	Detyrime për investime	3.978.037	0	3.978.037	0	3.978.037
3	Detyrime për shërbime	844.928	0	8144.928	0	844.928
4	Detyrime të tjera	4.651.012	0	4.651.012	0	4.651.012
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta						10.419.769
Detyrime te prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministrite e linjës)						0
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti						10.419.769

Bashkia Mallakastër më datë 01.01.2024, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 22,226,489 lekë. Nga kjo vlerë e përfshirë në planin e buxhetit vjetor të vitit 2024 nuk është parashikuar asnjë fond për likuidimin e këtyre detyrimeve përgjatë vitit 2024. Gjatë vitit 2024 është likuiduar vlera e detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore në vlerën 11,860,720 lekë, Më datë 31.12.2024, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën 22,226,489 lekë. Detyrimet e Bashkisë Mallakastër vijnë nga kontrata të mëparshme të trashëguara edhe nga ish-komunat të cilat kanë mungesa dokumentacioni ose kompanitë të cilat kanë kryer shërbimin nuk janë më aktive.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore:

Gjatë vitit 2024 në Bashkinë Mallakastër është protokolluar 1 vendime gjyqësore sipas tabelës në vijim të materialit.

Nr	Kreditore	Nr.Vendimit të gjykatës	Arsye pagesës	Vlera e detyrimit	Pagesat 2024	Vlera e mbetur
1.	RR.C	Nr.328 datë 30.11.2022	Dëmshperblim paga	241.400	241.400	0
2	R.Z		Dëmshperblim paga	1.255.444	1.255.444	0
3.	ZPE	Nr.309 datë 17.11.2022	Dëmshperblim	11.806.720	11.806.720	0
4.	A.N	Nr.235 datë 08.03.2024	Dëmshperblim paga	251.200	218.200	33.000

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 është shpenzuar vlera 13,521,720 lekë, nga e cila vlera 1,715,044 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 3 raste, ndërsa vlera 11,806,720 lekë për 1 rast i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore (dëmshpërblim për shpronësimet). Për sa trajtuar më sipër **vlera 1,715,044 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Mallakastër.** Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga

Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësi administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Shpjegoni sa investime keni patur nga granti (Ministritë e linjës etj.) për vitin 2024, cilat janë objektet e këtyre investimeve, vlera e kontratës, data e kontratës, vlera e financuar, vlera e pa financuar, operatori fitues (kontraktori), arsyet e mos likuidimit të të gjithë vlerës. Pasqyruar ne Aneksin nr. 7, pika 2, bashkëlidhur.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Për vitin 2024 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 10, datë 29.12.2023, “Për miratimin e strukturës, organikës, kategorisë/klasave të pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2024”, ku përfshihet edhe struktura e sektorit të tatim- taksave, e cila përbëhet nga 5 punonjës me përbërje 1 përgjegjës, 4 specialistë.

Struktura e sektorit të tatim-taksave për vitin 2024 është paraqitur si më poshtë:

Në **Pasqyrën Aneks 1** më poshtë paraqitur struktura e sektorit të tatim-taksave për vitin 2024.

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Urdhri i emërimit Nr. , datë
1.	A.M.	Përgjegjës sektori	Kontabilitet Finance, Master Profesional	Datë 05.04.2018
2.	A.XH.	Specialist	Administrim Biznesi, Master Shkencor	Datë 23.04.2007
3.	E.G.	Specialist	Administrim Biznesi, Master Profesional	Datë 08.08.2016
4.	L.D.	Specialist	Master Shkencor Financë	Datë 23.01.2023
5.	G.H.	Specialist	E mesme ekonomik	Datë 11.01.2021
6.	G. M.			

Burimi: Bashkia Mallakastër.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Me VKB nr. 56, datë 30.11.2023, është miratuar struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Mallakastër për vitin 2024.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Mallakastër parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Mallakastër për

vitin 2024 paraqitet në mënyrë analitike.

Pasqyruar në **Aneksin 3**, pika 2, “Planifikimet dhe arkëtimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024”, bashkëlidhur.

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore është në vlerën **411,045,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **178,197,935 lekë** ose në masën **43.4 %** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **232,847,065 lekë**.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- a. “Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura” është planifikuar në vlerën 13,506,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 15,461,224 lekë ose realizuar në masën 115%.
- b. “Tarifa për licencat e transportit” është planifikuar në vlerën 827,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 900,400 lekë ose realizuar në masën 109%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- a. “Tarifë Pastrimi” është planifikuar në vlerën 18,343,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 12,802,898 lekë ose realizuar në masën 70%.
- b. “Tarifë ndriçimi” është planifikuar në vlerën 6,642,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,138,466 lekë ose realizuar në masën 62 %.
- c. “Taksa mbi ndërtesën” është planifikuar në vlerën 38,703,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,460,338 lekë ose realizuar në masën 22%.
- d. “Taksë trualli” është planifikuar në vlerën 49,864,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 20,157,307 lekë ose realizuar në masën 40%.
- e. “Taksë toke” është planifikuar në vlerën 27,013,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,062,457 lekë ose realizuar në masën 37%.
- f. “Taksë table” është planifikuar në vlerën 2,606,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 884,050 lekë ose realizuar në masën 34%.
- g. “Taksa për hapsirat publike” është planifikuar në vlerën 25,468,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 334,900 lekë ose realizuar në masën 1%.
- h. “Taksë ndikimi në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 13,472,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 6,286,017 lekë ose realizuar në masën 47%.
- i. “Taksa e kalimit të pronësisë” është planifikuar në vlerën 25,172,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë ose realizuar në masën 0%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifavat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2024 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Mallakastër që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më

reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:**

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga sektori i tatim-taksave për vitin 2024 konstatohet se: Bashkia Mallakastër ka lidhur akt-marrëveshjen me Nr. 2552 prot, datë 25.05.2023 me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. Objekt i kësaj akt-marrëveshje është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve familjare.

Për vitin 2024 nuk janë mbajtur akt-rakordime midis Bashkisë Mallakastër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

Sektori i Tatim-Taksave ka dërguar faturat e arkëtimit Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A si mëposhtë:

1-Faturë arkëtimi datë 28.02.2024 periudha janar 2024 shuma e arkëtuar 1,475,769 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 58,218 lekë.

Shkresa Nr. 887 prot., datë 28.02.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

2-Faturë arkëtimi datë 12.03.2024 periudha shkurt 2024 shuma e arkëtuar 331,696 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 32,972 lekë.

Shkresa Nr. 1118 prot., datë 12.03.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

3- Faturë arkëtimi datë 16.04.2024 periudha Mars 2024 shuma e arkëtuar 115,107 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 68,511 lekë.

Shkresa Nr. 1755 prot., datë 16.04.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

4- Faturë arkëtimi datë 16.05.2024 periudha Prill 2024 shuma e arkëtuar 762,106 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 14,364 lekë.

Shkresa Nr.2345 prot datë 16.05.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

5- Faturë arkëtimi datë 13.06.2024 periudha Maj 2024 shuma e arkëtuar 795,458 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 27,560 lekë.

Shkresa Nr. 2887 prot datë 13.06.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

6- Faturë arkëtimi datë 10.07.2024 periudha Qershor 2024 shuma e arkëtuar 742,231 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 37,188 lekë.

Shkresa Nr. 3360 prot datë 10.07.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

7- Faturë arkëtimi datë 27.08.2024 periudha Korrik 2024 shuma e arkëtuar 891,344 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 45,360 lekë.

Shkresa Nr. 4200 prot datë 27.08.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

8- Faturë arkëtimi datë 10.09.2024 periudha Gusht 2024 shuma e arkëtuar 857,553 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 88,799 lekë.

Shkresa Nr. 4400 prot datë 10.09.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

9- Faturë arkëtimi datë 11.10.2024 periudha Shtator 2024 shuma e arkëtuar 741,128 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 55,943 lekë.
Shkresa Nr. 5125 prot datë 11.10.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

10- Faturë arkëtimi datë 03.12.2024 periudha Tetor 2024 shuma e arkëtuar 820,208 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 41,640 lekë.
Shkresa Nr. 5611 prot datë 11.11.2023 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

11- Faturë arkëtimi datë 03.12.2024 periudha Nëntor 2024 shuma e arkëtuar 750,936 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 55,288 lekë.
Shkresa Nr. 5877 prot datë 03.12.2024 me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

Bashkia Mallakastër referuar ligjit Nr.112/2016 datë 03.11.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 47 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” shpreh “Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme: a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

DRSHTRR Fier në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Mallakastër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Mallakastër.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2024 paraqiten si më poshtë:
Në **Pasqyrën Aneks 3** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet nga agjentët tatimorë për vitin 2024.

Agjenti Tatimor	Lloji I Taksës ne total	2023 plan	Fakt 2023	2024 Plan	2024 Fakt
UKF	Pastrim ,gjelberim,ndricim,ndertes truall	7,830,414	1,413,774	8,652,788	13,892,962

Burimi: Bashkia Mallakastër

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 1, datë 18.05.2020, në nenin 40 të rregullores pika 4 detyrat e përgjegjës të sektorit përcaktohet se “përgjegjësi i sektorit të tatim-taksave është personi përgjegjës për kryerjen e akt rakordimeve me strukturat përkatëse të Bashkisë dhe agjentëve tatimor, të cilat i paraqet më pas për miratim tek drejtori.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë më përgjegjësi përgjegjës in e sektorit të tatim taksave z.A.M.

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Sektori i tatim-taksave nuk ka hartuar regjistrin e familjarëve sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj.

Bashkia Mallakastër disponon vetëm regjistrin elektronik për tatimpaguesit familjar për të cilët regjistrohet ngarkesa sipas paketës fiskale për vitin 2024 dhe pagesat e kryera prej tyre.

Duke mos pasur regjister fizik për abonentët familjarë kemi risk të lartë për vërtetësinë e të dhënave.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Mallakastër ka lidhur akt-marrëveshje me Nr.2552 prot., datë 25.05.2023 me “Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A” me objekt kontrate mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve familjarë (taksë ndërtesë, tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndriçimi publik).

Sipas informacionit të përcjellë nga sektori i tatim-taksave regjistri elektronik në të cilin disponohet databaza e abonentëve familjarë përbëhet nga abonentë vetëm qyteti Ballsh.

Sipas nenit 6 “të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 1 Bashkia Mallakastër ka detyrimin të depozitojë pranë agjentit tatimor listën e plotë të kryefamiljarëve, së bashku me nivelin e taksave dhe tarifave vendore sipas llojit të tyre, pika 2 ka detyrim për të paraqitur në fund të çdo muaj pranë agjentit tatimor, ndryshimet që do të pësojë lista.

Konstatim: Bashkia Mallakastër ka vepruar në kundërshtim me aktmarrëveshjen Nr.2552 prot., datë 25.05.2023 neni 6 sepse sektori i tatim taksave nuk përcjell listat e azhornuara tek agjenti tatimor çdo muaj por informacioni për ndryshimet e data-bazës e merr nga vetë agjenti tatimor.

Në **Pasqyrën Aneks 4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas njësisive administrative për taksat dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor 2024 si vijon:

Në tabelën e mëposhtme gjendet informacion për detyrimet e abonentëve familjarë në njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër dhe qytetin e Ballshit vetëm për taksën bujqësore, taksën e truallit dhe taksën e ndërtesës.

Njësitë administrative nga sektori i tatim-taksave nuk ju faturohet detyrimi sipas paketës fiskale për tarifave vendore të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Debitorët familjarë për qytetin e Ballshit për vitin 2024 nuk janë rakorduar me Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Fier dhe për vitin 2024 nuk kemi informacioni për debitorët e krijuar gjatë vitin 2023 por vetëm vlerën e mbartur nga viti i mëparshëm.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2024 për mos pagesën e detyrimeve tatimore për vitet e mëparshme nuk kemi informacion nga ana e Bashkisë Mallakastër dhe nuk mund të dalim më vlerë detyrimesh për abonentë familjarë. Për vitin 2024 vlera debitore në shumën **91,930,023 lekë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër**, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2024. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Sipas VKB nr. 56, datë 30.11.2023 për miratimin e paketës fiskale për Bashkinë Mallakastër është përcaktuar si më poshtë për tarifave për familje:

Nr	Njësia Administrative	Lloji i tarifës në lekë/familje/vit		
		Tarifë pastrimi	Tarifë gjelbërimi	Tarifë ndriçimi
1	NJA Ballsh	2,000 lek/vit	500 lek/vit	1,000 lek/vit
2	Njësiti e tjera	1,000 lek/vit	250 lek/vit	500 lek/vit

Burimi:Bashkia Mallakastër

Për abonentët e qytetit Ballsh është përcaktuar agjent tatimor “Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA” e cila i tarifon abonentët sipas paketës fiskale në faturën mujore të ujit.

Nga informacioni i përcjell nga sektori i tatim-taksave nga 2,244 familje në njësinë Ballsh tarifohen vetëm 1,363 abonentë familjarë. Abonentët familjarë të përjashtuar nga tarifat sipas paketës fiskale i përkasin kategorive të kryefamiljarëve të parashikuara në paketën fiskale.

Konstatim: Për njësiti e tjera administrative sipas paketës fiskale janë përcaktuara nivelet e tarifave për abonentët familjarë sipas tabelës së mësipërme. Sipas regjistrave për njësiti administrative nr i familjeve të njësive administrative është 7,248 familje të cilat nuk janë tarifuar për vlerën 7,248,000 lekë për tarifën e pastrimit për të cilën ofrohet shërbimi nga Bashkia Mallakastër. Tarifa e gjelbërimit dhe e ndriçimit nuk ofrohet si shërbim nga Bashkia Mallakastër dhe abonentët nuk janë tarifuar për këto shërbime.

Nga sektori i tatim taksave nuk janë tarifuar tarifat për njësiti administrative si Në **Pasqyrën 4, Pika 2**, “Numri i familjeve të patarifuar për tarifën e pastrimit dhe detyrimi”, bashkëlidhur.

➤ **Taksa e tokës, ndërtesës dhe truallit:**

Bashkia Mallakastër për vitin 2024 ka parashikuar të mbledhë të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 27,013,000 lekë. Nga informacioni që na është përcjellës nga sektori i tatim taksave kemi informacion për sipërfaqen totale që ju është ndarë 7,248 familjeve konkretisht 12,835.83 ha.

Realizimi i kësaj taksë për vitin 2024 është në vlerën 10,062,457 lekë ose 37% e totalit të parashikimit..

Pasqyruar në **Aneksin Aneks 5, pika 2**, “Informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Mallakastër”

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Mallakastër kryhet në programin Excel. Sektori i tatim-taksave kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësiti administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Mallakastër i administron në excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Referuar të dhënave të marra nga DTV Bashkia Mallakastër, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Në Pasqyrën Aneksi nr. 7. Rregjistri i biznesit Bashkia Mallakastër

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2024	379	27	21	385
2	Biznesi Madh	2023	66	7	1	72
3	Institucione	2024	19	0	0	19
(1+2)	Gjithsej	2024	464	34	22	476

Burimi: Bashkia Mallakastër

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **1,137,692,159 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet në **Pasqyrën Aneksi nr. 8** si vijon.

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet në **Pasqyrën Aneksi nr. 8** si vijon.

Nr.	Loji i bizneseve	DETYRIMET		
		Viti 2024		
		Nr.sub	Detyrime 31.12.2023	Detyrime 31.12.2024
1	Biznes i vogël	123	8,985,573	10,807,281
2	Biznes VIP	7	1,074,888,444	1,101,947,623
3	Biznes i madh	30	11,207,733	12,048,694
4	Institucione	4	12,319,950	12,888,561
	Shuma	164	1,107,401,700	1,137,692,159

Burimi: Bashkia Mallakastër

Sa me sipër dalim në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Mallakastër, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Sipas VKB Nr.56, datë 23.11.2023 është miratuar paketa fiskale e Bashkisë Mallakastër ku janë përcaktuar taksat dhe tarifatat për abonentët familjarë dhe privatë.

Në **Pasqyrën Aneksi nr. 9** paraqiten bizneset e mëdha të cilat nuk janë tarifuar sipas paketës fiskale gjenden në tabelën mëposhtë:

Nr	Nipti	Subjekti	Tarifa e Pastrimit
1	K	A	60,000
2	K	A	60,000
3	K	A	50,000
4	L	E	60,000
5	J	O	50,000
6	K	XH	60,000
7	K	U	70,000
Total			410,000

Mostarifimi i biznesit të madh për tarifën e pastrimit është kryer në kundërshtim me VKB Nr. 56, datë 23.11.2023 sepse shërbimi i pastrimit kryer në të gjithë territorin e Bashkisë Mallakastër.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Mallakastër në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës

Debitorë nga vitet e mëparshme për taksën e infrastrukturës janë në vlerën 9,884,679 lekë

Në **Pasqyrën Aneksi nr. 10** paraqiten të dhëna për taksën e infrastrukturës për vitin 2024:

Periudha	Nr. I lejeve te legalizimit	Sip. totale e ndertimit (m ²)	Vlera e investimit (leke/m ²)	Vlera e taksës (leke) (0.5% e vl. Investimit)	Vlera e debis per 2024
Deri 31.12.2023	46	10555.3	31597	1668149	
Deri 31.12.2024	18	3805.1	31597	585396	9884679
Shuma	64	14360.4	31597	2253545	

Burimi:Bashkia Mallakastër

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Mallakastër për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Mallakastër të jetë drejtuar ASHK Dega Mallakastër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,”, indryshuar me ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme

për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe në Njësitë Administrative, ushtrojnë aktivitetin 9 subjekte të tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Në Pasqyrën Aneksi nr. 13 paraqiten: **Kontratat e Subjekteve që tregtojnë hidrokarbure**

N r	Subjekti	Nipt	Afati I autorizimit		Detyrimi per autorizimin	Pagesat e kryera	Detyrimi për vitin 2024
			Fillimi	Mbarimi			
1	N	J	23.07.2024	23.07.2029	1,000,000	1,000,000	-
2	L	J	07.10.2021	06.10.2026	1,000,000	1,000,000	-
3	N	J	07.03.2023	07.03.2028	1,000,000	1,000,000	-
4	K	J	14.08.2024	1308.2025	200,000	200,000	-
5	E	J					
6	SH	K	10.07.2023	09.07.2028	1,000,000	1,000,000	-
7	B	K					
8	BP	K					
9	O	J	21.04.2022	20.04.2027	1,000,000	1,000,000	-
	Total				5,200,000	5,200,000	

Burimi: Bashkia Mallakastër

1.BP Sh.P.K me adresë L.Povel-Damës, Mallakastër, subjekt i cili ka qënë i pajisur me autorizim 5 vjeçar të cilit i ka mbaruar afati në datë 19.09.2022. Subjekti B.P shpk kosntatohet se ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 19.09.2022-31.12.2024 duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 266,680 lekë për vitin 2022 janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 66,680 lekë dhe 200,000 lekë për vitin 2023.Për këtë subjekt nuk është marrë asnjë masë nga ana e Bashkisë Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk ka marrë masa shtrënguese, ndaj subjektit të mësipërm

2.B Sh.P.K me adresë Hekal, Mallakastër, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

3.E Sh.P.K me adresë Belishovë, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë. Për licencimin e këtij subjekti, i cili ka ushtruar aktivitet pa licencë nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Mallakastër e cila duhet t’i drejtohej ISHTI-t për bllokim të aktivitetit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për marrje masash si rrjedhojë e mosveprimit të strukturës në varësi të saj. Gjithashtu Sektori i të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake nuk kanë marrë masa shtrënguese ndaj subjektit të mësipërm.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi A.M, Përgjegjës Sektori i Tatim -Taksave.

-Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2023) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 3 subjekte për 3 stacione shitje të karburantit nuk kanë aplikuar për rilicencim/nuk kanë kryer

pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën 600,000 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.
- 2) VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.
- 3) VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 ku citohet:

15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi komisioni për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënproduktet e saj sipas shkresës nr 1685 prot datë 26.06.2020.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër, **z. A.M** me detyrë Përgjegjës Sektori i Tatim-Taksave, **z. A.XH, z. E.G, z. G.H, znj. L.D** me detyrë specialist pranë Sektorit të Tatim-Taksave, **z. M.M** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve dhe **z. L.SH** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve dhe Mjedisit.

Për sa trajtuar në Aktkonstatimin nr. 3, datë 16.02.2024, është paraqitur observacion me shkresën nr. 190/29, datë 25.04.2025, marrës KLSH me nr. 85/5, datë 28.04.2025 dhe në rrugë elektronike, nga personat e atakuar.

Observacion: Përsa i përket detyrimeve familjare për qytetin e Ballsh dhe për të gjitha njësitë Administrative ne disponojmë rregjistra elektronik dhe rriegjistra fizik të cilat i protokollojmë në zyrën e protokollit pranë bashkisë në cdo fillim vit dhe në cdo fundvit për arsye të përpunimit dhe njoftimit të cdo familje debitore dhe jo debitore, në cdo njoftim familjarë ka numër protokollit të vecant sipas regjistrit të protokolluar pranë Bashkisë. Rakordimi i fundvitit 2024 me UKF për arsye objektive nuk është kryer nga ana e UKF por në një kohë shumë të shkurtër do të kryhet sic është kryer edhe vitet e kaluara.

Bazuar në paketën fiskale me nr.56 datë 30.11.2023 si dhe në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar neni 35, dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 17 i tij, këto tarifa do të aplikohen në njësit dhe nënndarjet e tyre ku ofrohen shërbimet nga Bashkia Mallakastër

Fshatrat ku nuk janë aplikuar tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndricimit si më poshtë:

Në këto fshatra nuk janë aplikuar tarifat për arsye sepse nuk ofrohet shërbim.

Bashkia Mallakastër me Ujësjiellës Kanalizime fier ka vepruar sipas aktmarrëveshjes me nr.2552 datë 25.05.2023 për listat e azhornuara tek agjenti ka vepruar në bazë të emaileve të nisuar sepse ka pasur ndryshime vazhdimisht për arsye të përfitimit nga lehtësirat fiskale të parashikuara sipas paketës të miratuar nga keshilli Bashkiak që janë famijet e dëshmorëve pensionistët ndihmat ekonomike ,pensionistet e vetmuar invalidet, dhe për këte arsye është bërë rakordimi cdo muaj me punonjësen e UKF.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Observacioni do të pranohet dhe do të bëhen ndryshimet përkatëse në Projekt-Raport.*

Observacion: *Në realizimin e detyrave në si sektor i tatim taksave kemi përgatitur njoftimet për taksën e tokës bujqësore për të gjithë familjet që janë trajtuar me tokë në bazë të ligjit 7501 datë 01.08.1991, në total janë përgatitur 7241 njoftime dhe janë shpërndarë në çdo familje në territorin e Bashkisë Mallakastër.*

Nga të ardhurat e tokës bujqësore është mbledhur shifra prej 10,062,457 (Dhjetë milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë lekë)

Tabelat krahasuese për çdo fshat ,përqindja e realizimit krahasuar me ngarkesën e vitit dhe pagesën.

Për sa i përket realizimit prej 37% një nga arsyet është emigrimi dhe migrimi i banorëve, ne kemi shpërndarë njoftimet në çdo familje dhe kemi hasur vështirësi në gjetjen dhe verifikim e kryefamiljarëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Referuar nenit 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar, observacioni nuk merret parasysh.*

Observacion: *Nga auditimi i kryer ,përsa i përket borxhit të biznesit 1.243.000.681 në si sektor kemi kryer njoftimet dhe letër kujtesa përkatëse për të gjithë debitorët,më herët kemi bërë dhe urdhër bllokimi të llogarive bankare.*

Por, kjo shifer në një masë të madhe prej gati 78% vjen nga biznes vip A e cila është mbyllur ,A etj...

Kompanitë e naftës të cilat janë larguar ose mbyllur.

*-Shifra totale e subjekteve të naftës të cilat janë të mbyllura është **969.635.461** (nëntëqind e e gjashtëdhjetë e nentë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një)lekë .*

-Mos tarifimi i biznesit të madh për tarifen e pastrimit që është kryer në kundërshtim më vkb 56. Datë 30.11.2023 sipas raportit tuaj, nuk qëndron për arsye sepse në adresat kryesore ku ushtrohet aktiviteti nuk ofrohet shërbimi i pastrimit për 6 subjekte.

-Kurse subjekti UB nuk ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Mallakastër por paguan taksën e pronës dhe taksën e truallit për pronën e sekuestruar nga ana e bankës.

Subjektet sipas pasqyrës në aneksin nr.9 të cilat janë tarfuar nga sektori i tatim-taksave janë:

Janë bërë letërkujtesa për bizneset debitore dhe urdhër bllokime po për këto subjekte të cilat nuk kanë lejuar detyrimet të cilat lindin nga ushtrimi i aktivitetit në Bashkinë Mallakastër.

Realizimi në përqindje për bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë mallakastër,realizimi në përqindje krahasuar me ngarkesën e vitit dhe pagesën.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për sa i përket borxhit në vlerën 1,243,000,681 lekë nga biznesi i madh, referuar nenit 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar, observacioni nuk merret parasysh.*

Në lidhje me ankesin nr. 9, observacioni do të merret parasysh dhe do të bëhen ndryshimet përkatëse në Projekt/Raport.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

3.4. Auditim mbi administrimin e asetëve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Mallakastër për vitin 2024 (të cilat përfshijnë pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2024 të Bashkisë Mallakastër) janë të nënshkruara nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Mallakastër me shkresën nr. 1132 prot., datë 12.03.2025, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Mallakastër për aktivitetin ekonomik-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Mallakastër, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
Aktiviteti Neto janë të barabarta me Aktivitet - Pasive = Aktiviteti Neto		1,972,920,589
Aktiviteti		3,240,437,695
Pasiviteti		1,267,517,106
Aktiviteti Neto		1,972,920,589

		Lekë
Aktiviteti Afatshkurtra më datë 31.12.2024		1,505,070,730
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”		255,216,408
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		88,810,165
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		1,160,832,309

A. AKTIVET

I. Aktivitet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

		Lekë		
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	255,216,408	193,554,879	61,632,477
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	211,848	240,900	(29,052)
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		255,428,256	193,795,779	32,149,283

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 193,554,879 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 255,216,408 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 148,531,611 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 106,684,797 lekë. në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 49 dhe pika 50.

Llogaria 532 “Vlera të tjera” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 240,900 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 211,848 lekë e cila i përket biletave të tregut gjendje në magazinë.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023
31	Materiale	45,866,445	28,874,065
32	Inventar i imët	42,943,720	39,535,287
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0
34	Produkte	0	0
35	Mallra	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0
Totali		88,810,165	68,409,352

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 88,810,165 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 45,866,445 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 42,943,720 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 20,400,813 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 14,366,981 lekë.

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë të ndryshëm	1,116,875,551	61,697,234	1,055,178,317
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	33,536,989	28,708,429	4,828,560
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		1,150,412,540	90,405,663	1,060,006,877
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	10,419,769	10,419,769	0
Totali		10,419,769	10,419,769	0

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 61,697,234 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 1,116,875,551 lekë me një rritje në vlerën 1,055,178,317 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	61,697,234
Shtesa (K)	1,058,845,212
Pakësime (D)	3,666,895
Gjendja debitore në 31.12.2024	1,116,875,551

Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 28,708,429 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 28,708,429 lekë me

një pakësim në vlerën 4,113,204 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)		Lekë
Çelje e vitit 2024		28,708,429
Shtesa (K)		4,828,560
Pakësime (D)		
Gjendja debitore në 31.12.2024		33,536,989

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 10,422,499 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,419,769 lekë. Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është paraqitur në vlerën 10,419,769 lekë veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" ku përcaktohet që:

Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruara sipas pikës 6 (b) të këtij udhëimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin llogarinë kontabël 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2024, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këtë llogari në datën 31 Dhjetor 2024.

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2024 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"		Lekë
Çelje e vitit 2024		10,422,499
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		10,422,499

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Lekë	
		31.12.2024	31.12.2023
	II. Aktive Afatgjata	1,735,366,965	2,196,033,058
20	I. Aktive Afatgjata jo materiale	80,104,551	60,557,883
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0
202	Studime dhe kërkime	80,104,551	60,557,883
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0

21	2. Aktive Afatgjata materiale	1,655,262,414	1,426,811,532
210	Toka, Troje, Terene	309,970	309,970
211	Pyje, Plantacione	8,560,400	8,560,400
212	Ndërtesa e konstruksione	664,969,355	681,932,016
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	930,913,757	686,005,923
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	20,274,458	15,412,910
215	Mjete transporti	19,461,328	24,303,742
216	Rezerva shtetërore	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0
218	Inventar ekonomik	10,773,146	10,286,571
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0
	4. Investime	0	689,116,975
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	19,546,668
231	Për Aktive Afatgjata materiale	0	669,570,307

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 80,104,551 lekë. Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur shtesa, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 80,104,551 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyret në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur projektraportiti të auditimit.

Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit” në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohej në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

Nga auditimi konstatohet se, për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” nuk është përlllogaritur normë amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 66-69, dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 2, klasa 2 “Trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale”, gërma “d”, pika 36, “Për aktive afatgjata jo materiale, amortizimit të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimit 15%” ku përcaktohet që:

66. Një AAJM do të paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

67. Një njësi ekonomike duhet të shpërndajë shumën e amortizueshme të një aktivi jomaterial në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si

një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi tjetër.

68. Amortizimi fillon kur aktivi jomaterial është i disponueshëm për përdorim, p.sh. kur ai është në vendin dhe në kushtet e domosdoshme për të qënë i përdorshëm sipas mënyrës së menduar nga drejtuesit. Amortizimi pushon kur aktivi ç’regjistrohet.

69. Njësia ekonomike do të zgjedhë një metodë amortizimi që pasqyron modelin me të cilin ajo pret të konsumojë përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivitetit. Nëse njësia ekonomike nuk mund ta përcaktojë këtë model të besueshëm, ajo do të përdorë metodën lineare.

2. Aktivitet Afatgjatë Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2024, ka qënë në vlerën 309,970 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 309,970 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		309,970
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		309,970
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		309,970
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		309,970

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2024, ka qënë në vlerën lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		8,560,400
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		8,560,400
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		8,560,400
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		8,560,400

-Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” më datë 01.01.2024, ka qënë në vlerën 681,932,016 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 664,969,355 lekë e analizuar sipas inventarit kontabël.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2024, ka qënë në vlerën 686,005,923 lekë. ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 930,913,757 lekë e analizuar sipas inventarit kontabël.

a. Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 718,330,558 lekë kosto historike është përfshirë vlera 653,605,722 lekë për 146 objekte e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në

informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

b. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 708,932,190 lekë kosto historike është përfshirë vlera 322,013,137 lekë për 143 objekte e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30.

Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se, janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 62,500,417 lekë në Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sh.a (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër. Nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Mallakastër dhe UKM Sh.a. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Mallakastër për Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër Sh.a për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

Lekë

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike)	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Objekte inventari				
Ujësjetllësi Kutës	115,939	0	0	92,751
Ujësjetllësi 5 fshatrave Fratar	682,837	0	0	546,270
Rikonstrukcion rrjeti i Ujësjetllësit Ballsh	2,692,344	0	0	2,153,875
Ujësjetllësi Rromës	112,189	0	0	89,751
Rrejrti i brendshëm i fshatrave Fratar	4,062,398	0	0	3,249,918
Ndërtim KUZ Lagja Bylis Ballsh	30,156,029	0	0	24,124,823
Ndërtim Ujësjetllësi Rajonal Mallakastër	40,303,786	0	0	32,243,029
Totali	62,500,417	0	0	62,500,417

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 15,412,910 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 20,274,458 lekë. Analiza e detajuar e analizuar sipas inventarit kontabël.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 24,303,742 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 19,461,328 lekë. e analizuar sipas inventarit kontabël.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 10,286,571 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,773,146 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 34,640,004 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër me Nipt K47605804N është 621,858,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier me Nipt M23315402G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër 34,640,004 lekë ose 5.49% ($5.49 \cdot 621,858,000 / 100 = 34,640,004$ lekë). Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Bylis me Nipt L18407801Q është 2,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër është 500,000 lekë ose 25% ($25 \cdot 2,000,000 / 100 = 500,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më

datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivitet afatgjatë materiale dhe aktivitet afatgjatë jomateriale*” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, ku përcaktohet që:

55. Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse:

- (a) është e mundur që nga përdorimi i aktivitet do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike;
- (b) kostoja e aktivitet mund të matet me besueshmëri
- (c) aktivitet nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda njësisë ekonomike për një zë jomaterial.

56. Një aktiv jomaterial i blerë në një kombinim biznesi njihet zakonisht si një aktiv, sepse vlera e drejtë e tij mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme. Megjithatë, një aktiv jomaterial i blerë në një kombinim biznesi nuk njihet kur ai rrjedh nga të drejta ligjore ose kontraktuale dhe vlera e drejtë e tij nuk mund të matet në mënyrë të besueshme pasi aktivitet ose: (a) nuk është i ndashëm nga emri i mirë, ose (b) është i ndashëm nga emri i mirë, por nuk ekziston ndonjë histori apo evidencë e transaksioneve për aktive të njëjta ose të ngjashme, dhe si rrjedhim vlerësimi i vlerës së drejtë do të ishte i varur nga variabla të pamatshëm.

57. Një njësi ekonomike mat fillimisht një aktiv jomaterial me kosto.

27. Një investitor në një pjesëmarrje do të japë informacionet shpjeguese në vijim:

- (a) politikën e tij kontabël për investimet në pjesëmarrjet,
- (b) vlerën kontabël neto të investimeve në pjesëmarrje.

28. Për investimet në pjesëmarrje të kontabilizuara sipas modelit të kostos, një investitor do të japë informacion shpjegues për shumën e dividendëve dhe shpërndarjet e tjera të njohura si të ardhura.

29. Për investimet në pjesëmarrje të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit, një investitor do të japë informacion shpjegues veçmas për pjesën e vet në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjeve, dhe pjesën e tij në aktivitetet e ndërprera të pjesëmarrjeve, nëse ka të tilla. Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta.

30. Një investitor në një sipërmarrje të përbashkët do të japë informacion shpjegues për:

- (a) politikën kontabël që ka përdorur për njohjen e interesave të tij në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht,
- (b) vlerën kontabël neto të investimeve në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht.
- (c) shumën totale të angazhimeve të tij në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta, duke përfshirë pjesën e tij në angazhimet e kapitalit që janë bërë së bashku me sipërmarrësit e tjerë, si edhe pjesën e tij të angazhimeve të kapitalit të vetë sipërmarrjeve të përbashkëta.

4. Invenstimet

-Llogaria 230 “Për aktivitet afatgjatë jo materiale” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 19,546,668 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

-Llogaria 231 “Për aktive afatgjatë materiale” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 669,570,307 lekë. ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,552,806	3,489,713
42	Detyrime ndaj personelit	20,599,254	18,144,668
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0
460	Huadhënës	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,485,398	698,822
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0
435	Sigurime shoqërore	6,542,170	5,330,767
436	Sigurime shëndetësore	902,021	734,579
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	106,684,797	94,675,833
467	Kreditorë të ndryshëm	11,875,109	10,729,649
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	1,116,875,551	61,663,958
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	2,552,806	3,489,713
Gjendje në fund të periudhës		1,267,517,106	195,467,989

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datë 01.01.2024, është në vlerën 3,489,713 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Mallakastër, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,552,806 lekë.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera **20,599,254** lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”		Lekë
Çelje e vitit 2023		18,144,668
Shtesa (K)		2,454,586
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2023		20,599,254

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,485,398 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”		Lekë
Çelje e vitit 2023		698,822
Shtesa (K)		786,5760
Pakësime (D)		
Gjendja debitore në 31.12.2023		1,485,398

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 6,542,170 lekë dhe 902,021 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”		Lekë
Çelje e vitit 2024		5,330,767
Shtesa (K)		1,211,403
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		6,542,170
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”		Lekë
Çelje e vitit 2024		734,579
Shtesa (K)		167,442
Pakësime (D)		0

Gjendja debitore në 31.12.2024	902,021
--------------------------------	---------

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 106,992,906 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Mallakastër. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur projektraportin e auditimit.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”		Lekë
Çelje e vitit 2024		94,675,833
Shtesa (K)		15,832,329
Pakësime (D)		3,823,356
Gjendja debitore në 31.12.2024		106,992,906

Lekë

Për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Mallakastër janë ngurtësuar fonde në vlerën 39,937,791 lekë për të cilat nuk është bërë zhblokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Mallakastër, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 39,937,791 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10, ku përcaktohet që:

<p>Pika 29. Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.</p> <p>Pika 30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet.</p> <p>Pika 39. Këto pasqyra i’u dërgohen njësisive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të 10 njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjeneruara nga SIFQ-i.</p> <p>Pika 50. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).</p> <p>Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.</p>
--

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 10,729,649 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,455,340 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 11,875,109 lekë. Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk janë kontabilizuar detyrimet në vlerën 3,977,574 lekë e cila i përket detyrimeve mbi shpronësimet. Kjo problematikë është kontaktuar edhe në auditimin e mëparshëm nga KLSH por nga Drejtoria e Financës dhe çështjeve Sociale nuk janë marrë masat e duhura për kontabilizimin e këtij detyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, si më poshtë:

Lekë		
Nr.	Pronari	Vlera e mbetur e palikuiduar deri në 31.12.2023
1	I.H	449,920
2	V.M	1,337,106
3	V.M	1,581,750
4	V.M	608,798
Totali		3,977,574

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, funksionimi kontabël i llogarive të Klasës 4. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneksin nr. 3, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Lekë	
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	10,729,649
Shtesa (K)	1,455,340
Pakësime (D)	
Gjendja kreditore në 31.12.2024	11,875,109

a. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 2,552,806 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2024 janë në vlerën 11,875,109 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 85, pika 2 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 82-91.

-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 1,116,640,480 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”	
Çelje e vitit 2024	61,663,958
Shtesa (K)	1,058,643,417
Pakësime (D)	3,666,895
Gjendja debitore në 31.12.2024	1,116,640,480

Lekë			
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	1,972,920,589	2,363,595,632
D	FONDI I KONSOLIDUAR	1,972,920,589	2,363,595,632
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,824,388,978	2,314,698,240
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	148,531,611	48,897,392
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0

15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime		0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	3,240,437,695	2,559,063,621

Lekë

Fondi i konoliduar	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"			
1,972,920,589	Mbyllje më datë 31.12.2024		Çelje më datë 01.01.2024	
	Debi		Kredi	
			2,314,698,240	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2024
	35,780,422	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	339,122,460	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	186,551,053	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	14,366,981	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	222,331,475		2,668,187,681	
2,668,187,681-222,331,475 = 2,445,856,206				
2,445,856,206-1,972,920,589=472,935,617				

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,314,698,240 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 339,122,460 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 14,366,981 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 35,780,422 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 186,551,053 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është në vlerën 472,935,617 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17, ku përcaktohet që:

<p>17. Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar (bilancit) ndiqet procedura e mëposhtme:</p> <p>a) Llogaria 101 e klasës 1 funksionon si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga: <input type="checkbox"/> grantet kapitale për aktivet afatgjata të blera dhe të kapitalizuara; <input type="checkbox"/> grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata; <input type="checkbox"/> rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata; <input type="checkbox"/> anulimet e detyrimeve për t'u paguar; si dhe <input type="checkbox"/> të tjera. <p>b) Debitohet për pakësimet në fondet bazë që vijnë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuara me koston historike të blerjes së tyre <input type="checkbox"/> nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata; <input type="checkbox"/> transferimet e dhurimet e aktiveve afatgjata;

- konsumi i aktiveve afatgjata;
- rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe
- anulimet e të drejtave për t'u arkëtuar;
- të tjera.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 123,634,761 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 118,701,425 lekë ose me një ulje në vlerën 4,933,336 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	118,701,425	123,634,761
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	198,401	84,760
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	198,401	84,760
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	38,680,102	18,899,382
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	38,680,102	18,899,382
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	79,822,922	104,650,619
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	79,822,922	104,650,619
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksë kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 41,459,981 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,395,557 lekë ose me ulje në vlerën 12,064,424 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	29,395,557	41,459,981
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	5,504,162	14,173,480
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	5,504,162	14,173,480
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	23,891,395	27,286,501
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	13,758,154	9,640,519
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	4,855,997	8,320,419
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	62,000	0
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	5,215,244	9,325,563
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Grante korente:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 657,943,343 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 773,769,476 lekë ose me një ritje në vlerën 115,826,133 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2023
72	V. GRANTE KORENTE	773,769,476	657,943,343
720	1. Grant korent i brendshëm	773,769,476	657,943,343
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	307,665,053	226,797,136
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	379,181,771	370,319,572
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	27,359,074	26,465,779
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	30,984,183	28,000,700
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	28,579,395	6,360,156
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
7211	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

4. Të ardhura të tjera:

-Llogaria “Të ardhura të tjera”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 16,946,581 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 55,476,580 lekë ose me një ritje në vlerën 38,530,003 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	VI. TË ARDHURA TË TJERA	55,476,580	16,946,581
781	Të ardhura nga investimet në ekonomi	0	0
782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatshkurtra	0	0
783	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatgjata	0	0
784	Rimarrje shumash për shpenzime të viteve ardhshme	0	0
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve	55,476,580	16,946,581

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 259,235,879 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 279,405,394 lekë ose me një rritje në vlerën 20,169,515 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 43,282,335 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 46,719,605 lekë ose me një rritje në vlerën 3,437,270 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	279,405,394	259,235,879
602	Paga personel i përkohshëm	0	0
603	Shpërblime	0	0
609	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	41,887,106	41,356,645
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	4,832,499	1,925,690
	Totali	326,124,999	277,267,830

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 88,533,205 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 88,750,706 lekë ose me një shtim në vlerën 217,501 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit

Mallakastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	88,750,706	88,533,205
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,419,211	2,775,464
6021	Materiale dhe shërbime speciale	6,596,869	6,944,029
6022	Shërbime nga të tretë	29,342,662	17,473,323
6023	Shpenzime transporti	24,045,379	27,037,306
6024	Shpenzime udhëtimi	603,900	743,956
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	10,760,700	12,451,847
6026	Shpenzime për qiramarrje	42,500	272,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	2,938,081	4,998,640
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	12,001,404	15,836,640

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Mallakastër nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 385,356,331 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 218,298,345 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	V. TRANSFERIME KORENTE	385,356,331	393,645,699
604	1. Transferita korente të brendshme	167,057,986	139,416,851
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	0	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	163,533,167	133,504,957
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	3,524,819	5,911,894
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për qeveritë e huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	218,298,345	254,228,848
6060	Transferita të paguara nga ISSH e ISKSH	2,649,741	273,213
6061	Transferita të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	215,648,604	253,955,635

4. Shpenzime financiare:

-Llogaria **66 “Shpenzime Financiare të jashtme”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 6,390,156 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 28,579,395 lekë ose me një shtim në vlerën 22,189,239 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë shpenzime financiare paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2023
	VI. SHPENZIME FINANCIARE	28,579,395	6,390,156
65	1. Shpenzime Financiare të brendshme	0	0
650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte	0	0
651	Interesa për huamarrje të tjera Brendshme	0	0
652	Interesa Letra tjera vlerë Qeverisë	0	0
656	Shpenzime nga këmbimet valutore	0	0
66	2. Shpenzime Financiare të jashtme	28,579,395	6,390,156
660	Interesa për huamarrje nga Qeveri të Huaja	0	0
661	Interesa për financime nga Institucionet Ndërkombëtare	0	0
662	Interesa për huamarrje të tjera jashtme	28,579,395	6,390,156

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 962,976,061 lekë dhe totali shpenzimeve është 814,444,450 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 148,531,611 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 148,531,611 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet respektive të Këshillit Bashkiak.

Auditimi i Procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë, për periudhën nga data **01.01.2023**, deri më **31.12.2024**, paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 dhe periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB-në nr. 63, datë 21.12.2023, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026, të Bashkisë Mallakastër”.

Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB–ve përkatëse, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve ligjore të përcaktuara.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Mallakastër (regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve) si dhe të dhënave nga Sistemi i Prokurimit Elektronik të APP-së për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten si më poshtë:

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i prokurimeve për periudhën e auditimit 01.01.2024 deri 31.12.2024 rezultoi si më poshtë.

Në total, për periudhën e auditimit 01.01.2024 - 31.12.2024, janë realizuar **28 procedura** prokurimi me **vlerën limit të kontratës 265,624,840.8 lekë** pa TVSH dhe janë lidhur kontrata në vlerën **204,704,034 lekë** pa TVSH ose 77.06 % e fondit limit të kontratës, respektivisht të ndara, si vijon: sipas buxhetit dhe llojit të prokurime, rezulton:

- Janë realizuar **2** procedura prokurimi për investime publike me vlerën limit të kontratës **227,444,333.8** lekë pa TVSH dhe janë lidhur kontrata në vlerën **170,599,636.5** lekë pa TVSH ose **75 %** e fondit limit të kontratës.

- Janë realizuar **15** procedura prokurimi për blerje mallra me vlerën limit të kontratës **30,589,406** lekë pa TVSH dhe janë lidhur kontrata në vlerën **27,754,316** lekë pa TVSH ose **90.7 %** e fondit limit të kontratës.

- Janë realizuar **11** procedura prokurimi për shërbime me vlerën limit të kontratës **7,591,101** lekë pa TVSH dhe janë lidhur kontrata në vlerën **6,350,081** lekë pa TVSH ose **83.7 %** e fondit limit të kontratës.

Në mënyrë tabelore prokurimet e realizuara për Bashkinë Mallakastër, paraqiten në Anekset nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, pika 2.4, bashkëlidhur.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Në zbatim të kësaj pike të progarmit janë audituar procedura e prokurimit si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt “ **Ndërtimi i Shkollës “Gjokë Doçi”** ” zhvilluar në vitin 2024 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “ Ndërtimi i Shkollës Gjokë Doçi”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5, datë 08.05.2024.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 5, datë 08.05.2024. 1. B.F (Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. A.S (Inxhinier Ndërtimi) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 163, datë 08.05.2024. 1. L.S Anëtarë(Drejtor juridik/anëtar) 2. A.X, Anëtarë (Kryeinspe ktor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. N.N, Anëtar (Specialist jurist NSHP)
5. Fondi Limit: 159,811,598 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: BOE “RR.U.A” Shpk me vlerë oferte 105,635,461.4 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 54,176,137 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 28.06.2024.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 24 OE b) S’kualifikuar 12 OE: c) Kualifikuar: 12 OE 1. OE “RR.U.A” Shpk; 2. OE “N” Shpk; 3. BOE “G” Shpk& “K” Shpk;

		4. OE “S” Shpk; 5. OE “I” Shpk; 6. OE “SH” Shpk; 7. OE “EK” Shpk;; 8. OE “I” Shpk; 9. OE “AK” Shpk; 10. OE “S” Shpk; 11. OE “LK” Shpk; 12. OE “L” Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 2159/10 prot., datë 03.09.2024.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 125,995,451.19 lekë	Afati: 24 muaj

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtimi i Shkollës “Gjokë Doçi””, janë siguruar fonde në **vlerën totale 159,811,598 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, të miratuara me VKB-në nr. 63, datë 21.12.2023, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026, të Bashkisë Mallakastër”, miratuar zëri “investime” në vlerën 324,433 mijë lekë. Në këtë dokument nuk përcaktohet afatet e parashikuara të likuidimit të ndara sipas viteve 2023-2024 për objektin e prokuruar (duke marrë në konsideratë faktin që realizimi i objektit që prokurohet përfshin periudhën 2024-2025-2026).

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “I” ShPK sipas kontratës së shërbimit nr. 2709/30, datë 19.07.2022 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. Q.I, në cilësinë e Titullarit të AK.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Fondi limit dhe preventivi përkatës, janë hartuar nga projektuesi i objektit shoqëria “I” ShPK dhe çmimet e zërave të preventivit të ofertës, janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informalizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit”. Nga verifikimi zërave të të preventivit të të ofertës rezultoi se janë përfshirë në TVSH edhe disa zëra punimesh makineri dhe pajisje të cilat sipas VKM nr. Nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” duhet të përfshihen në strukturën e preventivit pa TVSH, konkretisht:

Për rreth 20 zëra që lidhen me furnizim makineri pajisje, në vlerën 6,726,700 lekë, për shkak të llogaritjes dhe shtimit në vlerën e preventivit të ofertuar të TVSH me 20%, është rritur fondi limit në vlerën 8,072,000 lekë, duke krijuar një diferencë, në **vlerë totale 1,345,300 lekë**(8,072,000-6,726,700), **me rritje** të pa argumentuar **të fondit limit**

Me Urdhrin nr. 5, datë 08.05.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, deleguar kopetencat në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F, z. A.S, z. F.A.

Me Urdhrin nr. 5, datë 08.05.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë deleguar kopetencat në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Ndërtim i Shkollës “Gjokë Doçi”” me fond limit në vlerën 159,811,598 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e Hapur”.

Hartimi i kritereve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 5, datë 08.05.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, me datë 29.05.2024 nga A.S në cilësinë e Specialistit të Fushës në Njësinë e prokurimit, është hartuar procesverbali mbi hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 30.05.2024, nga NJP e përbërë nga z. B.F, z. A.S, z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Më datë 19.06.2024, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Mallakastër, rezulton se: Për procedurën me REF-07218-05-30-2024, me objekt “Ndërtim i Shkollës “Gjokë Doçi””, me fond limit 159,811,598 lekë pa Tvsh, ka sygjerruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Më datën 19.06.2024, nga specialisti i fushës A.S është mbajtur procesverbali mbi ndryshimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, mbi këtë bazë nga NJP është hartuar shtojca date 20.06.2024 për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Me shkresën nr. 2159/3, datë 20.06.2024 N/Kryetari i Bashkisë z, G.N, në cilësinë e Titullarit të AK ka bërë “Njoftimin për Ndryshimin e Dokumenteve të Tenderit”.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s’kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.7. “Kapaciteti teknik”, kërkohet: Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar:2(dy) teknikë ndërtimi, shoqëruar me kontrata pune, diplomë/dëshmi.....

Ky kriter është i panevojshëm pasi kjo dublohet me pozicionin e punës së inxhinierit të ndërtimit, ndaj është i panevojshëm si kriter.

2. Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë **fuqinë punëtore prej 35 punonjës, të siguar për muajin e fundit, nga data e hapjes së tenderit,** të vërtetuar me:

Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

-2 (dy) teknik ndërtimi; - 3 (tre) muratorë; -2 (dy) hekurkthyes; - 3 (tre) karpentierë; 2 (dy) pllakashtrues;- 2(dy) bojaxhinj; - 2(dy) elektrçistë; - 2(dy) hidraulikë; - 2(dy) manovratorë; - 2(dy) shoferë;

Ky staf mbështetës duhet të ketë kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 5 ton	Në pronësi ose me qira	2

3	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
4	Kamion vinç	Në pronësi ose me qira	1
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	2
6	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Eskavator	Në pronësi ose me qira	1
8	Vinç kullë	Në pronësi ose me qira	1
9	Betoniere kantieri	Në pronësi ose me qira	2
10	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	2

-Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për **pikën nr. 2.3.3, nr. 2.3.4, nr. 2.3.6, nr. 2.3.7**, (në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore, mjetet/makineritë dhe pajisjet) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjrisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

Për të rritur cilësinë e punimeve dhe sigurinë në punë për objektin e tenderuar, duhet të vendoseshin edhe kriteret e tjera, konkretisht:

Pjesë e kriterëve duhet ishte kriteri “Operatori Ekonomik të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi 1.2.A. për “Mbrojtjen nga Zjarri”, ose të paraqesë kontratë me konsulentë të licensuar në këtë drejtim. Ky kriter është i argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

4. Pjesë e kriterëve duhet ishte kriteri “Operatori Ekonomik duhet të disponoj/qira skeleri, duke përcaktuar sasinë në referencë të sipërfaqes së fasadës së objektit.

Ky kriteri argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

-Lidhur me **“Kapacitetin teknik”**, duhet kërkohej që Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar specialistë të kualifikuar për procesin e hidroizolimit të objektit, shoqëruar me kontrata pune, diplomë/dëshmi.....

Kjo kërkesë argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 163, datë 08.05.2024, të të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, deleguar kopetencat në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. L.S kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X, z. N.N.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 22.07.2024, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 24 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 31.07.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 12 OE dhe s’kualifikuar 12 OE, është shpallur

si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “RR.U.A” Shpk.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “RR.U.A” Shpk (me Nipt J), me vlerë ekonomike të ofertës **105,635,461.4 lekë pa Tvsh.**
2. OE “N” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **108,855,114.26 lekë pa Tvsh.**
3. BOE “G” Shpk (me Nipt K)& “K” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **109,303,282 lekë pa Tvsh.**
4. OE “L” Shpk (me Nipt L) me vlerë ekonomike të ofertës **109,747,157.41 lekë pa Tvsh.**
5. OE “S” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **111,050,856.21 lekë pa Tvsh.**
6. OE “KC” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **111,158,504.46 lekë pa Tvsh.**
7. BOE “B” Shpk (me Nipt L) & “B 93” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **111,403,301.53 lekë pa Tvsh.**
8. OE “I” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **112,613,275.32 lekë pa Tvsh.**
9. OE “Sh” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **114,830,694 lekë pa Tvsh.**
10. OE “EK” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **116,641,432.66 lekë pa Tvsh.**
11. 10. OE “A” Shpk (me Nipt M) me vlerë ekonomike të ofertës **119,486,280.4 lekë pa Tvsh.**
12. OE “P” Shpk (me Nipt L) me vlerë ekonomike të ofertës **120,188,262.54 lekë pa Tvsh.**
13. OE “B” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **121,397,938 lekë pa Tvsh.**
14. OE “I” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **122,149,137.56 lekë pa Tvsh.**
15. BOE “C” Shpk (me Nipt J) & “J” Shpk (me Nipt J) & “A” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **122,222,222 lekë pa Tvsh.**
16. OE “AK” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **124,031,044 lekë pa Tvsh.**
17. OE “S” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **133,004,890.22 lekë pa Tvsh.**
18. OE “D” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **139,022,318.42 lekë pa Tvsh.**
19. OE “LK” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **139,451,285.81 lekë pa Tvsh.**
20. OE “L” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **143,513,870 lekë pa Tvsh.**
21. BOE “E” Shpk (me Nipt K) & “S” Shpk (me Nipt J), me vlerë ekonomike të ofertës **144,259,631 lekë pa Tvsh.**
22. OE “DC” Shpk (me Nipt K) me vlerë ekonomike të ofertës **149,770,495.07 lekë pa Tvsh.**
23. OE “E” Shpk (me Nipt L) me vlerë ekonomike të ofertës **159,100,000 lekë pa Tvsh.**
24. OE S Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës **160,326,597.43 lekë pa Tvsh.**

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE “L” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **109,747,157.41 lekë pa Tvsh**

për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim (shtojca 7) të DST, pasi lidhur me kontratat e ngjashme dokumentacioni shoqëruar nuk përmbush kërkesat e nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pika 5 neni 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Gjithashtu punët e tjera të paraqitura në total, nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në DST, që duhet të jetë jo më e vogël se 300,000,000 lekë.

2. OE “K” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **111,158,504.46 lekë pa Tvsh.** për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk përmbush detyrimin për plotësimin korrekt të shtojcës 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit” të DST, ku përcaktohet që zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen zëra të pa ofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës. Rezulton se te seksioni “Fikëse zjarri me bombula”, nuk është pasqyruar zëri i preventivit “f.v. fikëse zjarri pluhur karelato, destinacioni.....”. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

3. BOE “B” Shpk (me Nipt L) & “B” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 111,403,301.53 lekë pa Tvsh, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, lidhur me disponimin e stafit mbështetës të kualifikuar. Rezulton se anëtari I BOE me përqindja më të lartë pjesmarrje(OE “B ” ka 70 % kuote pjesmarrje), duhet të dipononte të paktën 15 punonjës staf të kualifikuar, ndërsa ka paraqitur 7 punonjës.

- Drejtuesi Teknik I deklaruar nga OE “B ”, rezulton me prefision inxhinier hidroteknik, në fakt duhet të jetë me profesion inxhinier ndërrtimi, kjo bie ndësh me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 2. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

4. OE “A” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 119,486,280.4 lekë pa Tvsh, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, pasi lidhur me kontratat e ngjashme dokumentacioni shoqërues nuk përmbush kërkesat e nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pika 5 neni 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Disa nga kontratat e paraqitura nuk përshkruajnë punë të me objektin e tenderuar, për tu konsideruar që plotësojnë kriterin për punë të ngjashme. Gjithashtu punët e tjera të paraqitura, ku për një kontratë duhet të jetë jo me e vogël se vlerë prej 75,000,000 lekë, ndërsa në total, nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në DST, që duhet të jetë jo më e vogël se 300,000,000 lekë. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

5. OE “P” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 120,188,262.54 lekë pa Tvsh, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.4, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, lidhur me stafin inxhinierik të kërkuar(derjtuesi teknik), pasi në formularin e vetë deklarimit(shtojca 8), nuk ka deklaruar se ka të punësuar inxhinier mekanik në pozicionin drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

6. OE “B” Shpk (me Nipt J), me vlerë ekonomike të ofertës 121,397,938 lekë pa Tvsh, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, lidhur me disponimin e stafit mbështetës të kualifikuar. Rezulton se OE “B” ka paraqitur 7 punonjës, ndërsapër pjesën tjetër është mbështetur tek subjekti “S” shpk. Sipas përcaktimeve ligjore, OE kërkon të mbështetet në subject tjetër, duhet që të zotërojë vetë të paktën 50% të kërkesës për stah mbështetës të kualifikuar(të paktën 11 punonjës). Në këto kushte nuk ka zbatuar pikën 2 neni 90, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

7. BOE “C” Shpk & “J” Shpk & “A” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 122,222,222 lekë pa Tvsh, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 8) të DST, lidhur me formularin e vetëdeklarimit tek seksion B “Deklarata”, ka selektuar alternativën “a”, ndërsa në rastin e BOE duhet të selktohej alternative “b”.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, pasi lidhur me kontratat e ngjashme dokumentacioni shoqërues nuk përmbush kërkesat e nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pika 5 neni 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Gjithashtu nga OE “A” pjesë e BOE, nuk është paraqitur asnjë kontratë e ngjashme e realizuar dhe bie ndësh me përcaktimet ligjore.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.5, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, lidhur me stafin inxhinierik të kërkuar(derjtuesi teknik), pasi në

formularin e vetë deklarimit(shtojca 8), Drejtuesi Teknik I deklaruar nga OE “C”, rezulton me prefision inxhinier hidroteknik, në fakt duhet të jetë me profesion inxhinier ndërtimi, kjo bie ndësh me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 2.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.5, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, pasi anëtari OE “J” shpk, nuk ka paraqitur licencë profesionale të shoqërisë.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.9, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim, pasi anëtari i BOE “J” nuk ka paraqitur certifikatat ISO të kërkuar. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

8. OE “D” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **139,022,318.42 lekë pa Tvsh**, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, pasi lidhur me kontratat e ngjashme dokumentacioni shoqërues nuk përmbush kërkesat e nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pika 5 neni 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nga 9 kontrata si punë të ngjashme të paraqitura, 6 kontrata nuk kanë si objekt punë që nuk janë të ngjashme me objektin e tenderuar. Për 1 kontratë të paraqitur, rezulton se mungon dokumentacioni shoqërues, si; Formulari i Vlerësimit(shtojca 9), Akti i kolaudimit përfundimtar të objektit përkatës. Ndërsa për 2 kontrata të tjera si punë të ngjashme nuk plotësojnë kushtin e vlerës së kërkuar në DST. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

9. BOE “E” Shpk & “S” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **144,259,631 lekë pa Tvsh**, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 1/a kriteret e veçanta të DST, lidhur me formularin e vetëdeklarimit tek seksion B “Deklarata”, ka dy OE “E” Shpk & “S” Shpk, pjesë BOE, kanë selektuar alternativën “a”, ndërsa në rastin e BOE duhet të selektohej alternative “b”. Mosplotësimi korrekt i rubrikave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konsiderohet si informacion I pa saktë, për rrjedhojë BOE skualifikohet.

10. OE “D” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **149,770,495.07 lekë pa Tvsh**, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1, të “Kapacitetit teknik” kriteret e veçanta për kualifikim(shtojca 7) të DST, pasi lidhur me kontratën e ngjashme të paraqitur, dokumentacioni shoqërues nuk përmbush kërkesat e nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pika 5 neni 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për 1 kontratë të paraqitur, rezulton se mungon dokumentacioni shoqërues, Formulari i Vlerësimit(shtojca 9). Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

11. OE “E” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **159,100,000 lekë pa Tvsh**, me vlerë ekonomike të ofertës **159,100,000 lekë pa Tvsh**, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk përmbush kërkesat për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur detajimin e ofertës sipas shtojcës 2 (nuk paraqitur preventive punimesh), si dhe nuk paraqitur asnjë document të kërkuar në DST. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

12. OE S Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës **160,326,597.43 lekë pa Tvsh**, për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk përmbush kërkesat për kualifikim, pasi në ofertën e paraqitur sipas shtojcës 2, preventivi punimeve I paraqitur, përmban gabime aritmetike dhe tejkalon vlerën e fondit limit të procedurës objekt prokurimi, konkretisht zëri “f.v Ashensor mekanik”, pas krogjimit të ofertës, rezulton me vlerë më të madhe se fondi limit. Për rrjedhojë skualifikohet ky OE.

Me shkresën nr. 2159/7 prot., datë 16.08.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Titullarit të AK. Me shkresën nr. 2159/8 prot., datë 16.08.2024, N/Kryetari i Bashkisë, në

cilësinë e Titullarit të AK(me delegim kopetencash), ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 2159/9 prot., datë 16.08.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “RR.U.A” Shpk

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në SPE, rezulton se skualifikimi i OE të sipërcituar përputhet me konstatimet e KVO-së.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme në aplikimin e kriterëve, ku evidentohen kritere jo në përputhje me procedurën dhe tipologjinë e saj, pavarësisht këtyre mangësive, rezulton se ka patur një pjesmarrje të gjërë në procedurë.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G.N N/Kryetar i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor(delegim kompetencash), z. B.F, z. A.S, z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “**Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës**” zhvilluar në vitin 2024 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 16, datë 16.08.2024.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 16, datë 16.08.2024. 1. B.F (Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. TH.GJ (Inxhinier Ndërtimi) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 263, datë 16.08.2024.2024. 1. L.S Anëtarë(Drejtor juridik/anëtar) 2. A.X, Anëtarë (Kryeinspe ktor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. A.S, Anëtar (Inxhinier Ndërtimi)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”.		
5. Fondi Limit: 67,632,735 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: BOE “A” Shpk & “K” Shpk & “AK” Shpk, me vlerë oferte 64,964,175.15 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 2,668,560 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 10.09.2024.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 24 OE b) S’kualifikuar: 1. BOE “A” & “K” Shpk & “AK” Shpk; 2. OE “E” Shpk; 3. OE “P G” Shpk; 4. OE “M” Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 4086/5 prot., datë 10.10.2024.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 77,957,010 lekë	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “S Ltd” ShPK sipas kontratës së dhurimit nr. 394/1, datë 26.01.2024 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër z. Q.I, në cilësinë e Titullarit të AK.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Fondi limit dhe preventivi përkatës, janë hartuar nga projektuesi i objektit shoqëria “SELAS Ltd” ShPK dhe çmimet e zërave të preventivit të ofertës, janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informalizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit”, si dhe për disa zëra janë përcaktuar me analizë çmimi. Nga verifikimi zërave të preventivit të ofertës rezultoi se çmimet për disa nga zërat e preventivit janë përcaktuar, jo në përputhje me atë që përcaktohet në VKM. Gjithashtu janë bërë përlllogaritje të gabuara në përcaktimin e volumeve, si dhe zëri nr. An. 3.7 “Shkulje rrënjë dhe bimë të vogla”, është përfshirë në mënyrë të gabuar tre herë në preventive. Këto parregullsi kanë sjellë rritjen e pa argumentuar vlerën e preventivit të ofertuar (fondit limit). Konkretisht:

- Nga përfshirja në preventive 3 herë i zërit An. 3.7 “Shkulje rrënjë dhe bimë të vogla”, kemi një përlllogaritje të gabuar duke sjellë shtesë të fondit limit **në vlerën 2,269,190 lekë** ($2 * 1,134,594$);

- Lidhur me zërin nr numër 1 tek seksioni I preventivit “Rindërtimi I shkarkuesit katastrofik të rezervuarit”, zëri I punimit “Gërmim dheu për riseksionimin e kanalit(80 % me makineri)”, ky zë punimi përbëhet nga dy zëra “gërmim me makineri” dhe “gërmim me krahë”, për këtë në preventive për vendosjen e çmimit janë referuar në zërin An 3.101./a dhe zërin An. 3.46/1, duke përcaktuar si çmim/m³ vlerën 2820.24 lekë/ m³. Në fakt duke ju referuar çmimeve të manualeve të miratuara me VKM nr. 216, datë 13.04.2023, rezulton se An 3.101./a “Gërmim dheu me eskavator me zinxhir kovë 0.5 m³, tokë zakonshme kategoria IV” rezulton çmimi në vlerën 212.4 lekë/ m³, duke qenë se 80 % e punimeve do të bëhen me makineri, vlera totale e këtij zëri punimi me makineri është $4270 \text{ m}^3 * 0.8 * 212.4 = \mathbf{725,558.4 \text{ lekë}}$. Zëri An. 3.46/1, “gërmim me krahë tokë zakonshme kategoria IV, $b < 2 \text{ m}$ ”, rezulton çmimi në vlerën 2827 lekë/ m³, duke qenë se 20 % e punimeve të gërmimit do të bëhen me krahë, vlera totale e këtij zëri punimi është $4270 \text{ m}^3 * 0.2 * 2827 = \mathbf{2,414,258 \text{ lekë}}$. Në total vlera e zërit (3.101/a+3.46/1) “Gërmim dheu për riseksionimin e kanalit(80 % me makineri)”, llogaritete në **vlerën 3,139,816 lekë** ($725,558 + 2,414,258$), duke krijuar një diferencë prej **8,904,019 lekë** [$12,043,835 \text{ lekë}$ (vlera totale sipas preventivit) - $3,139,816 \text{ lekë}$ (vlera faktike)], të pa argumentuar,

- Lidhur me zërin nr numër 1 tek seksioni” D” i preventivit “Punime për lidhjen e pusëtës së daljes së ujëlëshuesit...”, zëri I punimit “Gërmim dheu për riseksionimin e kanalit”, ky zë punimi përbëhet nga dy zëra “gërmim me makineri” dhe “gërmim me krahë”, për këtë në preventive për vendosjen e çmimit janë referuar në zërin An 3.101./a dhe zërin An. 3.46/1, duke përcaktuar si çmim/m³ vlerën 2820.24 lekë/ m³. Në fakt duke ju referuar çmimeve të manualeve të miratuara me VKM nr. 216, datë 13.04.2023, rezulton se An 3.101./a “Gërmim dheu me eskavator me zinxhir kovë 0.5 m³, tokë zakonshme kategoria IV” rezulton çmimi në vlerën 212.4 lekë/ m³, duke qenë se 80 % e punimeve do të bëhen me makineri, vlera totale e këtij zëri punimi me makineri është $335 \text{ m}^3 * 0.8 * 212.4 = \mathbf{56,900 \text{ lekë}}$. Zëri An. 3.46/1, “gërmim me krahë tokë zakonshme kategoria IV, $b < 2 \text{ m}$ ”, rezulton çmimi në vlerën 2827 lekë/ m³, duke qenë se 20 % e punimeve do të bëhen me krahë, vlera totale e këtij zëri punimi është $335 \text{ m}^3 * 0.2 * 2827 = \mathbf{189,409 \text{ lekë}}$. Në total vlera e zërit (3.101/a+3.46/1) “Gërmim dheu për riseksionimin e kanalit, llogaritete në **vlerën 246,300 lekë** ($56,900 + 189,400$), duke krijuar një diferencë të pa argumentuar prej **698,500 lekë** [$944,800 \text{ lekë}$ (vlera totale sipas preventivit) - $246,300 \text{ lekë}$ (vlera faktike)].

- Lidhur me zërin nr numër 16 tek seksioni” A” i preventivit “Punime për riparimin në kuadër të mirmbajtjes së digës”, zëri i punimit An 7- “Ndërtim parapet mbrojtës b/arme H=80 cm, përgjatë kurorës së digës”, ky zë punimi është bërë me analizë pasi ka edhe elementë të tjerë (gërmime, mbushje, nënshresa, beton, etj), Duke ju referuar të dhënave në strukturën e analizës së çmimit, rezulton se për zërin 3.244/1 “Beton C-20/25” për është llogaritur sasia 1.38, ndërsa duke ju referuar detajit të projektit rezulton se kjo sasi është 0.69 m^2 [$(1.1 * 0.2) +$

$(1.2*0.2)+(0.4*0.4)+(0.25*0.25)$], e llogaritur në total për gjithë gjatësinë prej 185 ml, I përket volume prej 127.7 m³ (185*0.69), ndërsa sipas preventivit(An. 7), është përcaktuar volumi I betonit prej 255.3 m³ (185*1.38), duke krijuar një diferencë në volum prej prej 127.6 m³ (255.3-127.7), për rrjedhojë ka krijuar një **rritje të pa argumentuar të fondit limit në vlerën 1,482,400 lekë**[127.6(diferenca në volum)*11618(çmimi i vendosur në An 7)].

Në total, është krijuar një rritje e pa argumentuar të fondit limit **në vlerën 14,138,000 lekë**(2,269,190+8,904,019+698,500+1,482,400), e cila rezulton më e lartë se diferenca ndërmjet vlerës së fondit limit dhe vlerës së që ka fituar tenderin(vlera 2,668,560 lekë), diferencë që **llogaritet në vlerën 11,469,440 lekë** (14,138,000-2,668,560);

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. V.A, përfaqësues i subjektit “S” ShPK, në cilësinë e projektuesit dhe hartuesit të preventivit të fondit limit dhe anëtari i NjP, në cilësinë e specialistit të fushës z. TH.GJ;

Gjithashtu për mos zbatim të procedurës së marrjes në dorëzim të projektit të zbatimit dhe preventivit të fondit limit(mos ngritja e grupit të marrjes në dorëzim), ngarkohet me përgjegjësi z. Q.I, Kryetari i Bashkisë Mallakastër.

Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 16, datë 16.08.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, delegim koptencash në cilësinë e Titullarit të AK, z. Th. Gj. me profesion inxhinier ndërtimi ka mbajtur procesverbalin e datës 20.08.2024, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 20.08.2024, nga NjP e përbërë nga z. B.F, z. F.A dhe Th. Gj. është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Më datë 23.08.2024 nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Mallakastër, rezulton se: Për procedurën me REF-16587-08-20-2024, ka përcjellë “kërkesën për sqarim” të OE “L” shpk pjesmarrës në tender, lidhur me kërkesën për dy automjetet teknologjike. Me shkresën datë 23.08.2024 është bërë sqarimi lidhur me vendosjen e kësaj kërkesë.

Me shkresën nr. 77, datë 23.08.2024, OE “B” shpk, pjesmarrës në tender, ka paraqitur ankesë, pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 4183 prot., datë 26.08.2024 dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e disa kriterëve të veçanta.

Pas paraqitjes së ankesës Titullari AK Bashkia Mallakastër ka nxjerrë Urdhrin nr. 271, datë 27.08.2024 për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe me Urdhrin nr. 272, datë 27.08.2024 ka caktuar z. A.S me profesion inxhinier ndërtimi, për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga OE “B93 II”.

Me shkresën nr. 4086/5, datë 27.08.2024 dhe me rrugë elektronike e mail datë 27.08.2024, nga Bashkia i është kërkuar OE ankues, që të paraqesë(brenda 2 ditëve) dokumentin bankar lidhur me vërtetimin e pagesës së tarifës për ankimimin e bërë pranë KPP-së.

Me shkresën nr. 4086/8, datë 30.08.2024 Bashkia Mallakastër ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me mos paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e tarifës së ankesës nga OE “B93 II”.

Komisioni i Prokurimit Publik ka nxjerrë Vendimin nr. 1169/2024, datë 02.09.2024, për mos shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga OE “B”, vendim të cilin e ka përcjellë pranë Bashkisë Mallakastër me shkresën nr. 2380/7, datë 02.09.2024.

Titullari i AK Bashkia Mallakastër ka nxjerrë Urdhrin nr. 275, datë 30.08.2024 për nxjerrjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit me numër reference RF-16587-08-20-2024

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtimit dhe të lidhura ngushtë

me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.4. “Kapaciteti teknik”, kërkohet: Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar: 3(tre) muratorë, shoqëruar me kontrata pune, diplomë/dëshmi.....

Ky kriter është i panevojshëm, pasi referuar zërave të punimit nuk argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

2. Në pikën nr. 2.3.7. “Kapaciteti teknik”, kërkohet: Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik mekanik(drejtimes teknik) shoqëruar me kontrata pune, diplomë, që figurojnë në listën e të punësuarvë të shoqërisë.

Ky kriter është i panevojshëm pasi **nuk argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.** Ndërsa gjendja teknike e makinereive, sigurohet nga specialisti mekanik i kërkuar.

3. Në pikën nr. 2.3.7. “Kapaciteti teknik”, kërkohet: Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar: 2(dy) teknikë ndërtimi, shoqëruar me kontrata pune, diplomë/dëshmi.....

Ky kriter është i panevojshëm, pasi referuar zërave të punimit nuk argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

4. Në pikën nr. 2.3.8. “Kapaciteti teknik”, kërkohet: Operatorët ekonomik për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet: ”Rul me dhëmbë min. 15 ton” copë 2(dy);- ”Rimorkiator për mjete të rënda” copë 1(një); - ”Gërmues me rrotullim” copë 2(dy);

Kriteri për disponimin e këtyre mjeteve është e panevojshme, ndërsa për mjetin ”Gërmues me rrotullim” duhet të kërkohej një mjet jo dy. **Kjo referuar zërave të punimit nuk argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.**

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë **fuqinë punëtore prej 8 punonjës, të siguar për muajin e fundit, nga data e hapjes së tenderit,** të vërtetuar me:

Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

-2 (dy) teknik ndërtimi; - 3 (tre) muratorë; -2 (dy) hekurkthyes; - 3 (tre) karpentierë; 2 (dy) hidraulikë;- 1(një) mekanik; - një(një) saldator; - 7(shtatë) punëtorë të thjeshtë ndërtimi; - 6(gjashtë) manovratorë; - 4(katër) shoferë;

Ky staf mbështetës duhet të ketë kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor; dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	Në pronësi ose me qira	2
2	Dumper(mjet teknologjik me goma) kapacitet 25 ton-30ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 2-5 ton	Në pronësi ose me qira	2
4	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1-2 ton	Në pronësi ose me qira	2
5	Eskavator me zinxhirë krahëgjatë me krah mbi 18 m	Në pronësi ose me qira	2
6	Fadromë(mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	1
7	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
8	Rrul vibruës min. 15 ton	Në pronësi ose me qira	1
9	Piastër ngjeshëse për eskavator	Në pronësi ose me qira	2
10	Rrul me dhëmbë min 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
11	Buldozer me peshë min. 20 ton	Në pronësi ose me qira	1
12	Auto vinç	Në pronësi ose me qira	1
13	Eskavator(mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	2
14	Rimorkiator për mjete të rënda	Në pronësi ose me qira	1
15	Pajisje gjeodezike tip stacion total	Në pronësi ose me qira	1
16	Pajisje gjeodezike GPS	Në pronësi ose me qira	1
17	Moto pompë	Në pronësi ose me qira	2
18	Mjet bujqësor me agregat	Në pronësi ose me qira	1
19	Kontinier i lëvizshëm(Zyrë)	Në pronësi ose me qira	1
20	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	1
21	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
22	Greider	Në pronësi ose me qira	1
23	Gërmues me rrotullim	Në pronësi ose me qira	2

-Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për **pikën nr. 2.3.3, nr. 2.3.4, nr. 2.3.6, nr. 2.3.7,** (në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore, mjetet/makineritë dhe pajisjet) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjrisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

Për të rritur cilësinë e punimeve dhe sigurinë në punë për objektin e tenderuar, duhet të vendoseshin edhe kritere të tjera, konkretisht:

- Pjesë e kriteve duhet ishte kriteri “Operatori Ekonomik duhet të kërkohej nga OE që të disponohej Licencë profesionale që të përmbajë kategorinë NP-7 A-Punime ujsjellës, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje.

Ky kriteri argumentohet teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 263, datë 16.08.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, delegim koptencash në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. L.S kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X, z. A.S.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 10.09.2024, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 18.09.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 BOE dhe s'kualifikuar 3 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga **BOE "A" Shpk & "A" Shpk & "K" Shpk**.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 26.09.2024, mbi verifikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të dorëzuar nga Ofertuesi i kualifikuar i pari BOE "A" Shpk & "A" Shpk & "K" Shpk.

Me shkresën nr.4086/12, datë 08.10.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës Përfundimtar, I miratuar nga Titullari i AK me shkresën nr. 4086/13, datë 08.10.2024.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE "A" Shpk & "A" Shpk & "K" Shp me vlerë ekonomike të ofertës **64,964,175.15 lekë pa Tvsh**.

2. OE "E" Shpk me vlerë ekonomike të ofertës **66,012,177 lekë pa Tvsh**.

3. OE "P" Shpk me vlerë ekonomike të ofertës **66,488,273.4 lekë pa Tvsh**.

4. OE "M" Shpk me vlerë ekonomike të ofertës **67,038,043 lekë pa Tvsh**.

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE "E" Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk ka paraqitur asnjë prej dokumenteve të kërkuara në DST për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta, rrjedhimisht I skualifikuar

2. OE "P" Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 2.3.1. tek "Kapaciteti teknik", lidhur me vlerën e kontratës së ngjashme të paraqitur, pasi është paraqitur një kontratë e vetme për punë të ngjashme me vlerë 24,129,470 lekë pa TVSH, që rezulton më e vogël se vlera e kërkuar prej 30,000,000 lekë. Gjithashtu nuk plotëson kërkesën sipas pikës 1/b të "Kritere të veçanta", pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës (shtojca 3).

3. OE "M" Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk ka plotësuar korrekt zërat e shtojcës 2 "Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit", pasi në seksionin "C", zëri me analizë 3.2 "Prerje bimësh.....", është paraqitur, në preventive, por nuk është kuotuar. Gjithashtu zëri me analizë 3.245 "B M-200...." I është ndryshuar sasia e për caktuar në preventivin e tenderuar.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE "A" Shpk & "A" Shpk & "K" Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.2.3. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023, sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, lëshuar prej njërive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Nga OE "A" Shpk janë paraqitur dhe janë gjendje në dosje vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Lushnje dhe Dimal, për vitet 2023-2024.

Për sa trajtuar më sipër nga OE "A" Shpk nuk është përmbushur pika nr. 2.2.3, e kriterëve të veçanta për kualifikim konkretisht, **nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë, Bashkisë Mallakastër dhe Bashkisë**

Durrës, referuar kontratave të praqitura nga operatori si punë të ngjashme të kryera, ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete sipas kontratës si më poshtë:

Kontrata nr. 1519/586 prot., datë 14.10.2021, me objekt “Ndërtim magazinë për produkte agrokulturë”, për subject privat Fshati Hekal, Mallakastër, në vlerën 180,474,346 lekë. Referuar aktit të kolaudimit rezulton e përfunduar me datë 04.02.2024.

Kontrata nr. 187/8 prot., datë 04.08.2023, me objekt “Rehabilitim dhe mbrojtje lumore”, institucioni Bordi Rajonal i Kullimit Durrës, referuar aktit të kolaudimit rezulton e përfunduar me datë 09.09.2023.

- Referuar Ekstraktit Historik, rezulton se **Farkë, Tiranë**, vijon të jetë aktive, ndërsa nuk ka paraqitur vërtetim për për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë.

Nga OE “A” Shpk janë paraqitur dhe janë gjendje në dosje vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë, për vitet 2023-2024.

Për sa trajtuar më sipër nga OE “A” Shpk nuk është përmbushur pika nr. 2.2.3, e kriterëve të veçanta për kualifikim konkretisht, **nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Divjakë, Bashkisë Poliçan, referuar kontratave të praqitura nga operatori si punë të ngjashme të kryera**, ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete sipas kontratës si më poshtë:

Kontrata nr. ... prot., datë 02.04.2021, me afat 24 muaj, deri me datë 04.02.2023, me objekt “Furnizim me ujë të pijshëm I zonave bregdetare të Bashkisë Divjakë”, Institucioni Bashkia Divjakë, në vlerën 416,718,945 lekë. Sipas afatit të përcaktuar në kontratë duhet të përfundonte me datë 02.04.2024.

Kontrata nr. ... prot., datë 07.08.2023, me objekt “Mbrojtje e Lumit Osum, Fshati Mbrakull”, institucioni Bashkia Poliçan,. Referuar kësaj kontrate rezulton se ka ushtruar aktivitet në këtë bashki në vitin 2023.

2. Në pikën nr. 2.3.2. Operatorët ekonomik duhet të disponojnë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërosë e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë:

NP-1 A-Punime gërmimi në tokë;-NP-4A; -NP-6 C;-NP-12 C; NS-8 A;-NS-18 A;

OE “A” Shpk në licencën që disponon, nuk disponon kategorinë -NP-12 C;

Për sa trajtuar më sipër, nga OE “A” Shpk nuk është përmbushur pika nr. 2.3.2. e kriterëve të veçanta.

3. Në pikën nr. 2.3.7. Operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, kjo e shoqëruar me kontratë punë, diplomë/certifikatë..

OE “A” Shpk në Formularin përmbledhur të vetëdeklarimit (shtojca 8), seksion I ”B”, ka deklaruar si staf mbështetës: K.V me profesion inxhinier hidroteknik, por rezulton se kontrata i ka përfunduar me datë 01.11.2022; E.S përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, por rezulton se kontrata i ka përfunduar me datë 20.01.2024; F.B, me profesion Karpentier, por rezulton se kontrata i ka përfunduar para 5 viteve;

4. Në pikën nr. 2.3.8. Operatorët ekonomik për realizimin e kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet. Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqitet dokumentacioni: Certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë kontrolli teknik, polica e sigurimit, leje/certifikatë transporti, lëshuar nga organet kompetente. Për mjetet që janë të disponuara me qira duhet të paraqitet dokumentacioni: kontratë qiraje, Certifikatë pronësie së qiradhënësit, leje qarkullimi, certifikatë kontrolli teknik, polica e sigurimit, leje/certifikatë transporti për të tretë, lëshuar nga organet kompetente.

OE “A K” Shpk në Formularin përmbledhur të vetëdeklarimit (shtojca 8), seksioni ”B”, ka deklaruar disponimin e mjeteve:

Autobot uji, me targa AA 823 MP, i pa përcaktuar në pronësi apo me qira, rezulton se mungon Leja e transportit dhe fotot e mjetit;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G.N N/Kryetar i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor(delegim kompetencash), z. B.F, z. TH.GJ, z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe znj. L.S, z. A.X, z. A.S, në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2024 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” zhvilluar në vitin 2024 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 10, datë 01.07.2024.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 10, datë 01.07.2024. 1. B.F (Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. E.Y (Inxhinier Navigacion) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 218, datë 01.07.2024. 1. A.S, Kryetar (Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, inxhinier ndërtimi) 2. A.XH, Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. Nikollaq Nesho, anëtar;
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”.		
5. Fondi Limit: 15,990,000 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: OE “N” Shpk me vlerë absolute 147.5 lekë/litër për shumën e prokuruar 15,723,200 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 266,500 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 25.07.2024.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE b) S’kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE 1. OE “N” Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: -Nr. 94/9 prot., datë 03.09.2024, për Bashkinë Mallakastër.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 18,867,840 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2024 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”, janë siguruar fonde në vlerën **15,990,000 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër sipas VKB nr. 64, datë 21.12.2023, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Mallakastër”. Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Mallakastër në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 10, datë 01.07.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK(delegim koptencash), është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F, z. E.Y, z. F.A.

Me Urdhrin nr. 218, datë 01.07.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK(delegim koptencash) ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Blerje karburant (Diezel) viti 2024 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” me fond limit në vlerën 15,990,000 lekë pa Tvsh, me anë të llojit të procedurës “Procedurë e Hapur”.

Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e kërkuar prej 106,600 litra diezel (naftë) konkretisht në dokumentin e mbajtur nga komisioni për përllogaritjen e fondit limit nuk me gjithëse përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant dhe furnizimet e vitit të mëparshme, por nuk ka një analizë të detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit (normat e harxhimit), për secilin mjet së bashku me plan shpërdarjen për mjetet e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Gjithashtu studimi paraprak i tregut nuk mund të bazohet në një kupon tatimor për një furnizim në një moment të caktuar, por duhet një studim më i detajuar për subjektet që operojnë në treg, duke analizuar çmimet që kanë mbajtur operatorët dhe lëvizjet që kanë pësuar çmimet në treg për një periudhë të caktuar. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Hartimi i kriterëve të DT:

Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike z. B.V ka nxjerrë Urdhrin nr. 18, datë 10.06.2024, për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga E.Y (Specialit Inxhinier Navigacion NSHP), kryetar i komisionit dhe anëtarët z. F.B (Përgjegjës i Sektorit të Transportit NSHP) z. F.A (Përgjegjës i Financës Bashkia Mallakastër), z. E.H, z. E.XH. Me shkresën nr. 94/1 prot., datë 12.06.2024, nga komisioni i sipërpërmendur është mbajtur aktiteknik për përllogaritjen e fondit limit, afatin e lëvritimit dhe hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Blerje karburant (Diezel) viti 2024 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”. Duke u bazuar në procesverbalin e sipërpërmendur, komisioni për caktimin e fondit limit, lidhur me përcaktimin e sasisë së nevojshme, është bazuar në konsumin e vitit të mëparshëm për çdo mjet, në total është përcaktuar sasia 10600 litra. Për përcaktimin e çmimit/litër është bazuar në metodën studim tregu dhe çmim mesatar konkretisht 150 lekë/litër diezel (naftë) pa Tvsh * 106600 litra = 15,990,000 lekë pa Tvsh.

Ky dokumentacion është përcjellë me shkresën nr.94/1prot., datë 12.06.2024, pranë Bashkisë Mallakastër për nisjen e procedurës së prokurimit.

Në zbatim të Urdhrin nr. 10, datë 01.07.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK(delegim koptencash), z. E.Y me detyrë Specialist pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me profesion Inxhinier Navigacioni ka mbajtur procesverbalin e datës 04.07.2024, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 04.07.2024, nga NjP e përbërë nga z. B.F, z. E.Y, z. F.A.

është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e kërkuar prej 106600 litra diezel (naftë), konkretisht në dokumentin e mbajtur nga komisioni për përllogaritjen e fondit limit përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant, furnizimi i vitit të mëparshme, por mungon analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet, së bashku me plan shpërdarjen për mjetet e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Veprime

këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.Y, z. F.B z. F.A, z. E.H dhe z. E.XH në cilësinë e anëtarëve të komisionit për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s’kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.6. Krahas të tjerave, kërkohet që Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin “Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar gjatë vitit 2024, nga Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose nga një organ/subjekt kompetent i çertifikuar/autorizuar/akredituar, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike.

Për sa i përket kësaj kërkesë për paraqitjen e “Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), gjatë vitit 2024, kjo kërkesë nuk është i argumentuar teknikisht, pasi fletë analiza ose raporti i testimit vlen për gjendjen në depozitë të sasisë së karburantit apo për një sasi karburante që operatorit ka tregëtuar më parë se të zhvillohej tenderi, ose është në proces tragëtimi. Kjo kërkesë ndaj subjektit duhet të plotësohet gjatë periudhës që zbaton kontratën, për të vërtetuar që mallrat e përdorur janë në përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

2. Në pikën nr. 2.3.2. Krahas kërkesës që Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë minimalisht një stacion furnizimi brenda territorit administrativ të Bashkisë Mallakastër, duhet të kërkohej që pjesë e dokumentacionit që vërteton disponimin e një stacioni furnizimi me karburant, të paraqitej dokumentacioni i lëshuar nga enti kompetent, që vërteton kolaudimin dhe verifikimin periodik të instrumentit matës(pistoletat e karburantit), për të konfirmuar që sasi dhënia e karburantit është brenda parametrave të lejuar, duke garantuar besueshmëri në këtë aspekt.

Pjesë e kërkesave që duhet të plotësojnë operatorët, Autoriteti Kontraktor **duhet të përfshinte kërkesën** që OE të paraqesin Vërtetim që ushtrojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi, kërkesë kjo që vjen në përputhje me nenin 40, pika 7/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 10, datë 01.07.2024, të z. G.N N/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK(delegim koptencash), është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. A.S kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X, z. N.N.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 25.07.2024, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 operatorë ekonomik ka marrë pjesë me vlerë ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 31.07.2024, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 operatorë ekonomikë është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “N” Shpk.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- OE “N” Shpk (me Nipt J) me vlerë ekonomike të ofertës me normë fitimi të shprehur me **vlerë absolute 18 lekë/litër për shumën e prokuruar 15,723,500 lekë pa Tvsh.**

Më datë 05.08.2024, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari OE “N” Shpk.

Me shkresën nr. 3216/6 prot., datë 16.08.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 3216/7 prot., datë 16.08.2024 Titullari i AK ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 3216/8 prot., datë 16.08.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “N” Shpk.

Veprime në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, pika 4, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G.N N/Kryetar i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor(delegim kompetencash), z. B.F, z. TH.GJ, z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Përsa trajtuar në faqet 53-83 të Projekt raportit të auditimit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 190/39, datë 07.08.2025, marrës KLSH me nr. 85/9, datë 11.08.2025, observacionet me: nr. 190/38, datë 07.08.2025; nr. 190/37, datë 07.08.2025; nr. 190/36, datë 07.08.2025; nr. 190/35, datë 07.08.2025; nr. 190/34, datë 07.08.2025 dhe nr. 190/33, datë 07.08.2025; nga punonjësit e atakuar.

1-Lidhur me observacionin e paraqitur me shkresën nr. 190/38, nga punonjësi A.S

Pretendimi i subjektit

Në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit, kam hartuar kriteret e veçanta për kualifikim të kapacitetit teknik, për procedurën e prokurimit me objekt “ **Ndërtimi i Shkollës “Gjokë Doçi”** ”. Kriteret e vendosura janë të argumentuara, duke mbajtur në konsideratë parimin e mosdiskriminimit dhe sigurimin e nje pjesmarrje të gjërë. Lidhur me konstatimet tuaja, për parregullsi, sqarojmë:

- **Ne piken nr. 2.3.7. "Kapaciteti teknik", kerkohet:** operatorët ekonomik duhen të kenë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar: 2 (dy) teknik ndërtimi.. . Kjo kërkesë është konsideruar e panevdpjshme nga grupi i auditimit, pasi mbivebdoset me detyrat e inxhinierit të ndërtimit... . **Sqarojmë se:** inxhinieri i ndërtimit në një objekt nuk kryen të njëjtat detyra si tekniku i ndërtimit. Inxhinieri ndërtimit ka më shumë rol organizativ, menaxherial dhe kontrollues duke bashkërenduar proceset e ndryshme të punës, materialet dhe puntorinë. Nga ana tjetër tekniku i ndërtimit merret me proceset faktike të punës, bën kontrollin e grupeve të punës,..... . Inxhinieri i ndërtimit në kantier angazhohet edhe në takime pune jashtë kantierit, ndaj tekniku i ndërtimit mbulon punën e inxhinierit në kantier.... . Duke parë kompleksitetin e këtij ndërtimit, natyrën dhe vlerën e tij është menduar të kërkohen 2 teknik ndërtimi pasi punimet janë të llojeve dhe specialiteteve të ndryshme... .

-**Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit për kriteret e vendosura sipas pikave nr. 2.3.3, nr. 2.3.4, nr.2.3.6 dhe nr.2.3.7 (në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore,mjetet/makineritë dhe paisjet) "Kapaciteti teknik"..... . Sqarojmë se:** Në lidhje me këtë pikë nga ana ime si specialist i fushës është bërë një vlerësim i përgjithshëm mbi mjetet dhe makineritë e nevojshme për realizimin e këtij objekti, duke patur parasysh preventivin e punimeve, grafikun e punimeve dhe duke patur fokusin në rritjen e konkurrencës kam përzgjedhur kriteret më minimaliste për zbatimin e këtij objekti..

-**Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit, për vendosjen e disa kriterëve të nevojshme, si:** Operatori Ekonomik të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi 1.2A për “Mbrojtjen nga Zjarri”..

Sqarojmë se: Në lidhje me këtë pikë mendojmë se nuk është e nevojshme, pasi ne jemi në fazën e zbatimit dhe QKL , Kodi 1.2A për “Mbrojtjen nga Zjarri” ka më shumë të bëjë me fazën e projektimit sesa zbatimit. Pasi projekti nga zjarri është hartuar nga një shoqëri e cila është e licensuar për këtë pjesë dhe në fazën e zbatimit, do të zbatohet ai projekt i miratuar.....

Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit, për vendosjen e disa kriterëve të nevojshme, si

“Operatori Ekonomik të disponoj/qira skeleri dhe duhet të kenë staf mbështetës specialistë të kualifikuar për procesin e hidroizolimi të objektit..... . **Sqarojmë se:** Duke parë natyrën e punimeve këto kriterë dhe mund të kërkoheshin, por sic jam shprehur dhe më sipër, kriteret janë përzgjedhur me frymën e legjislacionit të prokurimit në përgjithësi, duke u përpjekur të stimulojnë pjesëmarrje të gjerë..... . Edhe vetë Agjencia e Prokurimit Publik, si institucioni më i lartë që monitoron procedurat e prokurimit, e që jep rekomandime për vendosjen dhe përmirësimin e kriterëve, ka rekomanduar që në procedurën “Ndërtim i shkollës Gjok Doci”, të rishikohen vetëm 2 kriterë: - nr.i punonjësve nga 40 ne 35 punonjës dhe mundësia e kontraktimit të shoferëve dhe manovratorëve. Këto rekomandime të APP janë reflektuar në hartimin e kriterëve

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron: Ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, pretendimet tuaja janë të njëta me ato të paraqitura për akt konstatimet, për të cilat ne jemi shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Gjithsesi sqarojmë përsëri se: Nuk pranojmë argumentin tuaj për dy teknika ndërtimi, pasi inxhinieri i ndërtimit në kantier nuk ka funksione administrimi (siç pretendoni ju), por ushtron detyra teknike që lidhen me zbatimin e objektit.

Lidhur me pretendimin tuaj për kriteret: **nr. 2.3.3, nr. 2.3.4, nr.2.3.6 dhe nr.2.3.7**, nuk pranojmë argumentin tuaj, pasi ne jemi shprehur se mungon dokumentimi i llogaritjes dhe përcaktimit të fuqisë punëtore , numërit dhe llojit të makinerivë, etj. Lidhur me pretendimin tuaj, se nuk është e nevojshme, vendosja si kriter të lejes së QKL, Kodi 1.2A për “Mbrojtjen nga Zjarri”, pasi ne jemi në fazën e zbatimi..... , si dhe për kriterin “Operatori Ekonomik të disponoj/qira skeleri dhe duhet të kenë staf mbështetës specialistë të kualifikuar për procesin e hidroizolimi të objektit. Sqarojmë se ne kemi referuar këto kriterë, pasi janë të nevojshëm dhe në përjestim me natyrën e zëra të punimit dhe me ndikim në rritjen e cilësisë së punimeve dhe rritjen e sigurisë gjatë procesit të zbatimit të punimeve.

2-Lidhur me observacionin e paraqitur me shkresën nr. 190/37, nga punonjësit në cilësinë e antarëve të KVO-së, L.S, A.X dhe A.S

Pretendimi i subjektit

Nga ana jonë, janë mbajtur procesverbalet përkatëse të hapjes së tenderit, vlerësimit të ofertave, dhe pas kalimit të afateve të ankimit është përgatitur raporti përmbledhës i procedurës.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.2.2. “Kapaciteti ekonomik”, ku sipas konstatimit të KLSH-së bilanci i vitit 2022, është vëlosur nga sekretaria e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, por nuk është marrë konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.. **Sqarojmë:**

Sipas kriterit të vendosur OE duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të paraqitura pranë Administratës Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe OE duhet të paraqesin edhe akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar..... . OE, ka paraqitur bilancin e vitit 2022 të pajtur me aktin e ekspertit kontabël dhe të vëlosur nga sekretaria e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat.... . Ky dokument aksesohet fare lehtë dhe në QKB ku vërtetohet përputhshmëria e tyre..... . Thelbi i plotësisimit të këtij kriteri është paraqitja e bilanceve dhe ajo që është më kryesorja është se bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, gjë e cila rezulton e përmbushur nga ofertuesi fitues.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.2.3. “Kapaciteti ekonomik”, ku sipas konstatimit të KLSH-së, OE A sh.p.k që nuk ka paraqitur taksa vendore për Bashkinë Tiranë, Bashkinë Mallakastër, Bashkinë Durrës dhe për operatorin ekonomik A sh.p.k nuk ka paraqitur për Bashkinë Divjakë dhe Bashkinë Poliçan..... . **Sqarojmë se:** Sipas kriterit “2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006..... . Referuar sa më sipër, KVO ka verifikuar ekstraktet historike të anëtarëve të BOE, duke evidentuar të gjitha adresat kryesore dhe dytësore të ushtrimit të aktivitetit prej tyre, nga ku ka rezultuar se, pas kontrollit fizik të dokumentacionit të paraqitur, janë paraqitur vërtetimet përkatëse për çdo adresë (kryesore dhe dytësore). Për bashkitë e përmendura nga ju, këto subjekte nuk kishin adresë në QKB. Pra duke iu referuar ligjit si dhe në interpretim të kriterit të vendosur në DST është kërkuar vërtetimi i pagesës së taksave vendore në ato bashki, në të cilat subjektet kanë aktivitet sipas QKB, rrjedhimisht ky kriter konsiderohet i përmbushur nga OE.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.3.2. “Kapaciteti teknik”, ku sipas konstatimit të KLSH-së, OE A sh.p.k dhe “K” shpk nuk disponojnë kategorinë e licencës NP-12 C. **Sqarojmë se:** ky kriter është përmbushur nga operatori ekonomik A sh.p.k (anëtar i BOE) dhe nuk mund të kërkohej të plotësohet nga të tre anëtarët e B.O.E pasi vlera totale e preventivit është 77,957,010 lekë me tvsh. Një kërkesë e tillë që të 3 operatorët pjesë e B.O.E të kishin NP-12 C do të kishte kuptim kur të paktën vlera e punimeve të ishte 150,000,000 lekë..... Dalim në konkluzionin që kjo kategori licence duhej të plotësoj nga një prej anëtarëve dhe të tjerët në baze të përqindjes së bashkëpunimit, rrjedhimisht ky kriter konsiderohet i përmbushur nga BOE.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.3.7. “Kapaciteti teknik”, ku sipas konstatimit të KLSH-së, për disa punonjës, ka përfunduar kontrata e punës. **Sqarojmë se:** Mund të jetë thjesht një gabim material, pasi KVO i është referuar listpagesave të paraqitura nga operatorët ekonomik, duke qenë prezent në listpagesa, çka tregon vazhdimin e marrëdhënies së punës me subjektet përkatëse..... . Referuar përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës të RSH, punëmarrësit të cilit i ka përfunduar kontrata, por që në përfundim të saj marrëdhënia e punës vazhdon dhe nuk ndërpritet, kjo marrëdhënie merr karakterin e një kontrate pune me afat të pacaktuar..... . Rrjedhimisht ky kriter konsiderohet i përmbushur nga BOE.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.3.8. “Kapaciteti teknik”, ku sipas konstatimit të KLSH-së, për për mjetet me qera të cilat certifikatën e transportit e kanë për përdorim vetjak dhe jo për të tretë. **Sqarojmë se:** Në gjykimin tonë si KVO, sic ju kemi shprehur dhe më lartë janë plotësuar kërkesat sipas DST-ve, ky kusht është konsideruar si një devijim i vogël në aspektin që certifikata e transportit është paraqitur nga operatorët ekonomik..... , duke qenë se ata e disponojnë një dokument të vlefshëm, për të qarkulluar dhe transportuar mallra në rrugë. Sa i përket mjetit autovinç me targë TR5800B, është konsideruar si mjet që kryen vetëm funksionin e vinçit dhe si i tillë nuk ka detyrimin për të pajisur me leje transporti. Gjithashtu ju bëjmë me dije se në kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.8 të kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST, nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin foto të mjeteve. Sa më sipër, ato që ju citoni, janë konsideruar nga KVO si devijime të vogla që nuk çënojnë në thelb objektin e kontratës, e bazuar kjo edhe në frymën që parashikon ligji i prokurimit publik, në nenin 92..... . Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit “çmimi më i ulët”, të përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure, ... kjo në referencë të pikës 3, të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar..... .

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron: Ju nuk keni paraqitur

prova dhe fakte të reja, pretendimet tuaja janë të njëta me ato të paraqitura për akt konstatimet, për të cilat ne jemi shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Gjithsesi sqarojmë përsëri se:

-Lidhur me pretendimin për **me konstatimet për pikën 2.2.2. dhe konstatimet për pikën 2.3.8.** “Kapaciteti teknik”, për për mjetet me qera të cilat certifikatën e transportit e kanë për përdorim vetjak, **Grupi i auditimit i ka pranuar objeksionet tuaja, dhe i ka marrë parasysh në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit, duke i konsideruar si devijime të vogla që nuk çënojnë në thelb objektin e kontratës. Kjo tregon mungesë vëmendje nga ana juaj në leximin e projekt raportit të auditimit të dërguar në bashkinë tuaj.**

Lidhur me pretendimet e tjera që keni paraqitur në observacion, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë, pasi konsiderohen të pa argumentuara, konkretisht:

Lidhur me konstatimet për pikën 2.2.3, për mos paraqitjen e vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore nga disa bashki, pretendimi juaj nuk pranohet, pasi ju keni verifikuar kontrata e ngjashme të këtyre operatorëve dhe detyrimisht duhet të kishit kërkuar sqarime lidhur me faktin që ata kanë kryer aktivitet në bashkitë përkatëse, por nuk kanë paraqitur vërtetim taksash, aq më tepër që një rast lidhet me aktivitet të kryer në Bashkinë . Ju shpreheni se në kriteret e përcaktuara kërkohet “Shlyerja e detyrimeve dhe tarifave vendore për vitin 2024....”, në fakt referuar kriteret të vendosura nga NJP, është përcaktuar “Shlyerja e detyrimeve dhe tarifave vendore për vitin 2023....”.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.2.3- OE A. sh.p.k nuk disponon kategorinë e licencës NP-12 C në këtë rast pretendimi juaj është i pa argumentuar, pasi ky OE, nuk zotëron fare kategorinë e licencës NP-12, dhe nuk ka të bëjë me vlerën e kontratës, pra nuk kemi mangësi të nivelit të kategorisë, por mungon në licencën e zbatimit të OE “A” shpk. Lidhur me OE “K” shpk jemi shprehur që është përfshirë gabimisht, ndaj nuk është trajtuar Projekt raport, kjo tregon që ju nuk e keni lexuar.

Lidhur me konstatimet për pikën 2.3.7. -ku sipas konstatimit të KLSH-së, për disa punonjës, ka përfunduar kontrata e punës, pretendimet tuaja nu qëndrojnë, ndaj nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

3-Lidhur me observacionin e paraqitur me shkresën nr. 190/36, nga Kryetari i Bashkisë z. O.I dhe punonjësit në cilësinë e antarëve të Njesisë së prokurimit, B.F(Person pergjegjes), TH.GJ(Specialist fushe- ing Ndertimi), F.A(anëtar -ekonomist).

Pretendimi i subjektit

Lidhur me ngarkimin me përgjegjësi për hartimin e preventivave të fondit limit, kryetari i bashkisë dhe njësia e prokurimit shprehin jo dakordësi dhe kundërshti ,....pasi kjo nuk është një detyrë e tyre. Njësia e prokurimit ka administruar projekt-preventivat dhe çdo dokument tjetër që përfshihet në projekt, dokumente të cilat kanë qenë të miratuara nga kryetari i bashkisë dhe kanë kaluar oponencën teknike dhe miratimet përkatëse edhe pranë institucioneve kompetente.... . Njësia e prokurimit nuk ka kompetencat dhe kapacitetet teknike për kontrollin teknik të projektit, pasi asnjë nga anëtarët nuk ka licencë profesionale për ta bërë këtë...

Njësia e prokurimit dhe kryetari i bashkisë, nuk mundën kurrësesi të ndërhyjnë në zërat apo volumet e përcaktuara nga projektuesi në seksione të veçanta të preventivit, pasi kjo është kompetencë e subjekteve projektuese të licencuara për këtë qëllim dhe që për më tepër kanë kaluar në sitën e kontrollit në Institutin e Ndërtimit dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM). Në këtë rast njësia e prokurimit bën vetëm kontrollin aritmetik dhe nuk ndërhyjnë në aspekte që lidhen me përmasa..... . Lidhur me gabimet teknike të projektimit(prerje, vizatime, ...) kryetari i bashkisë dhe as njësia e prokurimit nuk kanë atributet ligjore dhe as kompetencat profesionale për të mbajtur përgjegjësi të kësaj natyre,..... kjo referuar përcaktimeve ligjore.....

shtrohet pyetja: A mund të kenë përgjegjësi NjP dhe Kryetari i Bashkisë, kur projektuesi ka bërë përlogaritjet të gabuara teknike, si përmasa themelesh, llogaritje hekuri..... . Nj P bën vetëm kontroll aritmetik dhe nuk ndërhyr në aspekte teknike të projektit..... . Referuar VKM nr. 759, datë 12.11.2014, kjo është kompetencë e subjekteve projektuese të licencuara..... .

Sqarojmë se: Hartimi i projekt-preventivit “Ndërtimi i shkollës Gjokë Doçi”, është realizuar nga subjekti “I” shpk, ndërsa hartimi i projekt-preventivit për objektin “**Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës**” është realizuar nga subjekti “S” shpk. Këto subjekte janë të pajisura me licenca profesionale sipas kërkesave ligjore përcaktuara në nenin 5 të Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Ju bëjmë me dije se objekti “Ndërtimi i shkollës Gjokë Doçi” i është nënshtruar dhe **ka kaluar Oponencën Teknike nga Instituti i Ndërtimit.** Ndërsa objekti “Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës”, përveçse i është nënshtruar dhe **ka kaluar Oponencën Teknike nga Instituti i Ndërtimit ka marrë edhe miratimin me Vendim nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM),** si institucioni i specializuar, në referencë të kërkesave ligjore përcaktuara në Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”.... .(Oponencat Teknike dhe Vendimin e KKDM, ju a kemi vënë në dispozicion në observacionin e mëparshëm)..... .

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron: Ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, pretendimet tuaja janë të njëta me ato të paraqitura për akt konstatimet, për të cilat ne jemi shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Gjithsesi sqarojmë përsëri se:

Pretendimet tuaja nuk janë të argumentuara, ndërsa sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur për ngarkim përgjegjësie jashtë atyre çfar përcakton kuadri ligjor, më konkretisht: Përgjegjësia e Bashkisë (kryetari, anëtarët e njësisë së prokurimit), qëndron në administrimin e dokumentacionit në përputhje me nenin 21 pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet: “Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit”, në këtë rast ju nuk ngarkoheni me përgjegjësi për pjesën teknike të hartimit të projektit apo preventivit të fondit limit, por për mënyrën si është proceduar për administrimin e dokumentacionit(marrja në dorëzim e projekt-preventivit dhe verifikimin e dokumentacionit të hartuar nga subjektet projektuese). Ju pretendoni në observacion se NjP ka vijuar procedurën, pasi projekti dhe preventivi janë marrë në dorëzim nga strukturat përkatëse të bashkisë, por në fakt nuk rezulton të ketë ndonjë urdhër apo dokument që pasqyron marrjen në dorëzim nga projektuesi. Pikërisht këto mangësi në lidhje me administrimin e dokumentacionit, sjellin përgjegjësi për personat përkatës. Në asnjë rast nuk mund të ngarkoheni më përgjegjësi për mangësi teknike të hartimit të projektit, por në rastin konkret kemi të bëjmë edhe me gabime të mëdha aritmetike, në preventivin e fondit limit, gjë e cila do të ishte shmangur, po të ishte trguar vëmendje dhe një kontroll aritmetik nga ana juaj,(siç e pohoni edhe vetë është detyrë e NjP).

4-Lidhur me observacionin e paraqitur me shkresën nr. 190/35, nga punonjësit në cilësinë e antarëve të Njësisë së prokurimit, B.F(Person përgjegjës) dhe F.A(anëtar -ekonomist).

Pretendimi i subjektit

Sqarojmë se: Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtareve që të përfshirë në procedurat e prokurimit janë të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik, kjo e reflektuar edhe në dokumentacionin e

procedurave(urdhra prokurimi, procesverbale, etj), ndaj nuk mund të ketë përgjegjësi në grup pune..... .Kjo provohet edhe nga fakti që specialisti i fushës, ka hartuar individualisht kriteret e veçanta dhe ka paraqitur individualisht observacionet.... . Praqesim argumentet si me poshtë:

Njësia e Prokurimit në Bashkinë Mallakastër, gjatë vitit 2024 ka funksionuar si një komision 'Ad Hoc' që ngrihet rast pas rasti, pra nuk ka qenë një strukturë e përhershme e që merret vetëm me çështje të prokurimit publik, por anëtarët e përfshirë në Njësi, përveç kësaj ngarkese, kanë pasur edhe ngarkesën e detyrave të tyre funksionale sipas pozicioneve të punës në strukturën e institucionit. Procesi i punës së personit përgjegjës për prokurimin është i mirëpërcaktuar nga legjislacioni i prokurimit publik. Konkretisht në pikën 3, të nenit 74, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Gjithashtu edhe anëtari tjetër i njësisë me profesion ekonomist, limitohet vetëm në kërkesat me karakter ekonomik. ***Pra, personi përgjegjës për prokurimin dhe anëtari tjetër i njësisë me profesion ekonomist nuk angazhohen dhe nuk kanë përgjegjësi për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik apo informacione të tjera teknike për procedurën e prokurimit, pasi hartimi dhe argumentimi i tyre është detyrë është detyrë e specialistit të fushës.*** Kërkesat e veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik apo informacione specifike me natyrë teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 78, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021..... . Kjo gjë është e përcaktuar qartësisht jo vetëm në legjislacionin në fuqi, por edhe në çdo urdhër prokurimi..... , si dhe në pikën 2, të nenit 78, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron: Ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, pretendimet tuaja janë të njëta me ato të paraqitura për akt konstatimet, për të cilat ne jemi shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Gjithsesi sqarojmë përsëri se:

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron; pretendimet tuaja nuk janë të argumentuara. *Sqarojmë se dakordësohemi se përgjegjësia ndahet në bazë të detyrave dhe funksionit që kryen çdo person, ndërsa në konstatimin tonë, kemi përcaktuar përgjegjësitë si grup pune, pasi në zhvillimin dhe administrimin e të gjithë procesit të prokurimit(lidhur me konstatimet e grupit të auditimit), nuk mund të shmangen nga përgjegjësia anëtarët e e tjerë të NjP. Procesverbali i argumentimit të specifikimeve tëknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, miratohet dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e NjP, ku sipas përcaktimeve ligjore, përbërja e anëtarëve të NjP duhet të jetë numër tek(pasi ushtrohet e drejta e miratimit/kundërshtimit). Sqarojmë se grupi i auditimit është i qartësuar lidhur me nivelin e përgjegjësive për çdo anëtarë të NjP, kjo në referncë të përcaktimeve ligjore përcaktuar në VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Për rrjedhojë konsatimet tona mbeten të pandryshuara.*

5-Lidhur me observacionin e paraqitur me shkresën nr. 190/34, nga punonjësit në cilësine e antarëve të Komisionit për Përllogaritjen e fondit limit dhe Specifikimeve Teknike, E.Y, Ferat Beqiraj, F.A dhe E.Xh

Pretendimi i subjektit

..... Bazuar në Urdhërin e Brendshëm të Drejtorit të NSHP nr.18, datë 07.06.2024 ... , Komisioni ka hartuar dokumentacionin teknik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, pjesë e të cilit është Akti Teknik nr.94/1 regj, datë 12.06.2024, nëpërmjet të cilit është bërë parashikimi sasiore, si dhe përllogaritja e fondit limit për një periudhë 12 mujore.... . Lidhur me parashikimin sasiore për të përmbushur nevojat e furnizimit me karburant, Komisioni është referuar në të dhënat sasiore të furnizimeve të realizuara nga mjetet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike gjatë vitit 2023,

Gjithashtu, lidhur me parashikimin sasior është marrë në konsideratë numri i automjeteve, proceset e shërbimeve dhe punëve që pritet të realizohen, si dhe planifikimi për blerjen e një mjeti të ri (përshkruar në mënyrë analitike në tabelën bashkëlidhur). Gjithashtu në përcaktimin e sasisë së mësipërme janë marrë në konsideratë, plan shpërndarjet e 12 muajve të mëparshëm për secilin mjet, normat e konsumit të karburantit (akte teknike) t ë disa mjeteve, si dhe plani i punës së NSHP (bashkëlidhur). Në këtë referencë komisioni ka përcaktuar sasinë e nevojshme (e pritshme) prej 106.600 litra, për të përmbushur nevojat e NSHP, për një periudhë 12 mujore. Sasia e karburantit e planifikuar si më sipër, është një sasi e pritshme dhe paraprakisht e përlllogaritur sipas kushteve aktuale. Kjo sasi mund të ndryshojë në rritje ose zbritje, në varësi të çmimeve të karburantit, i cili diktitet nga bursa. Gjithashtu janë marrë në konsideratë plan shpërndarjet e 12 muajve të mëparshëm për çdo mjet, normat e konsumit dhe plani i punës së NSHP-së(bashkëlidhur)..... Procedura është kryer referuar në nenin 12 pika 9 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron: Ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, pretendimet tuaja janë të njëta me ato të paraqitura për akt konstatimet, për të cilat ne jemi shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Gjithsesi sqarojmë përsëri se:

Pretendimet tuaja janë të pa argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në fakte të dokumentuara. Grupi i auditimit sqaron se, lidhur me përcaktimin e fondit limit, mungaon një analizë e detajuar, lidhur me normat e harxhimit të mjeteve, gje e cila nuk argumentohet nga ana juaj, më hollësisht konstatimet tona janë trjatur në aktin e konstatimit. Me gjithëse ju i referoheni një përcaktimi ligjor, lidhur me përcaktimin e fondit limit në referncë të kontratave të mëparshme, kjo nuk mund të vlejë në rastin konkret, pasi kushtet e përdorimit të mjeteve nuk janë të njëjta nga viti në vit, pasi ndryshon norma e amortizimit, ndryshojnë proceset e punës, etj, për rrjedhojë kërkohet detyrimisht një analizë detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet, si për ato të transportit edhe për mjetet teknologjike. Ju citoni në observacion, se keni bashkëlidhur *plan shpërndarjet e 12 muajve të mëparshëm për çdo mjet, normat e konsumit dhe plani i punës, por në fakt nuk rezultojnë gjendje bashkëlidhur observacionit të dërguar nga ana juaj.*

-Lidhur me observacionin e paraqitur me shkresën nr. 190/33, nga E.Y në cilësinë e antarëve të Komisionit për Përlllogaritjen e fondit limit dhe Specifikimeve Teknike(specialist i fushës).

Pretendimi i subjektit

Në cilësinë e specialistit të fushës kam hartuar kriteret e kualifikimit, për këtë qëllim kam mbajtur procesverbalet përkatëse “Mbi hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik”, ku është përcaktuar dhe argumentuar çdo kërkesë e vendosur, duke mbajtur në konsideratë parimin e mosdiskriminimit... . Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit për vendosjen e disa kriterëve të pa argumentuara, **sqarojmë:**

Lidhur me konstatimet për pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, ku është kërkuar: Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin “Vërtetim që OE nuk ka masë administrative për respektimin e kërkesave të standardit teknik të naftës”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) gjatë vitit 2024, si dhe “Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar gjatë vitit 2024, nga ISHTI.... .

Për këtë kërkesë është bërë edhe argumentimi përkatës..... . Sqaroj se ky është një kriter është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 dhe pikën 6/c nei 40, të VJM nr. 285, datë 19.05.2021.....

Sqaroj se ky kriter i vendosur gjerësisht në procedurat e prokurimit që zhvillohen thuajse nga të gjitha autoritetet kontraktore. Nga informacioni që kemi marrë gjatë testimit, nga subjektet tregtuese na është bërë me dije se “Fletë Analizë” / “Raport Testimi” është një dokument që bëhet

në mënyrë të detyrueshme çdo vit nga ISHTI..... . Duke qenë se ky dokument lëshohet 1 herë në vit, është parë e arsyeshme të kërkohet me qëllim provimin e përmbushjes së specifikimeve teknike nga OE.. . Gjithashtu nuk ka patur rekomandime për heqje apo ndryshim kriteresh nga APP-ja si institucioni më i lartë në fushën e prokurimeve, pra të gjitha kriteret e kësaj procedure janë konsideruar në përputhje me natyrën dhe përmasat e konkurrencës. Lidhur me sugjerimet tuaja për vendosjen e kriterëve të tjera në këtë procedurë, ju bëjmë me dije se kam mbajtur në konsideratë parimin e mosdiskriminimit dhe vendosjen e kërkesave sa më objektive dhe në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim sigurimin e një pjesëmarrjeje të gjerë dhe nxitjen e konkurrencës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Lidhur me pretendimet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit sqaron: Ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, pretendimet tuaja janë të njëta me ato të paraqitura për akt konstatimet, për të cilat ne jemi shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Gjithsesi sqarojmë përsëri se:

Pretendimet tuaja janë të pa argumentuara dhe nuk i përgjegjen konstatimeve të Grupit të auditimit, pasi në konstatimet tona nuk kemi konsideruar si të panevojshëm “Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), por jemi shprehur që ky dokument duhet të jetë prezent dhe i disponueshëm, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, për tu siguruar që produkte plotëson standardet e cilësisë. Gjithashtu në konstatimet tona jemi shprehur se krahas kërkesës disponimin e një stacioni furnizimi me karburant, të paraqitej dokumentacioni i lëshuar nga enti kompetent, që vërteton kolaudimin dhe verifikimin periodik të instrumentit matës(pistoletat e karburantit), për të konfirmuar që sasi dhënia e karburantit është brenda parametrave të lejuar. Sqarojmë se përfshirja në kërkesat e dokumentacionit shoqërues të stacionit të furnizimit të karburantit, nuk kufizon pjesmarrjen, përkundrazi ndikon në përmirësimin e përputhshmërisë ligjore nga OE, duke sjellë siguri në zbatimin e kontratës.

4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punëve publike dhe investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin për “Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ligjeve/rregullave specifike të institucionit që auditohet.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti:

- Dosja e zbatimit të punimeve.

1. “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, Bashkia Mallakastër

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Mallakastër, u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1973/5 prot., datë 19.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër, të përfaqësuar nga Kryetari z. Q.I dhe të BOE “2T” ShPK & “E” ShPK & “Shk” ShPK & “B” ShPK me përfaqësues ligjorë respektivë A.S, E.B, SH.K dhe z. K.B me licenca profesionale NZ 3455/13, NZ 4047/17, NZ 5586/8 dhe NZ 5430/16. Vlera e kontratës është 497,726,607 lekë me TVSh. Me shkresën nr. 5104/3, datë 11.11.2022 është bërë amendamenti për shtyrje afati të punimeve me 4 muaj, deri në datën 16.03.2023, për arsye të problematikave të dala në objekt dhe rritjes së çmimeve të materialeve (e cila reflektohet në Aktin normativ nr. 10, datë 18.05.2022). Me shkresën nr. 1290/4, datë 28.04.2023 është bërë

amendamenti për shtyrje afati të punimeve me 183 ditë, deri në datën 15.09.2023, për arsye të problematikave të dala në objekt dhe rritjes së çmimeve të materialeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 2382/12 prot., datë 16.11.2020, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE “E” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1174/6 dhe me vlerë të kontratës 4,328,038 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, edhe pse punimet kanë përfunduar në datën 24.07.2024, akoma nuk është caktuar kolaudatori i punimeve. Në dosje administrohet një shkresë e AKUKM me nr. 890 prot., datë 05.05.2021, sipas të cilës ky institucion “... do të jetë në rolin e investitorit (kolaudatorit) dhe do të kryejë kolaudimin e objektit, duke përfshirë edhe përfaqësues (inxhinierë të licencuar) nga Bashkia/Shoqëria UK për këtë objekt”. Bashkia Mallakastër me shkresën nr. 958, datë 03.03.2025, ose 216 ditë pas përfundimit të punimeve, i kërkon AKUKM caktimin e personave për kolaudimin e punimeve të këtij objekti. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12, sipas të cilit “Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Investitori do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit” dhe ngarkon me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Mallakastër z. Q.I.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, është dhënë leje infrastrukturore me Vendimin nr. 02, datë 26.10.2020 dhe nr. 08, datë 30.12.2021 për ndryshimin e projektit.

- Projektpreventivi është hartuar nga shoqëria “E” ShPK në vitin 2017.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 16.11.2020 dhe sipas shkresës nr. extra datë 24.07.2024, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 3709, datë 24.07.2024, kanë përfunduar në datën 24.07.2024, ose 311 ditë jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve (deri në datën 15.09.2023, datë që duhet të përfundonte objekti sipas amendamenteve). Nga verifikimi i pagesave të kryera për këtë objekt, rezulton se deri më sot janë paguar 388,417,445 lekë dhe kanë mbetur pa u paguar 109,309,162.

Në observacionin e paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve, është bërë miratimi i grafikut të ripunuar të punimeve me datë 15.09.2023, sipas të cilit punimet do të vazhdojnë deri në Shtator 2024, dokument që nuk administrohej në dosjen teknike ne fazën e auditimit.

- Në dosjen teknike administrohet situacioni përfundimtar i nënshkruar vetëm nga sipërmarrësi i punimeve dhe i pa miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve. Objekti vazhdon të shfrytëzohet nga SHRUK Fier, e cila ende nuk e ka marrë në dorëzim, pavarësisht se është në shfrytëzim nga komuniteti.

- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se është mbajtur një proceverbal për ndryshimin e volumeve ndërmjet Mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, me datë 22.04.2023, që është pasuar me tabelën e volumeve faktike. Ky procesverbal është i shoqëruar nga tabela e ndryshimeve “Punimet që hiqen dhe shtohen”, ku janë shtuar 233,239,471 lekë dhe pakësuar 218,110,540 lekë, duke përdorur edhe 15,128,932 lekë nga fondi rezervë, i cili rezulton të jetë në vlerën 23,323,388 lekë. Sipas raportit të mbikëqyrësit, kontrata është reduktuar në vlerën 8,194,456 lekë. Ndryshimet e projektit në masën 46.8 %, tregojnë që projekti është hartuar jo sipas gjendjes faktike, duke ngarkuar me përgjegjësi shoqërinë “E” ShPK, në cilësinë e projektuesit të këtij objekti. Në këtë procesverbal konstatohet se janë shqyrtuar edhe çmimet për 15 zëra të rinj pune (analizat administrohen në dosjen teknike).

Nga auditimi i çmimeve të zërave të rinj konstatohet se nga ana e sipërmarrësit është bërë një testim tregu, në lidhje të zërat e rinj të kësaj kontratë, të cilët nuk janë parashikuar në kontratën fillestare. Pas këtij testimi, me procesverbalin datë 22.04.2023, i mbajtur ndërmjet sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe përfaqësuesve të investitorit, është bërë miratimi i 15 zërave të rinj.

- Është hequr si zë pune “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 16”, i ofertuar me çmimin 2500 lekë/ml, në sasinë 1499 ml, në vlerë totale 3,747,500 lekë, i cili është zëvendësuar në mënyrë të paargumentuar teknikisht (pa patur një llogaritje të saktë të sistemit hidraulik) me zërin e ri “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 20”, me çmimin e dakordësuar 6741 lekë/ml, në sasinë 1227 ml, në vlerë totale 8,271,316.2 lekë, duke e shtuar vlerën e objektit me **5,203,707** (1227 ml x (6741 – 2500 lekë/ml)), vlerë që përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve të bashkisë Mallakastër.

Nga kontrolli në terren u konstatua se tubacionet PE të përdorura në objekt, nuk kanë matrikulimet e duhura, ku të jenë shënuar PN, diametri, spesori, viti i prodhimit, etj., veprim që mbart riskun për të qenë jo sipas cilësisë së kërkuar në specifikimet teknike.

Është konstatuar gjithashtu se me punimet e kryera për këtë objekt, janë përmirësuar 15303 m³ rrugë të qytetit, që nuk kanë lidhje me këtë objekt. Nisur nga çmimet e shtresave rrugore (stabilizant + binder + asfalt) në total 2716 lekë/m², rezulton të jenë kryer punime pa efikasitet në vlerën 41,562,948 lekë (15303 m² x 2716 lekë/m²). Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve dhe kryetari i Bashkisë Mallakastër z. Q.I.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”,				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1973/5 prot., datë 19.10.2020	15.Vlera e kontratës (pa tvsh) 497,726,607 lekë BOE fitues “2” ShPK & “E” ShPK & “Sh” ShPK & “B” ShPK		16.Likuiduar deri dt 23.12.2024 388,417,445 lekë. Mbetur papaguar 109,309,162 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 489,532,151 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 730 ditë, Zbatuar 1344 ditë. Fillimi punimeve: 16.11.2022 Përfundimi punimeve: 24.07.2024		19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. nr. 5104/3, datë 11.11.2022, për shtyrje afati të punimeve me 4 muaj, deri në datën 16.03.2023 Amendamenti nr. nr. 1290/4, datë 28.04.2023, për shtyrje afati të punimeve me 183 ditë, deri në datën 15.09.2023; Grafik i ripunuar, me afat deri ne Shtator 2024.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “E” ShPK	Licenca Nr: MK. 1174/6	Shkresa me nr. 2382/12 prot., datë 16.11.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Nuk ka			Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Nuk ka	23.Certifikaata e përfundimit të punimeve Nuk ka		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **602,810 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
	32	Mure butobetoni C 12/15	m ³	9656	1324.2	1324.2	1302.4	21.8	210,500
A-2/5		Ndërtim rrugë për depo							
	1	Gërmim dheu me ekskavator	m ³	290	2917.7	2917.7	1978.7	939	272,310
		FV matësa në objekte pallat (kasetat metalike)	copë	8,000				15	120,000
								Total	602,810

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri A-2.32. Mure butobetoni C 12/15. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 20 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1324.17 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1324.14 m³, i detajuar sipas mureve rrethues, mureve mbajtës të depos, me gjatësi dhe lartësi të ndryshueshme. Nga verifikimi i librit të masave, rezulton se muri mbajtës i shembjes në rrugë është marrë me sipërfaqë 4.91 m² dhe gjatësi 23.7 ml dhe jo me sipërfaqe 3.99 m², sipas vizatimeve të projektit të azhurnuar. Nga rillogaritja, volumi i këtij muri është 94.6 m³, ose 21.8 m³, më pak se volumi i librezuar dhe situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri A-2/5.1. Gërmim dheu me ekskavator. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 160 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 2917.7 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2917.7 m³, i detajuar sipas rrugëve për në të tre depot me sipërfaqe dhe gjatësi të ndryshueshme dhe me trashësi 0.5 m – 0.7 m për rrugët e depos 1000 m³ dhe 0.3 m për rrugën e depos 50 m³ dhe me një shifër të vetme 1343.6 m³ për rrugën në depon e Lavdanit. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se gjatësia e rrugës për në depon e Lavdanit është 270 m dhe thellësia sipas shtresave të miratuara është 0.5 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1978.7 m³, ose 939 m³, më pak se volumi i librezuar dhe situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri FV Matësa objekte pallat. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se në pallatin pranë menciës së naftëtarëve, në një hyrje me 15 apartamente, nuk janë vendosur kasetat metalike 30 x 60 cm, të cilat në situacion figurojnë me çmimin 8000 lekë/copë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Gjithashtu, rezulton se nuk janë vendosur në vepër pajisjet e parashikuara (sipas tabelës nr. 2), për shkak të mungesës së dorëzimit (rojeve) dhe energjisë elektrike, të cilat, sipas observacionit të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve, do të vendosen dhe verifikohen para kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të objektit. Këto zëra janë si më poshtë:

Tabela nr. 2

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
AIV	1	Furnizim impianti i klorifikimit	copë	502,051	2	2	1	1	502,051
A-IV/2		Makineri dhe Pajisje							2,928,506

A-6	4	FV Hard disk 6 TB, i prodhuar për sisteme CCTV	copë	85000	5	5	2	3	255,000
	5	FV switch 8 porta	copë	75000	5	5	2	3	225,000
AIV	1	FV Kamera 6 MPX	copë	170,800	28	28	25	3	512,400
	2	FV Kamera 3 MPX	copë	292,500	10	10	8	2	585,000
	3	FV NVR Profesional	copë	8,000				15	120,000
B/1	17	FV Prozhektorë	copë	25956	30	30	0	30	778,680
Total									<u>7,775,637</u>

1. Zëri IV/I.4 Furnizim impianti i klorifikimit (depot e reja). Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se është vendosur 1 copë, ose 1 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Kapitulli A-IV/2. Makineri dhe pajisje. Në preventivin bazë, preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, vlera e këtij kapitulli është 2,928,506 lekë. Në fakt, zërat e këtij kapitulli, nuk rezultojnë të jenë kryer. Për pasojë, vlera e këtij volumi nuk duhej situacionuar.

3. Zëri A-46.4 FV Hard disk 6 TB, i prodhuar për sisteme CCTV. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 6 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 5 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 5 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë vendosur 2 copë, ose 3 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri A-46.5 FV Switch 8 porta. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 3 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 5 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 5 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë vendosur 2 copë, ose 3 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

5. Zëri IV/2.1 FV Kamera 6 MPX. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 18 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 28 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 28 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë vendosur 25 copë, ose 3 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

6. Zëri IV/2.2 FV Kamera 3 MPX. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 3 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 10 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 10 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë vendosur 8 copë, ose 2 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

7. Zëri IV/2.3 FV NVR Profesional. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 5 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 5 copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë vendosur 2 copë, ose 3 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

8. Zëri FV Prozhektorë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 30 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 30 copë, i detajuar 10 copë në depon 1000 m³, nga 5 copë në depon 50 m³ dhe në depon e fshatit Lavdan dhe 10 copë në depon Kash. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se ky zë pune nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij zëri pune, është librezuar dhe situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE “E/M” ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2382/12 prot., datë 16.11.2020.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G.G, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. Q.I, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.

Përsa trajtuar në Projekt raportin e auditimit nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar

2-Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstrukison i Rugës Panahor –Ngracan(Segmenti Pnahor Subashaj) dhe Rugës Ballsh-Drenovë e Re(Segmenti depo uji-shkolla)” Bashkia Ballsh.

-Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1691/14 Prot., datë 12.07.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia, përfaqësuar nga Kryetari z. Q.I, dhe sipërmarrësit të punimeve BOE “K.M.K.” SHPK me licencë NZ.7591/11, me administrator z. K.C &“C” SHPK me licencë NZ.7778/9, me administrator Z. M.C, me kuota pjesmarrje përkatësisht 74.08% dhe 25.92% . Vlera e kontratës është 49,092,600 lekë pa TVSH ose 58,911,120 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është 8 muaj e përlllogaritur nga data e fillimit të punimeve. Ky afat është ndryshuar duke shtyrë përfundimin e punimeve me 26 ditë, sipas Amendimit të kontratës me nr.871/2, datë 28.02.2024, shtyrja është argumentuar për shkak të kushteve atmosferike jo të përshtatshme.

-Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin, është lidhur kontratë shërbimi me nr. 2829/2 Prot, datë 29.06.2, ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe OE “D” Shpk me administrator z. S.K, me Lic. MK 2. Kontrata e mbikëqyrjes ka vlerën 582,030 lekë me TVSH, me afat realizimi sipas afatit të zbatimit të punimeve.

-Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata nr. 3827/2, datë 04.07.2024 ndërmjet Bashkisë dhe OE “G” Shpk me administrator z. G.S, me Lic. MK 2. Vlera e kontratës së kolaudimit 69,723 lekë pa TVSH.

Më njoftimin nr. 3564/1, datë 18.07.2023, kanë filluar punimet, ndërsa Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me datë 01.05.2024, nga mbikëqyrësi i punimeve. Pjesë e dokumentacionit të dosjes së zbatimit është edhe Deklarata teknike e sipërmarrësit të punimeve, mbajtur me datë 01.05.2024. Akti i kolaudimit është hartuar datë 09.07.2024

Certifikata e Perkohshme e marrjes në dorëzim është hartuar pa datë, nga grupi i marrjes në dorëzim nr. 4797, datë 07.10.2024

-Me shkresën pa datë, dërguar nga mbikëqyrësi i punimeve, është kërkuar të rishikohet preventivi i punimeve, për të miratuar ndryshimet përkatëse nga palët. Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka miratuar preventivin e rishikuar.

Pjesë e dosjes janë procesverbalet për punimet e maskuara: për gjermim dhe me eskavator, kanale > 2 m, tokë kategoria III; Për mbushje me çakull të trupi të rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri(30-50 cm); Për shtresë stabilizanti t=10 cm; për gjermim dhe me krahë h= 1.5 m; për vendosje tombinosh me diametër 600 mm/mm; për shtresë binderi t=5 cm dhe shtresë asfaltobeton t=3 cm. Nga verifikimi i përmbajtjes së procesverbaleve të punimeve të maskuara, rezulton se ato përshkruajnë të dhëna të përgjithshme, duke përshkruar punimin e kryer në datën përkatëse, por nuk përshkruajnë dhe nuk saktësojnë vendin ku kryhet punimi i maskuar;

Pjesë e dosjes së zbatimit janë edhe aktet e kontrollit të mbajtura nga mbikëqyrësi i punimeve, gjatë inspektimeve që ka kryer në objekt, ku përshkruhen punimet e kryera në datat përkatëse;

Gjithashtu në dosje ndodhet Ditari i punimeve, i mbajtur për të gjithë periudhën nga data e fillimit të punimeve datë 18.07.2023 deri në përfundimin e tyre, datë 01.05.2024.

Në dosje ndodhen ndodhen Raportet e testimit për:

- Materialin çakull, të përdorur për shtresën 30-50 cm, ku janë kryer provat laboratorike për, plasticitetin, shpërndarjen e grimcave, densiteti+lagështia dhe Calofornia Bearing ratato(CBR);
- Materialin e përdorur për shtresën e stabiliznatit t= 10 cm, ku janë kryer provat laboratorike për, plasticitetin, shpërndarjen e grimcave, densiteti+lagështia dhe Calofornia Bearing ratato(CBR);
- Për betonet ku për 2 mostra janë kryer provat laboratorike lidhur me qëndrueshmërinë në shtypje;
- Lidhur me shtresat asfaltike janë kryer prova laboratorike për 3 mostra binderi dhe 3 mostra asfaltobeton, ku janë përcaktuar përmbajtja e bitumit dhe Analiza granuolometrike;

Situata 1

Lidhur me Raportet e testimit dhe Certifikatat e cilësisë së materialeve.

- Rezulton se provat laboratorike dhe raportet e testimit për nënshtresat dhe shtresat asfaltike, nuk janë kryer të plota. Për shtresat asfaltike, me sipërfaqe totale 19600 m², janë kryer provat laboratorike për 3-4 mostra secila. Referuar Specifikimeve Teknike provat laboratorike për shtresat asfaltike(binder, asfaltobeton) duhet të kryhen çdo 2500 m². Veprime në mospërputhje me Specifikimet Teknike, kushtet e kontratës dhe pikën 3, kreu II, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit", në të përcaktohet që:

- **pika 3:** " *Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike* "

Mungojnë skicat dhe detajet lidhur me prerjet tërthore dhe gjatësore përkatëse, pra mungon azhurnimi i i projektit në referencë të preventivit të ndryshuar.

- Nga verifikimi dokumentacionit në dosje(detajet e projektit të miratuar dhe të dhënave në librezën e masave), rezulton se ka diferencë në volume, si vijon:

- Zëri "Gjermim dhe me eskavator me goma, 0.25 m³, në kanale me gjërësi >2 m në tokë të zakonshme, me shkarkim në mjet"

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 12503 m³, në fakt duke ju referuar prerjeve(profileve) në projektin fillestar (pasi në projektin e azhurnuar mungojnë profilet), rezulton se kuotat e projektit dhe kouta e tokës nuk kanë ndryshime të konsiderueshme, ndërsa gjatë zbatimit gjermimi është llogaritur me përmasë fikse 50 cm thellësi(e pa argumentuar), duke e konsideruar si qëllim për vendosjen e nënshtresave(shtresë

çakulli 30 cm dhe shtresë stabilizanti 10 cm), thellësia takuese e gërmimit është 40 cm, për rrjedhojë është krijuar një diferencë volumi më tepër e pa argumentuar, prej 2500 m³[12503/5(diferenca në volum per 10 cm)], **me vlerë takuese 1,000,000 lekë**[2500(diferenca si volum i pakryer)*400 lek/ m³];

- Zëri “Shtresë stabilizanti t=10 cm(për bankinat)”

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 5342 m², në fakt duke ju referuar prerjeve(profileve) në projektin fillestar dhe në librezën e masave, rezulton se shtresa stabilizant për bankina ka trashësi 8 cm dhe është e njëjtë në trashësi me shtresën e asfaltit, ndërsa është llogaritur me trashësi 10 cm, për rrjedhojë nga diferenca në trashësi prej 2 cm(10-8), është krijuar një diferencë volumi më tepër e pa argumentuar, prej 1068 m²[5342/5(diferenca në volum per 2 cm)], **me vlerë takuese 213,600 lekë**[1068(diferenca si volum i pakryer)*200 lek/ m²];

- Zëri “ Mure b/a, t=21-30 cm, h deri 4 m, C 20/25”

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 40 m³, në fakt nga kontrolli i ushtruar në objektin e kontratës, ka rezultuar mungesa e 3 tombinove, përkatësisht 1 në segmentin Panahor – Subashaj dhe 2 në segmentin Depo e ujit-Shkolla, duke krijuar një diferencë volumi të pakryer prej prej 7.5 m³, e llogaritur në **vlerën takuese 82,500 lekë**[7.5 (diferenca si volum i pakryer)*11,000 lek/ m³];

- Zëri “ Tombino me tuba betoni me diametër 600 mmm, mbi shtresë betoni”

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 112.7 m, në fakt nga kontrolli i ushtruar në objektin e kontratës, ka rezultuar mungesa e 3 tombinove, përkatësisht 1 në segmentin Panahor – Subashaj dhe 2 në segmentin Depo e ujit-Shkolla, duke krijuar një diferencë volumi të pakryer prej prej 20.6 m, e llogaritur në **vlerën takuese 92,700 lekë**[20.6 (diferenca si volum i pakryer)*4500 lek/ m];

Për sa trajtuar ky aktkonstatimi mbahet me z. S.K, përfaqësues i subjektit “P” shpk, i kontraktuar për mbikëqyrjen e punimeve.

Lidhur sa trajtuar në Projekt raportin e auditimit nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar

3-Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstrukison i Rugës Rromës-Oafa e Drenovës(Segmenti Qendër Rromës-Lagja Tabakaj), Rrugës Fratar-Drizar dhe Rugës Nnesh-Nnenaj-Damës” Bashkia Ballsh.

-Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1785/13 Prot., datë 14.07.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia , përfaqësuar nga Kryetari z. Q.I, dhe sipërmarrësit të punimeve OE “L” SHPK me licencë NZ.4, me administrator z. A/LL. Vlera e kontratës është 45,366,340 lekë pa TVSH ose 54,439,608 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është 8 muaj e përlllogaritur nga data e fillimit të punimeve. Ky afat është ndryshuar duke shtyrë përfundimin e punimeve me 66 ditë, sipas Amendimit të kontratës me nr. 1133/2, datë 28.03.2024, shtyrja është argumentuar për shkak të kushteve atmosferike jo të përshtatshme.

-Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin, është lidhur kontratë shërbimi me nr. 2830/2 Prot, datë 30.06.2023, ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe OE “G” Shpk me administrator z. G.B, me Lic. MK 2812/5. Kontrata e mbikëqyrjes ka vlerën 584,188 lekë me TVSH, me afat realizimi sipas afatit të zbatimit të punimeve.

-Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata me OE “G” Shpk me administrator z. G.S.

Më njoftimin datë 17.07.2023, kanë filluar punimet, ndërsa Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me datë 02.04.2024, nga mbikëqyrësi i punimeve. Pjesë e dokumentacionit të dosjes së zbatimit është edhe Deklarata teknike e sipërmarrësit të punimeve, mbajtur me datë 01.05.2024. Akti i kolaudimit është hartuar me datë 02.05.2024, nëshkryar nga Sipërmarrësi, Mbikëqyrësi dhe Kolaudatori.

Certifikata e Perkohshme e marrjes në dorëzim është hartuar me shkresën nr. 2110/1, datë 07.05.2024, nga grupi i marrjes në dorëzim: A.S, A.X dhe B.V dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër Q.I.

-Me shkresën nr. 20 Prot, datë 28.02.2024 , dërguar nga mbikëqyrësi i punimeve, është kërkuar të rishikohet preventivi i punimeve, për të miratuar ndryshimet përkatëse nga palët. Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka miratuar preventivin e rishikuar me shkresën nr. 944/1, datë 06.03.2024. Pjesë e dosjes janë procesverbalet për punimet e maskuara: Për punime betoni në tre segmentet rrugore(vepra arti dhe punime betoni); për gjërmim dheu me eskavator, kanale > 2 m, tokë kategoria III, në tre segmentet rrugore; Për mbushje me çakull të trupi të rrugës, në tre segmentet rrugore, përhapur e ngjeshur me makineri(30-50 cm); Për shtresë stabilizanti t=10 cm, në tre segmentet rrugore; për shtresë binderi t=5 cm dhe shtresë asfaltobetoni t=3 cm, në tre segmentet rrugore.

Nga verifikimi i përmbajtjes së procesverbaleve të punimeve të maskuara, rezulton se ato përshkruajnë të dhëna të përgjithshme, duke përshkruar punimin e kryer në datën përkatëse, por nuk përshkruajnë dhe nuk saktësojnë vendin ku kryhet punimi i maskuar;

Pjesë e dosjes së zbatimit janë edhe aktet e kontrollit të mbajtura nga mbikëqyrësi i punimeve(gjithsej 9 Akte kontrolli), gjatë inspektimeve që ka kryer në objekt, ku përshkruen punimet e kryera në datat përkatëse;

Gjithashtu në dosje ndodhet Ditari i punimeve, i mbajtur për të gjithë periudhën nga data e fillimit të punimeve datë 17.07.2023 deri në përfundimin e tyre, datë 02.04.2024.

Në dosje ndodhen Raportet e testimit për betonet ku për 3 mostra që ju përkasin tre segmenteve rrugore, janë kryer provat laboratorike lidhur me qëndrueshmërinë në shtypje;

Për materialin çakull, të përdorur për shtresën 30-50 cm dhe materialin e përdorur për shtresën e stabiliznatit t= 10 cm, janë paraqitur Certifikata cilësie të lëshuara nga subjektet prodhuese të këtyre materialeve, të cilat i referohen të dhenave nga testet e laboratorit të akredituar, por në fakt në dosje mungojnë testet laboratorike.

Situata 1

Lidhur me Raportet e testimit dhe Certifikatat e cilësisë së materialeve.

- Rezulton se dhe raportet e testimit për shtresat asfaltike(binder, asfaltobeton), si dhe mungojnë provat laboratorike për nënshtresat. Referuar Specifikimeve Teknike provat laboratorike për nënshtresat(çakull, stabilizant) duhet të kryhen çdo 500 m², ndërsa për shtresat asfaltike duhet të kryhen çdo 2500 m². Veprime në mospërputhje me Specifikimet Teknike, kushtet e kontratës dhe pikën 3, kreu II, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 ”Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”, në të përcaktohet që:

pika 3: “ *Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike*”

Situata 2

- Nga verifikimi dokumentacionit në dosje(detajet e projektit të miratuar dhe të dhënave në librezën e masave), rezulton se ka diferencë në volume, si vijon:

- **Zëri** “Mbushje me çakëll e gure gurorje në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 6308 m^3 , e ndarë sipas segmenteve: Qendër Romës-Lagja Tabaka 2712 m^3 [2712(gjatësia e rrugës)*5(gjërësi)*0.2(trashësia e shtresës)]; Segmenti Ninësh-Nenaj-Damës 1998 m^3 [1800 (gjatësia e rrugës)*3.7(gjërësi)*0.3(trashësia e shtresës)]; Segmenti Fratar-Drizar 1598 m^3 [1440 (gjatësia e rrugës)*3.7(gjërësi)*0.3(trashësia e shtresës)];

Në fakt duke ju referuar detajeve të projektit të zbatimit(prejet tërthore), rezulton se për segmentin Qendër Romës-Lagja Tabaka, volumi i kryer për këtë zë punimi është 2712 m^3 , në përputhje me përmasat e përcaktuara në projekt.

Për segmentin Qendër Ninësh-Nenaj-Damës, me gjatësi 1800 m, sipas projektit të zbatimit rruga ka vetëm karrexhatën me gjërësi 3.5 m, nuk ka bankina. Referuar përmasave të përcaktuara në projektin e zbatimit, *Zëri “ Mbushje me çakëll e gure gurorje në trupin e rrugës...”*, llogaritet në **sasinë 1890 m^3** [1800 (gjatësia) *3.5 (gjërësia)*0.3(trashësia)]

Për segmentin Fratar-Drizar, me gjatësi 1440 m, sipas projektit të zbatimit rruga ka vetëm karrexhatën me gjërësi 3.5 m, nuk ka bankina. Referuar përmasave të përcaktuara në projektin e zbatimit, *Zëri “ Mbushje me çakëll e gure gurorje në trupin e rrugës...”*, llogaritet në **sasinë 1512 m^3** [1440 (gjatësia) *3.5 (gjërësia)*0.3(trashësia)]

Në total për tre segmentet, volumi për këtë zë punimi llogaritet në sasinë prej **6114 m^3** ($2712+1890+1512$). Për sa sqaruar, rezulton se për këtë zë punimi është situacionuar më tepër **një diferencë volumi prej 194 m^3** (6308 m^3 (sasia e situacionuar)- 6114 m^3 (sasia në fakt)), **me vlerë takuese $213,400 \text{ lekë}$** [194 (diferenca si volum i pakryer)* 1100 lek/ m^3];

- *Zëri “ Shtresë stabilizanti $t=10 \text{ cm}$ i ngjeshur me makineri”*

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 25548 m^3 , e ndarë sipas segmenteve: Qendër Romës-Lagja Tabaka 13560 m^2 [2712(gjatësia e rrugës)*5(gjërësi)]; Segmenti Ninësh-Nenaj-Damës 6660 m^2 [1800 (gjatësia e rrugës)*3.7 (gjërësi)]; Segmenti Fratar-Drizar 5328 m^2 [1440 (gjatësia e rrugës)*3.7(gjërësi)];

Në fakt duke ju referuar detajeve të projektit të zbatimit(prejet tërthore), rezulton se për segmentin Qendër Romës-Lagja Tabaka, volumi i kryer për këtë zë punimi është 13560 m^2 , në përputhje me përmasat e përcaktuara në projekt.

Për segmentin Qendër Ninësh-Nenaj-Damës, me gjatësi 1800 m dhe segmentin Fratar-Drizar, me gjatësi 1440 m, sipas projektit të zbatimit rruga ka vetëm karrexhatën me gjërësi 3.5 m, nuk ka bankina. Referuar përmasave të përcaktuara në projektin e zbatimit, për këto segmente rruge, volumi për këtë zë punimi llogaritet përkatësisht: **6300 m^2** ($1800*3.5$) dhe **5040 m^2** ($1440*3.5$)

Në total për tre segmentet, volumi për këtë zë punimi llogaritet në sasinë prej **24900 m^3** ($13560+6300+5040$). Për sa sqaruar, rezulton se për këtë zë punimi është situacionuar më tepër **një diferencë volumi prej 648 m^2** (25548 m^2 (sasia e situacionuar)- 24900 m^2 (sasia në fakt)), **me vlerë takuese $90,700 \text{ lekë}$** [1138 (diferenca si volum i pakryer)* 140 lek/ m^3];

- *Zëri “Shtresë stabilizanti $t=10 \text{ cm}$ (për bankinat)”*

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 4716 m^2 , e ndarë sipas segmenteve: Qendër Romës-Lagja Tabaka 4068 m^2 [2712 (gjatësia e rrugës)*1.5(gjërësi)]; Segmenti Ninësh-Nenaj-Damës 360 m^2 [1800 (gjatësia e rrugës)*0.2(gjërësi)]; Segmenti Fratar-Drizar 288 m^2 [1440 (gjatësia e rrugës)*3.7 (gjërësia)];

Në fakt duke ju referuar detajeve të projektit të zbatimit(prejet tërthore), rezulton se për segmentin Qendër Romës-Lagja Tabaka, volumi i kryer për këtë zë punimi është 4068 m^2 , në përputhje me përmasat e përcaktuara në projekt.

Për segmentin Qendër Ninësh-Nenaj-Damës, me gjatësi 1800 m dhe segmentin Fratar-Drizar, me gjatësi 1440 m, sipas projektit të zbatimit rruga ka vetëm karrexhatën me gjërësi 3.5 m, nuk ka bankina, për rrjedhojë nuk mund të ketë volum pune të kryer.

Për sa sqaruar, në total volumi për këtë zë punimi llogaritet vetëm për segmentin Qendër Romës-Lagja Tabaka, në sasinë prej 4068 m². Për sa sqaruar, rezulton se për këtë zë punimi është situacionuar më tepër **një diferencë volumi prej 648 m²** (4716 m²(sasia e situacionuar)-4068 m²(sasia në fakt)), **me vlerë takuese 90.700 lekë**[648 (diferenca si volum i pakryer)*140 lek/ m²]; - Zëri “ *Strukturë monolite C 16/20(veshje kanali)* ”

Në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, është pasqyruar volumi i kryer në sasinë 163 m³, nga e cila, volumi prej 79.3 m³ i përket veshje kanali në segmentin Qendër Rromës-Lagja Tabakaj, llogaritur me trashësi 10 cm. Nga verifikimi i bërë në objekt rezulton se trashësia e mesatare e shtresës së betonit për veshje kanali është 8.5 cm, duke krijuar një diferencë më pak në trashësi 1.5 cm, që i përket **volumi prej 11.9 m³** [1.5/10*79(volumi sipas situacionit)], që konsiderohet volum i pakryer.

Gjithashtu nga verifikimi në objekt, rezulton se në 2 segmente nga 30 m secili, faqja e kanalit nga ana e shkëmbit nuk është veshur me shtresë betoni, për një sasi prej 3 m³[60(gjatësia) *0.5(gjërësia e faqes kanali)*0.1(trashësia e shtresës)]

Në total është krijuar një diferencë si volum pune i pakryer prej **14.9 m³**(11.9+3) **me vlerë takuese 134,100 lekë**[14.9(diferenca si volum i pakryer)*9000 lek/ m³];

Gjithashtu nga verifikimi në terren, rezultoi se në segmentin Fratar-Drizar, në vendin para ndërtesës së vjetër(ish repart ushtarak), ka ndodhur dëmtim i shtresave asfaltike në një gjatësi rreth 60 m dhe gjërësi rruge 3.6 m, dëmtimi i shtresave llogaritet për një sipërfaqe prej 216 m² (60*3.6), *për secilën shtresë binder dhe asfaltobeton;*

Për sa trajtuar, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S, perfaqësues i subjektit OE “G” shpk, të kontraktuar për mbikëqyrjen e punimeve.

Përsa trajtuar në Projekt raportin e auditimit nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar

5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

5.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

5.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventari kontabël i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale.
2. Lista e inventarëve të transferuara sipas VKM-ve përkatëse.
3. Inventari i pasurive të paluajtshme dhe regjistrimi i tyre në Drejtorinë Vendore ASHK.
4. Lista e inventarit të pa pajisura me certifikatë pronësie.
5. Kontratat për dhënien me qira të asetëve, së bashku me praktikën shoqëruese.

Auditim mbi administrimin e asetëve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Mallakastër, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Mallakastër i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Mallakastër. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Mallakastër duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data

e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Mallakastër dhe Njësive Administrative Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar, Selitë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Mallakastër, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastër.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Mallakastër disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku në të specifikohet analitikët e këtyre llogarive si dhe në të paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Mallakastër ka në pronësi në total **1,652 pasuri** të cilat janë transferuar sipas VKM-ve si më poshtë:

➤ **Njësia Administrative Ballsh:**

-Me VKM nr. 161, datë 27.02.2013, “Për miratimin e listave së inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Ballsh”, janë transferuar gjithsej **274 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie**.

➤ **Njësia Administrative Kutë:**

-Me VKM nr. 758, datë 02.11.2011, “Për miratimin e listave paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore për Njësinë Administrative Kutë”, janë transferuar **169 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie**.

➤ **Njësia Administrative Qendër:**

-Me VKM nr. 71, datë 02.02.2011, “Për miratimin e listave së inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Qendër”, janë transferuar **277 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie**.

➤ **Njësia Administrative Hekal:**

-Me VKM nr. 244, datë 27.02.2008, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Hekal”, janë transferuar **207 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie**.

➤ **Njësia Administrative Ngraçan:**

-Me VKM nr. 33, datë 24.01.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Ngraçan”, janë transferuar **33 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Selitë:**

-Me VKM nr. 706, datë 19.10.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Selitë”, janë transferuar **203 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Aranitas:**

-Me VKM nr. 474, datë 18.07.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Aranitas”, janë transferuar **175 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Greshicë:**

-Me VKM nr. 93, datë 31.01.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Greshicë”, janë transferuar **78 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Fratar:**

-Me VKM nr. 31, datë 24.01.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Greshicë”, janë transferuar **263 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

Shënim: Sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave ka kaluar në mënyrë përfundimtare me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, e ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”.

c. Në total në pronësi të Bashkisë Mallakastër janë **1,652 pasuri** të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura **për të cilat asnjë pasuri nuk është pajisur me çertifikatë pronësie.**

d. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Mallakastër **të cilat janë të evidentuara në kontabilitet asnjë prej tyre nuk posedon titull pronësie.** Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit, me objekt: “**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024,** u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Dokumentacioni në sistemin “E-leje”;*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;*
- *Dokumente të tjera nga arkiva, etj.*

Referuar të dhënave në sistemin elektronik **e-lejet** për Bashkinë Mallakastër rezulton se, për periudhën objekt auditimi nga data **01.01.2024, deri në 31.12.2024,** janë miratuar gjithsej 5 leje ndërtimi nga të cilat 2 leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250 m² dhe një leje ndërtimi me sipërfaqe

me te vogel se 250m² dhe 2 leje për ndryshim funksioni. Janë miratuar 5 leje për certifikata përdorimi si dhe 2 leje infrastrukurore **Tabelën nr. 1.**

- **Tabela nr. 1.**

Viti 2024			
Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje ndërtimi mbi 250m ²	3	3	0
Leje ndërtimi deri 250m ²	1	1	0
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	1	1	0
Ndryshim funksioni	2	2	0
Njoftim fillim punimesh	4	4	0
Leje infrastrukture	2	2	0

- Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve (këtu e në vazhdim DAZHTLP), Bashkia Mallakastër, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të madhe se 250 m² janë miratuar **2 leje, nga të cilat 1 leje është investitor bashkia,** leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të vogël se 250 m² është miratuar **1 leje,** ndërsa certifikata përdorimi janë miratuar **4 të tilla,** të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m² dhe certifikata përdorimi:

Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Shtesë kati mbi objekt ekzistues	A.Y	Vendim Nr. 09, datë 16.07.2024
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Ndërtim magazine 1k me bodrum për grumbullim të prodhimeve bujqësore	K.K	Vendim Nr. 15, datë 24.09.2024
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Ndërtim shkolle "Gjok Doçi", Damës	Bashkia Mallakastër	Vendim Nr. 08, datë 28.06.2024
Lejeje për ndryshim funksionit	Objekt shërbimi 3 kate	LL	Vendim Nr. 14, datë 12.09.2024
Lejeje për ndryshim funksionit	Ndryshimi i aktivitetit dhe funksionit të njësisë individuale lloji: apartament në njësi individuale lloji: njësi	SH.LL	Vendim Nr. 20, datë 21.11.2024
Çertifikate përdorimi	Ndërtim godine shërbimi 1 kat (+1 kat nëntok)	A	Vendim Nr.12, datë 15.04.2022
Çertifikate përdorimi	Ndërtim objekti banimi me 1 kat	L.R	Vendim Nr.22, datë 30.08.2022
Çertifikate përdorimi	Banesë 1 kat	N.K	Vendim Nr.37, datë 10.11.2021
Çertifikate përdorimi	Rindërtim banese ekzistuese 1 kat	S.K	Vendim Nr.05, datë 01.02.2022
Çertifikate përdorimi	Ndërtim magazine grumbullimi për produkte bujqësore	S.T	Vendim Nr.11, datë 25.05.2023

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditim 2 leje ndërtimi nga ku rezultoi se dokumentacioni i ngarkuar në sistem është i plot dhe në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe në VKM-në Nr. 408, datë 13.5.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si vijon:

- **Leja e Ndërtimit me Nr. 04, datë 26.09.2024, me zhvillues z. K.K** me subjekt ndërtues shoqërinë "G M" sh.p.k, me **Objekt:** Ndërtim magazine 1k me bodrum për grumbullim të prodhimeve bujqësore dhe **afat kohor** 24 (njëzetë e katër) muaj nga data e fillimit të punimve.
- **Leja e Ndërtimit me Nr. 02, datë 22.07.2024 me zhvillues z. A.Y dhe znj. T.Y** me subjekt ndërtues shoqërinë "E" shpk, me **Objekt** Shtesë kati mbi objekt ekzistues dhe **afat kohor** 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e fillimit të punimve.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditim miratimi i 2 certifikatave të përdorimit nga ku rezulton se dokumentacioni i ngarkuar në sistem është i plot dhe në përputhje me Nenin 42 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin e zhvillimit të territorit”, nenin 13 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar si dhe nenin 27 të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si vijon:

- - **Çertifikata e përdorimit me Nr. 05, datë 17.12.2024** për objektin “Ndërtim godine shërbimi 1 kat (+1 kat nëntokë)”, ndërtuar nga sipërmarrësi “T” shpk, Lic. NZ.8, sipas Lejes së Ndërtimit (për ndryshim projekti gjatë ndërtimit), Nr. 07, datë 01.11.2023 protokolluar me Nr. 4877/3 prot., datë 01.11.2023, i ndodhur në pasuritë me nr. pasurie 331/46 dhe 331/43, ZK 2160, me zhvillues shoqërinë “A” shpk sipas certifikatave të Pronësisë, me vendodhje fshati Klos, NJA Hekal, Bashkia Mallakastër.
- - **Çertifikata e përdorimit me Nr. 02, datë 13.02.2024** për objektin “Banesë 1 kat”, ndërtuar nga sipërmarrësi “G” shpk, Lic. NZ.7, sipas Lejes së Ndërtimit Nr.3078/4 prot., datë 23.11.2021, i ndodhur në pasurinë me nr. pasurie 98/9, ZK 1566, me zhvillues z. Novrus Kullsi, me vendodhje fshati Dukas, NJA Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
- Auditimi i Lejeve Infrastrukturore
- Nga auditimi i Lejeve Infrastrukturore rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë dhënë nga 2 leje infrastrukturore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër në 1 prej tyre është Zhvillues Bashkia Mallakastër, dhe nuk është paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë në 1 rrastë subjekte zhvillues nuk është Bashkia Mallakastër si vijon:

Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit	TNI më %
Leje ndërtimi infrastrukturë	Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës	Bashkia Mallakastër	Vendim Nr. 16, datë 01.10.2024	81,159,282	0%
Leje ndërtimi infrastrukturë	Ndërtimi ujësjellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë, Bashkia Mallakastër	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve	Vendim Nr. 17, datë 29.10.2024	472,790,521	0%

Referuar informacionit të marrë në DPZHT Bashkia Mallakastër, rezulton se për periudhën objekt auditimi në territorin e Bashkisë Mallakastër janë miratuar në total 2 leje infrastrukturore të cilat korrespondojnë me investimet e kryera në Bashki për periudhën 01.01.2024-31.12.2024. Nga auditimi i sistemit e-leje rezultoi se në Bashkinë Mallakastër po kryhen disa investime ku investitor dhe zhvillues nuk është Bashkinë Mallakastër, (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve), për të cilën nga Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve nuk ka mundur përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve, konkretisht objektet:

" Ndërtimi ujësjellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë, Bashkia Mallakastër" me vlerë preventivi prej 472,790,521 lekë; sipas lejes Vendim Nr. 17, datë 29.10.2024 me zhvillues “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve” Nga auditimi i sistemit e leje, miratimi i lejes nuk është paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 0.1% sipas paketës fiskale. Vlera e investimeve sipas preventivit është 472,790,521 lekë x 0.1% = **472,790 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.** Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nënpika 3 e pikës 4 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” të VKB nr. 56 datë 30.11.2023.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi znj. S.K me detyrë Specialiste Buxheti e caktuar për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

2.7. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore(IMTV).

4. Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

5. Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë:

6. Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të prishjes së objektit të kundërligjshëm dhe ekzekutimin e tyre:

7. Mbi respektimin e afateve për nxjerrjen e vendimeve pas konstatimit të kundërvajtjes:

8. Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit:

9. Mbi arkëtimin e masave administrative:

Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3, kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

a) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njesisë Vendore përkatëse;

b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.⁴

Për vitin 2024 IMTV, Bashkia Mallakastër ka funksionuar e plotë sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 10, datë 29.12.2023 “Për miratimin e strukturës, organikës, kategoritë/klasat e pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2024”, si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
1.	SH.XH	Inspektor	Arsimi i mesëm, dega ndërtim	14.10.2019	Në punë
2.	K.Y	Jurist	Bachelor	02.11.2023	Në punë
3.	A.X	Kryeinspektor	Arsimi i lartë, inxhinier ndër	20.05.2019	Në punë

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IMTV Bashkia Mallakastër, sipas evidencave të vëna në dispozicion për periudhën objekt auditimi rezultojnë se janë mbajtur procesverbalet e konstatimit të shkeljeve në punimet e ndërtimit të hartuara nga IMTV, vendimet e marra nga kryeinspektori për pezullimin e punimeve të ndërtimit, vendimet e gjobave dhe vendimet e prishjeve për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi. Në formë table paraqiten vendimeve të marra nga IMTV për vitin 2024 si vijon:

Nr.	Lloji i aktit	2024
1	PV/Akte kontrolli	58
2	PV/Akte konstatimi	13
3	Vendime gjobe	11
4	Vendime pezullimi	6
5	Vendime prishje	5
6	PV ekzekutimi të prishjeve	0

⁴ Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4.

7	Kallëzime penale	1
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	5
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	2
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12

Burimi: Bashkia Mallakastër

Nga auditimi rezultoi se IMTV, Bashkia Mallakastër për periudhën 01.01.2024 deri me 31.12.2024 ka miratuar planin vjetor të punës si dhe ka miratuar planet mujore për periudhën objekt sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Mallakastër për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në mënyrë të përmbledhur Aneksin 1, pika 7, bashkëlidhur.

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Mallakastër u konstatua se për vitin 2024 janë dhënë 11 masa “Dënim me gjobë”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2024 është 7,631,327 lekë. Janë paguar në mënyrë vullnetare vetëm 6 gjoba me vlerë 3,471,422 lekë dhe mbeten për tu paguar 5 gjoba me vlerë totale 4,159,905 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat ligjore që janë marrë nga IMTV Mallakastër për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave rezulton se, ka filluar procesi për të arkëtuar gjobat që nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore. Të gjithë kundërvajtësit janë njoftuar për detyrimin që kanë si rezultat i shkëlqes që është konstatuar nga IMTV. - Janë në proces gjyqësorë 5 vendime në vlerë 4,159,885 lekë. Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, rezulton se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultat e duhura, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9 “Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbartimor, sipas këtij ligji”, neni 22, pika 1, “Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbartimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji”, neni 3, pika 5 “Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhet ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë”. Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 deri më 31.12.2024 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Mallakastër, ka marrë 5 vendime për prishje objektësh pa leje. Referuar tabelës më poshtë rezulton se nuk është ekzekutuar vullnetarisht asnjë vendim si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedurë, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

2.8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

8.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

8.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

8.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 33/17 prot. datë 11.06.2024 i ka dërguar Bashkinë Mallakastër, “Raportin përfundimtar”, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Mallakastër ka respektuar afatet, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr. 122/24 Prot., datë 01.07.2024, për Urdhrin Administrativ nr.211, datë 18.06.2024 mbi planin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr. 122/25 Prot., datë 27.02.2024, sipas planit të veprimit miratuar me shkresën nr.122/24, datë 01.08.2024 “Mbi planin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH së”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 33/17 prot. datë 11.06.2024, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **47 masa organizative**;

b. Janë rekomanduar 4 masa shpërbllim dëmi në vlerën **26,259,410 lekë**

c. Janë rekomanduar **6 masa për uljen e borxhit tatimor në vlerën 1,198,177,534 lekë**;

d. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Mallakastër që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 2 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për

të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 329, datë 01.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë z. Q.I është ngritur grupi i punës përkatës për hartimin e strategjisë së riskut të institucionit. Kjo situatë ka mbetur në fazën e ngritjes së grupit të punës, pra nuk janë ndjekur hapat e tjerë për hartimin e strategjisë së riskut.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

2.1. Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Mallakastër, të marrë masa:

-Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, etj, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

-Gjithashtu nga Përgjegjësi i NjAB-së të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Përgjatë vitit 2024 nga NjAB është audituar Drejtoria e Administrimit të Territorit dhe Liçensave (për lejet e ndërtimit), liçensat, funksionin e kontrollit të brendshëm, NSHP-në lidhur me mbajtjen e pagave, prokurimeve publike, investimeve në infrastrukturë pra janë audituar fusha me risk. Për sa i përket kontrollit për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ky rekomandim nuk është realizuar për arsye se kjo detyrë kryhet nga Përgjegjësi i NjAB-së dhe ky pozicion pune në strukturën e NjAB është vakant.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

3.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme në hartimin e buxhetit vjetor të përfshihen vetëm ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar/specifike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentit të planifikimit të buxhetit për vitin 2025, janë planifikuar fondet në buxhetin vjetor të institucionit vetëm për të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe nga transferta e pakushtëzuar/specifike.

Rekomandimi është zbatuar.

4.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar treguesve buxhetorë të vitit 2024 Bashkia Mallakastër konstatohet se, buxheti i rishikuar është në vlerën 1,346,047,086 lekë në bashku me njësitë e varësisë ndërsa realizimi në vlerën 968,049,273 lekë ose në masën 73% ose me një mos realizim në vlerën 36,5661,936 lekë. Pra edhe për vitin 2024 evidentohet diferenca të konisderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit të treguesve buxhetorë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

5.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për hartimin e raporteve mujore dhe atë vjetor mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, duke informuar edhe njëkohësisht Këshillin Bashkiak Mallakastër dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë dhe zbatimin e buxhetit të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale ky raportim nuk është kryer në çdo tre muaj referuar parashikimeve ligjore, por nga muaji shtator i vitit 2024 janë hartuar raporte mujore.

Rekomandimi është në proces zbatimi

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

6.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.3. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është trajtuar gjerësisht në akt konstatimin e datës 18.04.2025.

Në proces zbatim

7.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa që:

-Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për vitin 2024 të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore janë të planifikuara në vlerën 408,782,379 lekë dhe realizuar në vlerën 178,197,935 në masën 43.4% ose me një diferencë mos realizimi në vlerën 230,584,444 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mbliidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

8.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të

evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifave vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjatë të agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me rakordimet mujore me agjentët tatimorë të cilët Bashkia Mallakastër ka aplikuar për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, disponohet akt rakordime mujore vetëm me Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime, ndërsa me agjentët e tjerë nuk janë mbajtur akt rakordimet mujore përkatëse.

Rekomandimet nr. 9.1, dhe nr. 9.2., janë në proces zbatimi.

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Mallakastër, të marrin masa për planifikimin e fondeve për blerjen e një programi kompjuterik ku të përfshihet Sektori i Financë dhe Sektori i Taksave Vendore për mbajtjen veprimeve kontabël dhe të detyrimeve fiskale me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

9.2. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masa për hartimin e regjistrimit të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë dhe abonentët familjarë më të gjitha detyrime vjetore që ato kanë në zbatimin të paketës fiskale të miratuar çdo vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të plotësuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Mallakastër konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit nr. 9.1, dhe nr. 9.2.

Rekomandimet nr. 9.1, dhe nr. 9.2., nuk janë zbatuar.

10.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

Deri më datë 31.12.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Mallakastër është kryer njoftim për subjektet që ushtrojnë aktivitetet të pa pajisur me licensë për tregtimin e hidrokarbureve dhe derivateve të tyre sipas shkresave si më poshtë:

Shkresat nr. 4865, datë 20.9.2024, për vlerën 1,302,663 lekë dhe urdhër bllokimi për subjektin "P 2009";

Shkresa nr. 4869, datë 30.9.2024, për vlerën 3,562,470 dhe urdhër bllokimi për subjektin "F" Shpk";

Shkresa nr. 4867, datë 30.09.2024, për vlerën 581,433 lekë për subjektin "S" Shpk **Rekomandimi është në proces zbatimi**

11.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Deri më datë 31.12.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të plotësuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Mallakastër konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar.

12.1. Rekomandim: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

12.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale **7,696,030 lekë** e ndarë kjo për Bashkinë Mallakastër vlerën 6,220,139 lekë për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,110,070 lekë, llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,592,339 lekë, llogarinë 532 “Vlera të tjera” në vlerën 1,517,730 lekë dhe për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike vlerën 1,475,891 lekë për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 1,423,891 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 52,000 lekë që i përket aktiveve apo letrave me vlerë të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2024, janë në vlerën 10,419,769 lekë me një rritje në vlerën 2,723,739 lekë nga mbyllja e vitit 2023. Të dhënat paraqiten si më poshtë:

Detyrime vendime gjyqësore në vlerën 945,792 lekë;

Detyrime investimi në vlerën 3,978,037 lekë;

Detyrime shërbime në 844,928 lekë;

Detyrime të tjera 4,651,012 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

13.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 31.12.2024, në vlerën 255,524,517 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 148,531,571 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 106,992,906 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

14.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrave financiare ushtrimore për vitin 2024, konstatohet në gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2024, paraqitet në

vlerën 1,116,875,551 lekë pra nuk është e kontabilizuar e gjithë vlera prej 1,192,034,397 lekë e rekomanduar. Për më tepër evidendohet e njëjta problematikë ku llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar nuk evidendohet në pasqyrat financiare.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe në hartimin e pasqyrave financiare për vitin 2024, konkretisht mbyllja e gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 10,422,499 lekë

Rekomandimi nuk është zbatuar.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për:

-Sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 21,405,216 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

-Aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe në hartimin e pasqyrave financiare për vitin 2024, konkretisht mbyllja e gjendjes së llogarisë 202 “Studime dhe projekte” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 80,104,551 lekë, pra nuk është kryer asnjë veprim sistemuar për kalimin e projektit me objekt “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit” në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi si dhe nuk është përlllogaritur normë amortizimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe në hartimin e pasqyrave financiare për vitin 2024, konkretisht në kartelat analitike të llogarive të aktivitetit evidentohehen përsëri aktivet e transferuara nga ish-komunat të paanalizuara në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

18.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Mallakastër për vlerën kontabël 62,500,417 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Deri më datë 31.12.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Mallakastër ende nuk ka iniciuar procesi i transferimit nëpërmjet procesverbaleve përkatëse për vlerën kontabël 62,500,417 lekë drejt Ujësjellës Kanalizime Sha Mallakastër.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, të marrën masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë konstatohet edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2024 ku konstatohet se llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

20.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për sistemin e vlerës 19,546,668 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të projekteve të përfunduara dhe të likuiduara që i përkasin llogarisë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” duke i kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë konstatohet edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2024 ku konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe projekte” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 80,104,551 lekë pra nuk është kryer sistemimi i vlerës 10,546,668 lekë e cila i përket dy projekteve Studim Projektim “Ndërtimi Ujësjellësit të fshatrave të Njësia Administrative Aranitas” në vlerën 9,303,986 lekë dhe Studim Projektim “Ndërtim i Ujësjellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë” të përfunduara dhe të likuiduara.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për sistemin e vlerës 171,166,853 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të kontratave të përfunduara dhe të likuiduara të punimeve, supervizorit dhe kolaudimit që i përkasin llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” duke i kontabilizuar në llogaritë 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, konstatohet se nuk janë kryer veprimet rregulluese mbi kontabilizimin në gjendjen e kësaj llogarie të vlerës 171,166,853 lekë që ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të kontratave të përfunduara dhe të likuiduara të punimeve, supervizorit dhe kolaudimit të cilat duhet t'i bashkohen vlerës së investimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 324,331,522 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 324,331,522 lekë, nuk

kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

23.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Mallakastër të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrir fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

23.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale Bashkia Mallakastër, të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të plotësuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Mallakastër konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit nr. 23.1, dhe nr. 23.2.

Rekomandimet nr. 23.1, dhe nr. 23.2., nuk janë zbatuar.

24.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 2,552,806 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 13,776,068 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,312,444 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,552,546 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 625,926 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 10,419,769 lekë ku totali shkon në vlerën 33,239,559 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 22,819,790 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

25.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, nga 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim në vlerën 39,937,791 lekë janë kryer likuidime në vlerën 3,823,365 lekë vetëm për 5 objekte sipas Urdhër Shpenzimeve si më poshtë:

Urdhër Shpenzimi nr. 667, datë 01.08.2024, në vlerën 1,317,330 lekë;

Urdhër Shpenzimi nr. 668, datë 01.08.2024, në vlerën 1,046,775 lekë;

Urdhër Shpenzimi nr. 494, datë 11.07.2024, në vlerën 544,743 lekë;

Urdhër Shpenzimi nr. 688, datë 02.08.2024, në vlerën 378,217 lekë;

Urdhër Shpenzimi nr. 666, datë 01.08.2024, në vlerën 235,800 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

26.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë Mallakastër ndaj të tretëve, në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të plotësuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Mallakastër konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

27.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,253,863,832 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 118,826,703 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 3,016,916 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 34,485,060 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 180,287,785 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 291,379,035 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

29.1. Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në hartimin e projekteve nga persona të palicesuar, në dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është trajtuar gjerësisht në akt konstatimin e datës 18.04.2025.

Në proces zbatim

30.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që, përpara nisjes së procedurave të prokurimeve, garatimin e fondeve me qëllim realizimin e objektit që prokurohet. Gjithashtu për procedurat e prokurimit të cilat e kanë afatin kohor të zbatimit të kontratës për më tepër se një vit, të kryhet parashikimin i likuidimit të tyre që në fazën e PBA-së sipas listës analitike të investimeve dhe buxhetit vjetore sipas viteve përkatëse që do të kryhet zbatimi i kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është trajtuar gjerësisht në akt konstatimin e datës 18.04.2025.

31.1. Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Përgjegjësi i Sektorit të Transportit të marrin masa që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për

karburant naftë, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e institucionit.

31.2. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të merren masa që, në Njësinë e Prokurimit të përfshijë specialist të fushës me qëllimin hartimin me objektivitet të kriteret të veçanta për kualifikim apo specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

31.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është trajtuar gjerësisht në akt konstatimin e datës 18.04.2025.

Në proces zbatim

32.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe/ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese (sipas rastit) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

32.2. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe/ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese (sipas rastit) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e fondit limit, në publikimin e Sistemin e Prokurimit Elektronik, në ngritjen e komisionit për marrjen e mallrave në dorëzim, etj.,

Menjëherë dhe në vijimësi

33.3. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është trajtuar gjerësisht në akt konstatimin e datës 18.04.2025.

Në proces zbatim

33.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të hartohen kartelat përkatëse të mjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e mjeteve.

33.2. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të merren masa për pajisjen me certifikatë pronësie, certifikatë të kontrollit teknik dhe me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësisë ndaj palëve të treta për mjetet të cilat nuk i disponojë këto dokumentacione duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

33.3. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është trajtuar gjerësisht në akt konstatimin e datës 18.04.2025.

Në proces zbatim

34.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të merren masa në të ardhmen që, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e testeve përkatëse të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve me qëllim caktimin e normativave sa më reale.

Menjëherë dhe në vijimësi

34.1. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim nuk është pranuar.

Pa zbatuar

36.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe Projekteve (DAZHITLP), Bashkia Mallakastër të marrë të gjitha masat që për çdo leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi të respektohen kondicionet urbane, duke i plotësuar ato me dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, duke u siguruar mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve.

Për subjektet që kanë hartuar projektin ndërtimor të kërkohet në çdo rast dokumentacioni që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, të kërkohet dhe respektohet mendimi i autoriteteve publike në lidhje me miratimin e këtyre lejeve, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim.

Menjëherë dhe në vijimësi

36.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar, pasi nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe me certifikatë përdorimi për periudhën 2024 shkeljet e konstatuara nga auditimi i mëparshëm janë reflektuar gjatë miratimit të lejeve.

Zbaruar

37.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu, në vijim, nga ana e Bashkisë Mallakastër, të plotësohet struktura e njësisë së Inspektoriatit të Mborjes së Territorit Vendor vetëm me punonjës që kanë arsimim të lartë, sipas përcaktimeve ligjore, duke synuar rekrutimin e stafit me profil arsimimi teknik.

Menjëherë dhe në vijimësi

37.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar, më hollësisht trajtuar në akt-konstatimin e datës 18.04.2025.

Pa zbatuar

38.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Mallakastër të marrë masa për:

-Të ndjekur me përpikmëri procedurat administrative dhe inspektuese, të parashikuar në legjislacion dhe rregullore, në lidhje me inspektimin, evidentimin, si dhe ndërmarrjen e masave administrative, për të gjithë kundërvajtësit e konstatuar në shkelje të dispozitave ligjore;

-Të nxjerrë vendimin e pezullimit të punimeve, në çdo rast që subjektet zhvilluese kanë nevojë për hapësirë kohore për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit justifikues të konstatimit të IMTV;

-Të nxjerrë vendimet e prishjes së objekteve të konstatuar në mospërputhje me ligjin, edhe nëse për këto çështje palët mund të jenë në procese gjyqësore;

-Të merren masa për të njoftuar rast pas rasti, autoritetet kompetente, në këtë rast IKMT, për të kërkuar asistencë prej tyre për prishjen e objekteve të kundërligjshme, në kushtet kur IMTV nuk është e pajisur me mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit të prishjes;

-Të merren masa për kryerjen e inspektimeve periodike për evidentimin e kundërvajtjeve, sipas përgjegjësisive përkatëse dhe sipas planeve të punës, mujore dhe vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

38.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet në proces më hollësisht trajtuar në akt-konstatimin e datës 18.04.2025.

39.1. Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe Projekteve (DAZHMLP), Bashkia Mallakastër të marrin masa për rritjen e bashkëveprimit ndërstrukturor me qëllim respektimin e dispozitave ligjore në lidhje me afatet e përfundimit të punimeve të objekteve me leje të miratuara. Nga ana e DAZHMLP të merren masa për të informuar zyrtarisht IMTV për të gjitha rastet që miratohet dokumenti “Njoftim për Fillimin e Punimeve”, si dhe të merren masa nga IMTV për të inspektuar në mënyrë periodike respektimin e afatit të përfundimit të punimeve nga zhvilluesit e objekteve të miratuara.

Menjëherë dhe vijimësi

39.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar pasi gjate vitit 2024 me D.A.Zh.T.P për çdo leje ndërtimi, njoftimit i punimeve është bërë nëpërmjet sistemit E.Leje.

Zbaruar

40.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

40.2. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësit edhe afatin e raportimit.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

B.1.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rekomandimet nr. 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.1, 3.2, 4.1, 7.1, 7.2, 8.1, 9.1, 10.2, 10.4, 11.1, 11.2, 12.1, 15.1, 20.4, 21.1, 22.1, 22.2, 22.3, që i përkasin kategorisë masa organizative të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet përveç rekomandimit nr. 22.3.

22.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë**.

Në vijimësi

B.1.2. Masa për shpërbllim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa TVSh** nga BOE “SH” ShPK, & “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt “Ndërtim shëtitore nga shkolla “Odisea” deri tek varrezat e qytetit”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa TVSh** nga OE “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë

15.02.2019, me objekt “Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja “5 Shkurti”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

40.3. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi pasi me shkresën nr. 2779/2 prot., datë 27.06.2024 janë ngarkuar personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimit sipas planit të veprimit.

Në proces zbatim

41.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të dokumentojë të gjithë procesin e konsumit të karburantit, duke hartuar rregulla në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet dhe pajisjet e institucionit, si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

41.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim nuk është pranuar pasi me urdhrin nr. 22 datë 03.05.2023 është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të kontratës së furnizimit nr. 50/4 rregj, datë 03.05.2023 me objekt “Blerje karburanti”(Diezel) viti 2023.

Zbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) “Të drejtat e KLSH”, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **26,259,410 lekë pa TVSh**, si më poshtë:
1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **12,668,343 lekë pa TVSh** nga kontraktori OE “C” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 30.07.2024

1.1. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar pasi me shkresën nr.3877, date 02.08.2024 është njoftuar subjekti “C” sh.p.k për vlerën e detyrimit i cili ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konfirmuar me letër njoftimin me nr. 2814 aktit, date 19.09.2024.

Zbatuar

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin

e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **884,140 lekë pa TVSh** nga kontraktori OE “S” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 30.07.2024

2.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet zbatuar pjesërisht pasi me shkresën nr.3878, date 02.08.2024 është njoftuar subjektit "S" sh.p.k.

Zbatuar pjesërisht

3.1. Rekomandimi: AK Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **12,662,028 lekë pa TVSh** nga Kontraktori BOE “A” ShPK & “EK” ShPK & “K” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 30.07.2024

3.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi pasi me shkresën nr.3876, date 02.08.2024 janë njoftuar subjektit BOE “A” sh.p.k, & “EK” sh.p.k & “K” sh.p.k në lidhje me detyrimin e konstatuar.

Me shkresën nr. 20 prot., datë 09.08.2024 kolaudatori z. F. Sh. ka bërë dorëzimin e Akti-Kolaudit të objektit “Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit rajonal (nga burimi i Poçemit)” me nr. 777/7 prot., datë 06.07.2021, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 4112 prot., datë 20.08.2024, ku bashkëlidhur ndodhen:

- 1) Akt--Kolaudimi i punimeve të objektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Rajonal (nga Burimi i Poçemit) “Kontrata Nr. 777 datë 06.07.2021”.*
- 2) Proçes - Verbalin mbi Inspektimin e Punimeve në objektin e sipërcituar i datës 25/05/2024.*
- 3) Marrje - Angazhimi për riparimin e difekteve të firmosura nga palët si dhe afatin 15 ditor për ti përmbushur.*
- 4) Proçes - Verbal i riparimit të difekteve nga kontraktori dhe supervizori.*
- 5) Dosja finale e objektit: "Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Rajonal (nga Burimi i Poçemit)" Kontrata Nr. 777 datë 06.07.2021" të shtjelluar e të plotësuar nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi i Punimeve.*

Në proces zbatim

4.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **44,899 lekë** nga “Eximol” Sh.a, për mos aplikimin e penalitetit si pasojë e mos dorëzimit të mallrave pranë AK brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Deri më 30.07.2024

4.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet zbatuar pjesërisht pasi me shkresën nr.113, date 11.07.2024 është njoftuar subjektit “Eximol” Sh.a

Zbatuar pjesërisht

D. MASA PËR ELIMINIM E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi nuk është kërkuar prej Kryetari i Bashkisë, nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime.

Pa zbatuar

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në vlerën totale **1,178,768,204 lekë**, e cila përbëhet nga:

-**71,367,454 lekë** detyrime nga **abonentët familjarë**;

-**1,074,888,444 lekë** detyrime nga **biznesi VIP**;

-**11,207,733 lekë** detyrime nga **biznesi i madh**;

-**8,985,573 lekë** detyrime nga **biznesi i vogël**;

-**12,319,000 lekë** detyrime nga **institucionet**;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim-Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Sektori i Tatim-Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Mallakastër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim është në zbatuar pjesërisht pasi Bashkia Mallakastër ka bërë Njoftimet sipas afateve të parashikuara në paketën fiskale, deri në momentin e verifikimit është arkëtuar vlera 11.248.886 leke. Më hollësisht trajtuar në aktkonstatimin e të ardhurave.

Zbatuar pjesërisht

2.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Administratorët e Njësie Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve dhe bizneseve të pataknuara me taksa/tarifa vendore, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të abonentëve familjarë dhe privat, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës pastrimit për vitin 2023, rezultojnë 8,018,000 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Nga verifikim rezulton se: Referuar shkresës nr. 122/25 prot., datë 27.12.2024 përcjell në KLSH, ky rekomandim nuk është pranuar pasi në_VKB nr.61, date 24.11.2023 “Për miratimin e paketës fiskale” në këto njësi ku nuk afrohet shërbimi, për rrjedhojë nuk mund të tariforen.

Pa pranuar

3.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **9,773,789 lekë** ndaj **319** personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1. Nga verifikim rezulton se: Referuar relacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së është ngarkuar Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave, të cilat kanë bërë njoftimin e subjekteve debitorë. Në vijim të njoftimeve nga DAZHTP është arkëtuar vlera 585,396 lekë për 18 subjekte duke ngelur debitor 301 subjekte në vlerën 9,188,393 lekë.

Zbatuar pjesërisht

E.1. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit sipas kontratave të qirasë në shumë **3,004,710 lekë**.

1.2. Rekomandim: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të plotësuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Mallakastër konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit nr. 1.1, dhe nr. 1.2.

Rekomandimet nr. 1.1, dhe nr. 1.2., nuk janë zbatuar.

F. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mallakastër t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë

Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes, **për 2 punonjës**, respektivisht:

Nga verifikimi rezulton se me Urdhër të Brendshëm nr.236, date 23,07,2024 të Kryetarit të Bashkisë është krijuar Komisioni disiplinor për propozimin e masës disiplinore për 2 punonjës, respektivisht:

1. Z. A.M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

2. Z. A.R, me status nëpunësi civil me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.

Në vijim të urdhrit nr.236, date 23,07,2024 të Kryetarit të Bashkisë Komisioni disiplinor me shkrese nr.3587/1,date 11,9,2024 ka përcjell DECS z-A.R të filloj procedure disiplinore ndaj z-A.M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Në proces zbatimi

H. PËR MASA ADMINISTRATIVE.

H.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 41 –“Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 67- “Klasifikimi i ofertave”, 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

a- Anëtarët e Hartimit të specifikimeve teknike dhe Njesisë së Prokurimit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 –“Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 78- “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

b- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësisht të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020,

datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 9- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92- “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit” (*Trajtuar në pikën 4 faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Nga verifikimi rezulton se me vendimin nr. 9 datë 28.02.2025 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur masë administrative dhe masë disiplinore për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, në bazë të rekomandimeve të KLSH-së.

Zbatuar

H.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMT), Bashkia Mallakastër.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7/1 dhe 12, Kreu III, dhe nenet 15 e 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të ndryshuar, me nenin 12 të Ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit”, **i rekomandoj, Kryetarit të Bashkisë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Mallakastër**, sipas kontratave respektive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për:**

1. Subjekti OE “D” ShPK përfaqësuar nga administrator z. N.XH, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr. 3408/9 prot., datë 27.09.2022 me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorush”*”, me Kontraktor punimesh OE “C” ShPK, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 12,668,343 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi rezulton se Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Mallakastër me vendim nr.21, date 25.09.2024 ka vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “D” sh.p.k e cila ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konfirmuar me letër njoftimin me nr. 3033 aktit, date 11.12.2024.

Zbatuar

2. Subjekti “M” ShPK, përfaqësuar nga administrator z. M.A, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr. 3486/13 prot., datë 05.10.2022 me objekt: “*Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj”*”, me Kontraktor punimesh OE “S” ShPK si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 884,140 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi rezulton se Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Mallakastër me vendim nr.24, date 14.10.2024 ka vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “M” sh.p.k e cila ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konfirmuar me letër njoftimin me nr. 3051 aktit, date 05.11.2024.

Zbatuar

3. Subjekti BOE “G” & “I” Shpk, përfaqësuar nga administrator z. G.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr.777/7 prot., datë 06.07.2021 me objekt: “Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjetës rajonal (nga burimi i Poçemit)” me Kontraktor punimesh BOE “A” ShPK & “EK” ShPK & “K” ShPK, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 12,662,028 lekë pa TVSH. Nga verifikimi rezulton se Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Mallakastër me vendim nr.26, date 26.10.2024 ka vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “G” sh.p.k, vlerë e cila është likuiduar.

Zbatuar

- **Konkluzione dhe rekomandime:**

Nga verifikimi i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur i Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 33/17 prot. datë 11.06.2024 dhe përcjellë në Bashkinë Mallakastër, statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjëndjes janë rekomanduar 47 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 47 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 5 masa, zbatuar pjesërisht 3 masa, në proces zbatimi 20 masa dhe pa zbatuar 19 masa. Nga 22 masa të zbatuara pjesërisht ose pa zbatuar nuk rikërkohen 11 masa (9.1, 9.2, 15.1, 16.1, 20.1, 21.1, 22.1, 23.1, 24.1, 26.1 dhe 27.1), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe është pjesë e raportit përfundimtar.

b. Për shpërbllim dëmi janë rekomanduar 4 masa me vlerë **26,259,410** lekë. Nga verifikimi rezultoi se është zbatuar 1 masë në vlera 12,668,343 lekë (Proces gjyqësorë), janë zbatuar pjesërisht 2 masa në vlerën 929,039 lekë, si dhe është në 1 masë në vlerën 12,662,028 lekë deri më datën 18.04.2025

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash. janë rekomanduar 6 masa që të analizohen në një vlerë 1,198,177,534 lekë, nga të cilat 1 masa nuk është pranuar në vlerën 8,018,000 lekë dhe 5 masa në vlerën 1,190,159,534 lekë janë në proces zbatimi.

d. Janë rekomanduar 2 masa disiplinore. Nga verifikimi rezulton se statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

h. Janë rekomanduar 5 masa administrative, nga të cilat 2 masa APP dhe 3 masa IMTV. Nga verifikimi i masave të mara nga APP rezulton se me vendimin nr. 9 datë 28.02.2025 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur masë administrative dhe masë disiplinore për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, në bazë të rekomandimeve të KLSH-së.

Nga verifikimi i masave të mara nga IMTV rezulton se me vendim nr.21, date 25.09.2024 ka vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “D” sh.p.k; me vendim nr.24, date 14.10.2024 është vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “M” sh.p.k dhe me vendim nr.26, date 26.10.2024 është vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “G” sh.p.k.

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e kryer nga Bashkia Mallakastër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, paraqitur me shkresën e saj nr. 33/17 prot. datë 11.06.2024, për masat të cilat janë cilësuar në proces zbatimi rikërkohet vazhdimi i procedurave dhe për masat e pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, **KLSH rikërkon zbatimin e plotë të rekomandimeve**, si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

11.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE),

që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

18.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër për vlerën kontabël 62,500,417 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

25.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

34.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të merren masa në të ardhmen që, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e testeve përkatëse të mjeteve/makinerve dhe pajisjeve me qëllim caktimin e normativave sa më reale.

37.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu, në vijim, nga ana e Bashkisë Mallakastër, të plotësohet struktura e njësisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor vetëm me punonjës që kanë arsimim të lartë, sipas përcaktimeve ligjore, duke synuar rekrutimin e stafit me profil arsimimi teknik.

Menjëherë

B.1.2. Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa TVSh** nga BOE “SH” ShPK, & “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt “Ndërtim shëtitore nga shkolla “Odisea” deri tek varrezat e qytetit”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa TVSh** nga OE “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt “Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja “5 Shkurti”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimit e vlerës masa për arkëtimit e vlerës prej **884,140 lekë pa TVSh** nga kontraktori **OE “S” ShPK**, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

4.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimit e vlerës masa për arkëtimit e vlerës prej **44,899 lekë** nga **“E” Sh.a**, për mos aplikimin e penalitetit si pasojë e mos dorëzimit të mallrave pranë AK brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Menjëherë

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

B. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm u konstatua se Bashkia Mallakastër nuk ka ngritur një sistem efektiv, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e këtyre raporteve, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore.

-Nuk janë hartuar plane vjetore të miratuara nga titullari i institucionit për arritjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave vjetore. Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit, nga fillimi deri në përfundim të tyre, duke mos përkrahur të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshmen dërguar pranë MFE-së nuk përfshin të gjithë kapitujt dhe elementët përkatës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pika 2-3, 21, pika 2, Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut”, Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, hapi 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm u konstatuan parregullsitë, si më poshtë:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

-Në planin strategjik nuk është paraqitur plani i punës që do të kryhet në 3 vitet e ardhshme (por është paraqitur për vitet 2022-2024) pra nuk është parashikuar veprimtaria që do të zhvillohet nga NJAB në vitin 2025.

- Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është kryer vlerësimi i brendshëm i cilësisë në kundërshtim me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1, që kryhet nga vetë Njësia.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën viti 2024, u konstatua se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemi i Prokurimeve, Sistemi i Pagave, Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit, ku sipas përcaktimit të bërë në kapitullin nr. 3.1.3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.1 dhe pika 3.2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Mallakastër, të marrë masa:

-Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë.

- Të hartojë Planin e Punës për 3 vitete e ardhshme, si dhe të monitorojë në vijimësi funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke ofruar këshillime, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Transfertën e pa kushtëzuar dhe specifike ka vlerën 208,807 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 485,528 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 324,433 mijë lekë ose në masën 67%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 350,598 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 278,431 mijë lekë ose në masën 79%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 197,763 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,750 mijë lekë ose në masën 45%.

Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 232,571 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 226,072 mijë lekë ose në masën 97%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2024 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën 485,528 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 324,433 mijë lekë ose në masën 67%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 7, datë 28.08.2018 dhe VKB përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 24-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 411,045,000 lekë dhe realizimi në vlerën 178,197,935 lekë ose në masën 43.4% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 232,847,065 lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 30-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa që:

-Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Mallakastër kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim-Taksave kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Mallakastër i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 174 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 30-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Mallakastër, të marrin masa për planifikimin e fondeve për blerjen e një programi kompjuterik ku të përfshihet Sektori i Financë dhe Sektori i Taksave Vendore për mbajtjen veprimeve kontabël dhe të detyrimeve fiskale me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Menjëherë

5.2. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e një regjistri të përditësuar të tatimpaguesve fizikë/juridikë/shtetërorë si dhe abonentëve familjarë, duke përfshirë të gjitha detyrimet e tyre vjetore, në zbatim të paketës fiskale të miratuar çdo vit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezultoi se përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe njësite administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 9 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, u konstatua se në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 6 subjekte të pajisura me autorizim me afat 5 vjeçar, të cilat e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit. Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Mallakastër të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga Sektorit të Tatim Taksave dhe Policisë Bashkiake. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa “b” dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 30-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial, të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetet për tregtim karburanti, pa u pajisur me autorizim/licencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi pasqyrave financiare konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur gabim vlerën 10,419,769 lekë pasi llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera 10,419,769 lekë e kontabilizuar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” duhej të kontabilizohej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Seksioni 3.1, pika 15. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 3, faqe 39-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit” në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohej në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të ishte kapitalizuar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Gjithashtu për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” nuk është përlllogaritur normë amortizimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 2, klasa 2, pika 36, “Për aktive afatgjata jo materiale, amortizimit të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimit 15%”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 3, faqe 39-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për:

-Sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 21,405,216 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

-Aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

9. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajshme të Aparatit të Bashkisë Mallakastër dhe Njësi Administrative Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar, Selitë, rezulton se:

Me VKM i janë kaluar kësaj njësie vendore, gjithsej 1652 pasuri përdorim/pronësi, por nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik”, konstatohet se nga Bashkia Mallakastër disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel dhe jo regjistër fizik, në të cilin evidentohen analitikët e këtyre llogarive me emërtimin dhe vlerën përkatëse por nuk paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Mallakastër të cilat janë të evidentuara në kontabilitet asnjë prej tyre nuk posedon titull pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 2, klasa 2 “Trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale”, gërma “d”, pika 36, për rrjedhje edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 3, faqe 39-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Mallakastër të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale Bashkia Mallakastër, të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet, se Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,314,698,240 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 339,122,460 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 14,366,981 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 35,780,422 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 186,551,053 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 472,935,617 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 17. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 3, faqe 39-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, kanë rezultuar disa parregullsi në shkelje, apo mos zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të LPP, si më poshtë vijon:

Në 3 procedura prokurimi me fond limit 243,434 mijë lekë, ose 100 % e fondit të audituar, disa nga kriteret e aplikuar janë të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mos pjesëmarrje e operatorëve ekonomik në garë dhe ose në skualifikim e operatorëve ekonomik me ofertë më të leverdishme dhe me mundësi për realizimin e kontratës, si: -aplikimi i kriterëve “Kapaciteti teknik”(kategoritë e licencave, stafi teknik, stafi mbështetës), të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës dhe jo në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve; - mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar, në të gjitha rastet, konkretisht procedurat:

- Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtimi i Shkollës “Gjokë Doçi” ” zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 159,811,598 lekë pa TVSh.

- Procedura e prokurimit me objekt “Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës” , zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 67,632,735 lekë pa TVSh.

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2024 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 15,990,000 lekë pa TVSh.

Në procedurën e prokurimit me objekt “Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës”, me fond limit 67,632,735 lekë pa TVSh, vlerësimi i bërë nga KVO-ja është në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe në mos plotësim të kërkesave të DST, pasi OE të kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO-ja, nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST. Në këto kushte BOE i shpallur fitues, duhet të skualifikohej, për të vijuar procedura e kualifikimit me OE të radhës që plotëson kërkesat e DST.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 2, nenin 77, nenin 92 pika 3 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me nenin 2, nenin 39, pika 4, pika 5 neni 43 dhe nenin 78, pika 2, nenin 82, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 4, faqe 55-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari të AK Bashkia Mallakastër, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret e veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

KVO-ja, në çdo rast, gjatë fazës së vlerësimit të një procedure, duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, rezultoi se për procedurën e prokurimit me objekt objekt “Ndërtimi i Shkollës “Gjokë Doçi””, me fond limit 159,811,598 lekë pa TVSh, janë konstatuar parregullsi lidhur me hartimin e preventivit dhe përlllogaritjen e fondit limit, duke përfshirë në preventivin e ofertuar vlerën 20% të TVSh-së, për rreth 20 zëra, që lidhen me furnizim makineri pajisje, për rrjedhojë ka krijuar rritje të pa argumentuar të fondit limit, në vlerën takuese 1,345,300 lekë, ndërsa nuk ka krijuar efekte financiare, pasi OE fitues ka paraqitur ofertë më të ulët .

Veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për strukturën e kostos”, kreu I seksioni A ”Punime Ndërtimi”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 55-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Mallakastër, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në përlllogaritjen e fondit limit dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësia e prokurimit, gjatë përlllogaritjes së fondit limit, të marrë masa të analizojë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, Bashkia Mallakastër u konstatua se, për kolaudimin e punimeve të ndërtimit të këtij objekti, edhe pse punimet kanë përfunduar në datën 24.07.2024, akoma nuk është caktuar kolaudatori i punimeve. Në dosje administrohet një shkresë e AKUKM me nr. 890 prot., datë 05.05.2021, sipas të cilës ky institucion “... do të jetë në rolin e investitorit (kolaudatorit) dhe do të kryejë kolaudimin e objektit, duke përfshirë edhe përfaqësues (inxhinierë të licencuar) nga Bashkia/Shoqëria UK për këtë objekt”. Bashkia Mallakastër me shkresën nr. 958, datë 03.03.2025, ose 216 ditë pas përfundimit të punimeve, i kërkon AKUKM caktimin e personave për kolaudimin e punimeve të këtij objekti. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime, të marrë masa për caktimin e kolaudatorit të këtij objekti, me qëllim dorëzimin në institucionin pronar dhe administrimin ligjor të këtij objekti jetik për komunitetin.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, me vlerë të kontratës (me TVSh) 497,726,607 lekë, realizuar nga BOE “2T” ShPK & “E” ShPK & “SH” ShPK & “B-I” SHPK, rezultoi se nuk janë vendosur pajisjet e parashikuara, për shkak të mungesës së rojeve, të energjisë elektrike dhe moskolaudimit dhe dorëzimit tek institucioni që do të administrojë këtë objekt. Vlera e këtyre zërave “Furnizim impianti i klorifikimit”, “Linjat e shpërndarjes, Makineri dhe Pajisje”, “FV Hard disk 6 TB, i prodhuar për sisteme CCTV”, “FV switch 8 porta”, “FV Kamera 6 MPX”, “FV Kamera 3 MPX”, “FV NVR Profesional” dhe “FV Prozhektorë”, të pakryera në fakt, është 7,775,637 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes

së punimeve nr. 1973/5 prot., datë 19.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe BOE “2T” ShPK & “E” ShPK & “SH” ShPK & “B-I” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër, në bashkëpunim me AKUKM dhe SHRUK Fier, të merren masa duke ngritur grup pune për monitorimin e vendosjes së pajisjeve të parashikuara në objekt dhe dorëzimin e objektit në institucionin që do të bëjë administrimin e tij. PAGESA e këtyre zërave pune, të bëhet vetëm pasi të jenë marrë në dorëzim nga institucioni administrues, konform akteve ligjore që duhet të ndiqen për marrjen në dorëzim të objektit.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile, për kontratat me objekt: *Rikonstrukcion i Rrugës Panahor –Ngraçan(Segmenti Panahor Subashaj) dhe Rrugës Ballsh-Drenovë e Re(Segmenti depo uji-shkolla)*; *“Rikonstrukcion i Rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (Segmenti Qendër Rromës-Lagja Tabakaj), Rrugës Fratar-Drizar dhe Rrugës Ninesh-Nenaj-Damës”,* u konstatua se provat laboratorike dhe raportet e testimit janë të pa mjaftueshme dhe dendësia e provave të kryera, nuk mbulon kërkesat lidhur me përcaktimin e parametrave fiziko kimikë, për shtresat rrugës, të ndërtuara sipas materialeve përkatëse. Veprime në mospërputhje me Specifikimet Teknike, kushtet e kontratës dhe pikën 3 kreu II, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”.* *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me strukturat e saj, të marrë masa në vijimësi, të verifikojnë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit, që do të paraqesin operatorët kontraktues dhe për çdo mungesë dokumentacioni të konstatuar, të pezullohet dorëzimi i dosjes përkatëse, deri në plotësimin e saj, duke nxjerrë përgjegjësitë për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër, konstatohet se struktura e IMTV për vitin 2024 nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”,* i ndryshuar, neni 11, pasi pjesë e kësaj strukture rezultojnë punonjës që nuk janë arsimuar në profil teknik(inxhinier ndërtimi, arkitekturë, urbanistik, teknologjisë së materialeve). Gjithashtu rezultoi një punonjës me profil arsimit të mesëm(teknik ndërtimi). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 7, faqe 94-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me fushën e ndërtimit, sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu, në vijim, nga ana e Bashkisë Mallakastër, të plotësohet struktura e njësisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, vetëm me punonjës që kanë arsimim të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Bashkia Mallakastër, rezultoi se gjatë verifikimit në terren për ndërtimet e paligjshme, nga inspektorët, në 5 raste janë konstatuar objekte të ndërtuara pa leje. Për këto raste nga Kryeinspektori është marrë vendim prishje, referuar kundravajtjes së konstatuar, por vendimet e marra, nuk janë ekzekutuar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”* dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *“Për inspektimin e ndërtimit”.* *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 7, faqe 94-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të ekzekutuar vendimet e prishjes të marra prej tyre dhe në vijimësi për çdo vendim të marrë për prishjen e objekteve, të procedohet deri në përfundim të ekzekutimit të vendimit, për prishjen e objektit përkatës.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 33/17 prot. datë 11.06.2024, ku janë lënë për zbatim 47 masa organizative, 4 masë për shpërblim dëmi në vlerën **26,259,410** lekë, 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 1,198,177,534 lekë, 2 masa disiplinore dhe 5 masa administrative.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, rezulton se:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 47 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 47 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 5 masa, zbatuar pjesërisht 3 masa, në proces zbatimi 20 masa dhe pa zbatuar 19 masa. Nga 22 masa të zbatuara pjesërisht ose pa zbatuar nuk rikërkohen 9 masa (15.1, 16.1, 20.1, 21.1, 22.1, 23.1, 24.1, 26.1 dhe 27.1), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe është pjesë e raportit përfundimtar.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa me vlerë 26,259,410 lekë. Nga verifikimi rezultoi se është zbatuar 1 masë në vlera 12,668,343 lekë (Proces gjyqësorë), janë zbatuar pjesërisht 2 masa në vlerën 929,039 lekë si dhe është në proces 1 masë në vlerën 12,662,028 lekë deri më datën 18.04.2025.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash. janë rekomanduar 6 masa që të analizohen në një vlerë 1,198,177,534 lekë, nga të cilat 1 masa nuk është pranuar në vlerën 8,018,000 lekë dhe 5 masa në vlerën 1,190,159,534 lekë janë në proces zbatimi.

d. Janë rekomanduar 2 masa disiplinore. Nga verifikimi rezulton se statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

h. Janë rekomanduar 5 masa administrative, nga të cilat 2 masa APP dhe 3 masa IMTV. Nga verifikimi i masave të mara nga APP rezulton se me vendimin nr. 9 datë 28.02.2025 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur masë administrative dhe masë disiplinore për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, në bazë të rekomandimeve të KLSH-së.

Nga verifikimi i masave të mara nga IMTV rezulton se me vendim nr.21,date 25.09.2024 ka vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “D-N C Studio” ShPK; me vendim nr.24,date 14.10.2024 është vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “M.A.G. Partners” sh.p.k dhe me vendim nr.26,date 26.10.2024 është vendosur masë administrative me gjobe në vlerën 1.000.000 leke ndaj subjektit “GB C E” ShPK. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura për ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15, germa “c”, neni 30, pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 96-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkohet** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

11.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

18.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Mallakastër për vlerën kontabël 62,500,417 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

25.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

34.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të merren masa në të ardhmen që, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e testeve përkatëse të mjeteve/makinerve dhe pajisjeve me qëllim caktimin e normativave sa më reale.

37.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu, në vijim, nga ana e Bashkisë Mallakastër, të plotësohet struktura e njësisë së Inspektoratit të Mborjes së Territorit Vendor vetëm me punonjës që kanë arsimim të lartë, sipas përcaktimeve ligjore, duke synuar rekrutimin e stafit me profil arsimimi teknik.

Menjëherë

B.1.2. Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa TVSh** nga BOE "Sh" ShPK, & "A" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt "Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri tek varrezat e qytetit", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa TVSh** nga OE "A" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt "Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

C. Masa për shpërblim dëmi.

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **884,140 lekë pa TVSh** nga kontraktori OE “S” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

4.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **44,899 lekë** nga “E” Sh.a, për mos aplikimin e penalitetit si pasojë e mos dorëzimit të mallrave pranë AK brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Njësisë Publike (Bashkia Mallakastër), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerë **2,520,500 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, me vlerë të kontratës (me TVSh) 497,726,607 lekë, realizuar nga BOE “T” ShPK & “E” ShPK & “Sh” ShPK & “B-I” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 602,810 lekë pa TVSh në zërat e punës “Mure butobetoni C 12/15”, “Gërmim dheu me ekskavator”, “FV matësa në objekte pallat”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmartjes së punimeve nr. 1973/5 prot., datë 19.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe BOE “T” ShPK & “E” ShPK & “SH” ShPK & “B” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në nën-pikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **602,810 lekë pa TVSh** nga BOE “T” ShPK & “E” ShPK & “Sh” ShPK & “B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1973/5 prot., datë 19.10.2020, me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”.

Brenda datës 31.12.2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksoni i Rrugës Panahor –Ngraçan(Segmenti Pnahor Subashaj) dhe Rrugës Ballsh-Drenovë e Re(Segmenti depo uji-shkolla)”, sipas kontratës për punë publike me nr. 1691/14 Prot., datë 12.07.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe sipërmarrësit të punimeve BOE “K” SHPK (me licencë NZ.7) & “Ç” SHPK (me licencë NZ.7), me vlerë të kontratës 49,092,600 lekë pa TVSH, për 4 zëra punimi, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë *dëm ekonomik* në buxhetin e Bashkisë Mallakastër, në

vlerën 1,388,800 lekë pa TVSh.

Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e vlerës prej 1,388,800 lekë (pa TVSh) nga BOE “K” SHPK & Ç” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1691/14 Prot., datë 12.07.2023, me objekt “Rikonstrukison i Rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Pnahor Subashaj) dhe Rrugës Ballsh-Drenovë e Re(Segmenti depo uji-shkolla)”.

Brenda datës 31.12.2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstrukison i Rrugës Rromës-Qafa e Drenovës(Segmenti Qendër Rromës-Lagja Tabakaj), Rrugës Fratar-Drizar dhe Rrugës Ninesh-Nenaj-Damës”, sipas kontratës për punë publike me nr. 1785/13 Prot., datë 14.07.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe sipërmarrësit të punimeve OE “LL” SHPK me licencë NZ.4, me vlerë të kontratës 45,366,340 lekë pa TVSh, për 4 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë *dëm ekonomik* në buxhetin e Bashkisë Mallakastër, në vlerën 528,900 lekë pa TVSh. Gjithashtu nga verifikimi në terren, rezultoi se në segmentin Fratar-Drizar, në vendin para ndërtesës së vjetër(ish repart ushtarak), ka ndodhur dëmtim i shtresave asfaltike në një gjatësi rreth 60 m dhe gjërësi rruge 3.6 m, dëmtimi i shtresave llogaritet për një sipërfaqe prej 216 m² (60*3.6), për secilën shtresë binder dhe asfaltobeton. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402,)datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e vlerës prej 528,900 lekë (pa TVSh) nga OE “LL” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1785/13 Prot., datë 14.07.2023, me objekt “Rikonstrukison i Rrugës Rromës-Qafa e Drenovës(Segmenti Qendër Rromës-Lagja Tabakaj), Rrugës Fratar-Drizar dhe Rrugës Ninesh-Nenaj-Damës”. Gjithashtu AK të marrë masa, të njoftojë kontraktorin, që të kryhet riparim i plotë i shtresave asfaltike të dëmtuara, në të kundërt për vlerën takuese e konsideruar si dëm ekonomik, të ndiqen procedurat e arkëtimit.

Brenda datës 31.12.2025

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përlllogaritjen e fondit limit. Për procedurën e prokurimit me objekt “Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës”, me fond limit 67,632,735 lekë pa TVSh, lidhur kontrata nr. 4086/5, datë 10.10.2024 me vlerë 64,964,175 lekë pa TVSh, rezultoi se në preventivin e fondit limit është përfshirë në mënyrë të paargumentuar, 3 herë i njëjti zë punimi (“Shkulje rrënjë dhe bimë të vogla”), si dhe nga përcaktimi i pa saktë i çmimit/njësi për zërin “Gërmim dheu për riseksionimin e kanalit(80 % me makineri)”. Për rrjedhojë nga llogaritjet

e pa sakta në volume, është krijuar rritje e pa argumentuar e fondit limit në vlerën totale 14,138,000 lekë dhe në referencë të ofertës fituese, me vlerë 64,964,175 lekë, është krijuar një diferencë në vlerën prej **11,469,440 lekë** [64,964,175 (vlera e kontratës)-53,494,735 (vlera e korrigjuar e fondit limit)], e cila përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike.

Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për strukturën e kostos”, kreu II seksioni B ”Shpenzime të përgjithshme”, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Mallakastër, të analizojë arsyet e anomalive në përlogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa, që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësitë e prokurimit, gjatë përlogaritjes së fondit limit, të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë, për të bërë të mundur përdorimin e fondeve publike me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, rezultoi se është hequr si zë pune “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 16”, i ofertuar me çmimin 2500 lekë/ml, në sasinë 1499 ml, në vlerë totale 3,747,500 lekë, i cili është zëvendësuar në mënyrë të paargumentuar teknikisht (pa patur një llogaritje të saktë të sistemit hidraulik dhe pa marrë opinionin teknikisht) me zërin e ri “FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, t = 27.9 mm, PN 20”, me çmimin e dakordësuar 6741 lekë/ml, në sasinë 1227 ml, në vlerë totale 8,271,316.2 lekë, duke e shtuar vlerën e objektit me **5,203,707** (1227 ml x (6741 – 2500 lekë/ml)). Kjo vlerë përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Mallakastër. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa duke ngritur një grup pune për kontrollin e dokumentacionit të paraqitur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi në fazën e hartimit të projektit të azhurnuar, me qëllim që ndryshimet e paraqitura të jenë të argumentuara teknikisht, duke mos rënduar ekonomikisht në buxhetin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, rezultoi se me punimet e kryera, pas ndryshimeve të miratuara nga Bashkia Mallakastër, përveç sjelljes në gjendjen fillestare të shtresave rrugore në pjesën e kanaleve të hapura, janë janë përmirësuar 15303 m² rrugë të qytetit, që nuk kanë lidhje me këtë objekt. Nisur nga çmimet e shtresave rrugore (stabilizant + binder + asfalt) në total 2716 lekë/m², rezultoi të jenë kryer punime pa efikasitet në vlerën 41,562,948 lekë. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 4.4, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa që në të ardhmen, gjatë zbatimit të punimeve, të mos miratojë ndryshime në projektpreventiv të paargumentuara teknikisht, për zëra pune të cilat nuk janë sipas natyrës së objektit që zbatohet, me qëllim shmangien e punimeve pa efikasitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 është shpenzuar vlera 13,521,720 lekë, nga e cila vlera 1,715,044 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 3 raste, ndërsa vlera 11,806,720 lekë për 1 rast i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore (dëmshpërblim për shpronësimet). Për

sa trajtuar më sipër vlera **1,715,044 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Mallakastër**. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 90-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje rezultoi se në Bashkinë Mallakastër po kryhen disa investime ku investitor dhe zhvillues nuk është Bashkinë Mallakastër, (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve), për të cilën nga Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve nuk ka mundur përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve, konkretisht për objektin:

"Ndërtimi ujësjellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë, Bashkia Mallakastër" me vlerë preventivi prej 472,790,521 lekë, sipas lejes Vendim Nr. 17, datë 29.10.2024 me zhvillues "Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve". Miratimi i lejes në sistemit është bërë pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 0.1% sipas paketës fiskale. Vlera e investimeve sipas preventivit është 472,790,521 lekë x 0.1% = 472,790 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nënpika 3 e pikës 4 të VKB nr. 56 datë 30.11.2023. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 92-94 të projektraportit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që zhvillues nuk është Bashkia Mallakastër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **472,790 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër u konstatotua se deri më datën 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 71,367,454 lekë shumë e cili i përket vetëm abonentëve familjarë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë familjarë në datë 31.12.2024, është në vlerën 91,930,023 lekë. Detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër u konstatotua se deri në datë 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 1,107,401,700 lekë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2024, është në vlerën 1,137,692,159 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifat

vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2024, janë në vlerën 1,243,000,681 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër e përbëra nga:

- Detyrime abonentët familjarë në vlerën 91,930,023 lekë;
- Detyrime nga biznesi VIP në vlerën 1,101,947,623 lekë;
- Detyrime nga biznesi i madhë në vlerën 12,048,694 lekë;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 10,807,281 lekë;
- Detyrime nga institucionet në vlerën 12,888,561 lekë;
- Detyrime nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 9,773,789 lekë;
- Detyrime nga shitja me pakicë e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 600,000 lekë;
- Detyrime nga kontratat e qirasë në vlerën 3,004,710 lekë;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.6, faqe 30-39 të projektraportit të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2024, në vlerën totale 1,243,000,681 lekë, e cila përbëhet nga:

- Detyrime abonentët familjarë në vlerën 91,930,023 lekë;
- Detyrime nga biznesi VIP në vlerën 1,101,947,623 lekë;
- Detyrime nga biznesi i madhë në vlerën 12,048,694 lekë;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 10,807,281 lekë;
- Detyrime nga institucionet në vlerën 12,888,561 lekë;
- Detyrime nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 9,773,789 lekë;
- Detyrime nga shitja me pakicë e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 600,000 lekë për subjektet “B. P. P.” Sh.P.K në vlerën 200,000 lekë, “B. 2003” Sh.P.K në vlerën 200,000 lekë dhe “E.” Sh.P.K në vlerën 200,000 lekë.
- Detyrime nga kontratat e qirasë në vlerën 3,004,710 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 15 germa (b,c,ç); nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore, si më poshtë:

a. “Vërejtje”, në zbatim të germës “a” të nenit 58, për:

1. Z. G.N, me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me delegim kompetencash,

për shkeljet e konstatuara:

- Në 3 procedura prokurimi, për mos ushtrimin e kontrollit në zbatimin me korrektësi të procedurave të prokurimit. pasi konstatohen parregullsi lidhur me mos argumentimin dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, si dhe parregullsi për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me 21, nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Trajtuar në pikën 4 faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Z. B.F, me detyrë specialist jurist, në cilësinë e Përgjegjësit për prokurimet,

për shkeljet e konstatuara:

- Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e Përgjegjësit për prokurimet dhe anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE. Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të raportin përfundimtar të auditimit).*

3. Z. Th. Gj, më detyrë specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Zhvillimit të Territorit,

për shkeljet e konstatuara:

- Në 2 procedura prokurimi, në cilësinë e specialistit të fushës si anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur. Gjithashtu për mos kontroll dhe verifikim të zërave të preventivit të fondit limit, që për rrjedhojë ka sjellë rritje të pa argumentuar të fondit limit. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të raportin përfundimtar të auditimit).*

4. Z. F.A, me detyrë specialist në Drejtorin e Ekonomike,

për shkeljet e konstatuara:

- Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe mos kryerjen e kontrollit aritmetik të vlerave për zërat e punimeve të preventivit të fondit limit, që për rrjedhojë, ka sjellë rritje të pa argumentuar të fondit limit. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin

Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të raportin përfundimtar të auditimit).

5. z. A.S, më detyrë Përgjegjës i Drejtorisë së Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:

- Në 2 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësisimit të të gjitha kriterëve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Z. E.Y, me detyrë specialsit në NSHP

7. Z. F.B, me detyrë, specialsit në NSHP

8. Z. E.H, me detyrë, specialsit në NSHP

9. Z. E.XH, me detyrë, specialsit në NSHP

për shkeljet e konstatuara:

- Në 1 procedurë prokurimi, në cilësinë e anëtarëve të komisionit për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe mos argumentim të fondit limit të përcaktuar, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Mallakastër pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTOLLI I LARTË I SHTETIT

